**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 136, Datë 10.07.2024**

**MBI**

**PËR MIRATMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË "KONTRATËS TIP PËR MBËSHTETJE"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*" i ndryshuar; nenit 14 të ligjit nr. 24/2023 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*"; si dhe neneve 19 dhe 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; nenit 11 të *Rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë,* miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.162, datë 20.10. 2020; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.07.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1611 prot., datë 08.07.2024, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike "*Per miratimin e Kushteve të Përgjithshme të kontratës TIP për Mbështetje",*

**Konstatoi se:**

- Enti Rregullator i Energjisë, në zbatim të nenit 14, pika 2 të ligjit nr. 24/2023 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"*, është autoriteti përgjegjës për miratimin e "Kushteve të përgjithshme të kontratës tip për mbështetje".

- ERE me vendim nr. 45, datë 29.03.2024, filloi procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e kushteve të përgjithshme të Kontratës Tip për Mbështetje;

- Me shkresën nr.823/1 prot., datë 27.05.2024, ERE njoftoi palët e interesit për vendimmarrjen e ERE nr. 45, datë 29.03.2024, si vijon; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Bursa Shqiptare e energjisë Elektrike (ALPEX) sh.a.; Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH) sh.a.; Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a.; Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.; Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a.; Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA);Shoqata e Investitorëve të Huaj të Shqipërisë (FIAA).

- Drafti i kontratës për mbështetje, u publikua në faqen zyrtare të internetit të ERE-s më datë 09.04.2024 në zbatim të nenit 15 të Ligjit nr. 146/*2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"* si dhe nenit 12 të *"Rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë"* miratuar me vendimin e bordit të ERE-

Adresa: Blvd "Bajram Curri" Rr: "Viktor Eftimiu",1023, Tel: +355 42 69 590;
Tiranë web: www.ere.gov.al E-mail: erealb@ere.gov.al

s nr. 162, datë 20.10.2020. Në përfundim të afateve për sa i takon procesit të konsultimit publik nuk ka patur komente nga palët e interesit.

- Marrëveshja, parashikon përgjegjësitë dhe detyrimet e palëve siç janë:

  A) **TERMA TË PËRGJITHSHËM** ku parashikohet klauzolat si: *fillimi dhe afati; kushtet; ndërtimi dhe kolaudimi; operimi dhe garancia e disponueshmërisë; riorganizimi dhe vlerësimi i gatishmërisë;*
  B) **PERIUDHË E TREGTIMIT I - TERMA E MBE-së** ku parashikohet klauzolat si: *Parashikime; nominime, ndërprerje dhe balancimi; Shitja dhe blerja e elektricitetit dhe transferimi i atributeve të prodhimit; matjet dhe të dhënat;*
  C) **PERIUDHA E TREGTIMIT II - TERMAT E CFD-së** ku parashikohet klauzolat si: *kushtet; shlyerja financiare; çmimet negative; ndërprerja e tregut; dorëzimi dhe pranimi i atributeve të prodhimit; parashikimet në lidhje me rrugën e tregut;*
  D) **TË TJERA TERMA TË PËRGJITHSHËM** ku parashikohen klauzolat si: *çmimi dhe pagesa; zgjidhja; dëmshpërblimi pas zgjidhjes; përgjegjësia; forca madhore; mbështetja e kredisë; sigurimi nën kontraktimi dhe kalimi; ndryshimi i ligjit ; deklarime, garanci dhe angazhime njoftime; konfidencialiteti dhe publikimi; Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve; të ndryshme.*

- Në përfundim marrëveshja parashikon dhe këto shtojca: SHTOJCA 1: impianti, vendndodhja, aparati matës; SHTOJCA 2: forma e garancisë bankare; SHTOJCA 3: profilet sezonale dhe objektivat; SHTOJCA 4: formula për dëmet e likuiduara të disponueshmërisë energjitike; SHTOJCA 5: SHTOJCA 5: përcaktimi i sasisë së kontratës për periudhën e tregtimit tii.

- Procedura për miratimin e kushteve të përgjithshme është detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 14 të ligjit nr. 24/2023 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"* i cilin parashikon se: *(1).Kontratat për mbështetje përfshijnë: a) kushtet e përgjithshme, të cilat përbëhen nga kushte dhe terma kontraktualë të standardizuar, që janë të ngjashëm me të gjitha projektet e krahasueshme. b) kushtet individuale, të cilat përbëhen nga kushte specifike të zbatueshme për projekte individuale dhe/ose zgjedhje midis opsioneve të disponueshme sipas kushteve të përgjithshme. (2).Kushtet e përgjithshme të kontratës tip për mbështetje miratohen nga Enti Rregullator i Energjisë. (3) Në një proces konkurrues, ministri mund të publikojë paraprakisht si pjesë të dokumenteve të procedurës konkurruese kushtet e përgjithshme dhe individuale të kontratës përkatëse për mbështetje.* Së fundi pika 4, e po të njëjtin nen të ligjit për BRE[1], parashikon se: *(4).Kontratat për mbështetje përgjithësisht kanë një kohëzgjatje prej 15 vjetësh.*

- Ndërsa në nenin 12 të ligjit nr. 24/2023 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme",* parashikohen dhe *skemat mbështetëse, (1) Mbështetja për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme mund të jetë në një nga format e mëposhtme: a) marrëveshje për blerje të energjisë; b) kontratë për diferencën; c) kontratë për prim. (2) Përpara krijimit të një tregu likuid të energjisë elektrike të ditës në avancë në përputhje me nenin 30 të këtij ligji, mbështetja mund të jepet në formën e një marrëveshjeje për blerjen e*

[1] ligj nr. 24/2023 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme",*

*energjisë, e cila duhet t'i nënshtrohet një konvertimi në një kontratë për diferencë pas krijimit të tregut likuid të energjisë elektrike të ditës në avancë, në përputhje me nenin 30, pikat 4, 5 dhe 6, të këtij ligji. (3) Forma e skemës mbështetëse përcaktohet përpara nisjes së çdo procesi konkurrues nga ministria.*

- Ligji për BRE[2] ka parashikuar në Neni 3 "Përkufizime" në pikat 17,18,19, dhe kuptimin e "Kontratës për diference" , "Kontratës për mbështetje" dhe "Kontratës për Prim" si me poshtë vijon: (i) pika 17. *"Kontratë për diferencën" (CfD) është një kontratë për mbështetje e rregulluar financiarisht ku Operatori i Energjisë së Rinovueshme i paguan prodhuesit me përparësi diferencën midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës kur çmimi i referencës është më i ulët se çmimi i garantuar dhe prodhuesi me përparësi i paguan diferencën Operatorit të Energjisë së Rinovueshme kur çmimi i referencës është më i lartë se çmimi i garantuar.* (ii) pika 18. *"Kontratë për mbështetje" është kontratë përmes së cilës prodhuesit me përparësi i jepet mbështetje sipas këtij ligji.* (iii) pika 19. *"Kontratë për prim" është një lloj kontrate për mbështetje ku paguhet një prim fiks (që mund të jetë pozitiv ose negativ në varësi të rezultatit të procesit konkurrues) ose një prim rrëshqitës (si diferencë midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës) nga Operatori i Energjisë së Rinovueshme për prodhuesit me përparësi mbi çmimin e tregut.*

- Duke marrë në konsiderate dhe saktësimet / sqarimet e MIE-s më datë 08.07.2024, por dhe në përfundim të analizës ligjore vlerësohet se;

(i) Rezulton se në tekstin e hyrjes së marrëveshjes, seksioni (E) ku parashikohet ndër të tjera se: (...)*Për Periudhën e Tregtimit II, kjo Marrëveshje për Mbështetje do të zbatohet në formën e një Kontrate për Diferencë të shlyer financiarisht.*

Vlerësohet të shtohet gjithashtu saktësimi dhe sqarimi tek fjalia e fundit e këtij paragrafi sa vijon ; (...) *Për Periudhën e Tregtimit II, kjo Marrëveshje për Mbështetje do të zbatohet në formën e një Kontrate për Diferencë të shlyer financiarisht*, ***e cila bëhet e zbatueshme sipas përcaktimeve të modelit të tregut të energjisë elektrike dhe nëse palët nuk kanë përcaktuar një nga format e tjera të parashikuar në skemën mbështetësë të ligjit nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të Energjisë nga Burimet Rinovueshme".***

(ii) Rezulton se në draftin e publikuar të *Marrëveshjes për Mbështetje* nuk është specifikuar qartë terminologjia (tek pjesa e përkufizimeve) për sa i takon *rregullave te tregut të Balancimit*. Ndaj, vlerësojmë se duhet ndryshuar terminologjia e përdorur duke zëvendësuar kudo në dokument ku përmendet termi "*Rregullat e tregut te përkohshme të balancimit"* të zëvendësohet si vijon: ***"Rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020**.

(iii) Rezulton se në draftin e publikuar të marrëveshjes (sipërcituar) po në seksionin e *përkufizimeve* ku parashikohet dhe kuptimi i termave: *Ofruesi i shërbimeve (...), kapaciteti(...) dhe kapaciteti i mbështetur (...)*; vlerësohet se vlerat e paraqitura sa i takon sasive për MW, **duhet të jenë të papërcaktuar në vlera përkatëse (xx /MW),** pasi ndodhemi në rastin e miratimit të kushtet të përgjithshme të marrëveshjes;

[2] ligj nr. 24/2023 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"*,

(iv) Rezulton se në draftin e publikuar të marrëveshjes në seksionin (B).......... neni 7 pika 7.9, nder te terja parashikohet se ; *(...)Tarifa për Shërbimet e Balancimit nuk duhet të jetë më lartë se limiti prej [5 EUR / MWh], derisa një Vlerësim Pozitiv i Likuiditetit të Tregut Brenda të Njëjtës Ditë të jetë arritur.* Duke marrë në konsideratë sqarimet e sipërcituar se kushtet e përgjithshme te marrëveshjes, nuk duhet te specifikojnë vlera apo sasi pasi ketë të fundit janë subjekt i negocimeve dhe rrjedhimisht duhet te jene pjese e kushteve të veçanta të kontratës. Për pasoje vlerësojmë se kjo klauzolë duhet të saktësohet si vijon: *(...)Tarifa për Shërbimet e Balancimit nuk duhet të jetë më lartë se limiti prej* ***[xxxx EUR / MWh], përcaktuar në kushtet e veçanta të marrëveshjes****, derisa një Vlerësim Pozitiv i Likuiditetit të Tregut Brenda të Njëjtës Ditë të jetë arritur.*

(v) Rezulton se marrëveshja në neni 28 *"Ligji rregullues dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve"* parashikon ndër të tjera se marrëveshja do të *rregullohet nga dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë.* Ligji nr. 43/2015 i ndryshuar, parashikon se ERE ka në kompetence edhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarave. Në vijim vlerësojmë të shtohet fjalia në vijim të përcaktimeve të nenit 28.1. me saktësimin si vijon: ***Palët mund t'i drejtohen ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëse nuk parashikohet ndryshe në kushtet e veçanta të marrëveshjes për mbështetje. Në çdo rast kushtet e veçanta duhet të mbështeten në përcaktimet e përgjithshme në nenin 28.2 në vijim.***

(vi) Rezulton se nenin 28 *"Ligji rregullues dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve"* pika 28.5 ndër të tjera parashikon gjithashtu se : (....) *Selia e arbitrazhit do jetë Vjene Austri*. Duke marrë në konsideratë për sa argumentuar më lart , vlerësojmë se në kushtet e përgjithshme të kontratës duhet të jetë e papërcaktuar vendi i zhvillimit të arbitrazhit duke iu lenë mundësinë palëve që ta përcaktojnë në kushtet e veçanta te saj vendin e selisë së arbitrazhit. Në vijim vlerësojmë të saktësohet (fjalia e parafundit) nenit 28.5, si vijon; (....) *Selia e arbitrazhit* ***do të përcaktohet nga palët në kushtet kushtet e veçanta të marrëvshjes.***

(vii) Rezulton se në Shtojcat e *marrëveshjes për mbështetje* të emërtuara si vijon: Shtojca 1: *impianti, vendndodhja, aparati matës* ; Shtojca 2: *forma e garancisë bankare;* Shtojca 3: *profilet sezonale dhe objektivat*; Shtojca 4: *formula për dëmet e likuiduara të disponueshmërisë energjitike*; Shtojca 5: *përcaktimi i sasisë së kontratës për periudhën e tregtimit tii.* përveç emërtimeve, nuk kanë të përcaktuar në përmbajtje formatin e plotësuar por vetëm emërtimet përkatëse. Për sa më sipër vlerësohet të shtohet me përjashtim të **Shtojcës 2 *"forma e garancisë bankare"*** e cila rezulton e plotë dhe do të konsiderohet pjesë integrale e marrëveshjes për mbështetje. Ndërkohe titulli i **Shtojces 5,** duhet korrigjuar tek *përmbajtja e marrëveshjes* pasi vlerësojmë se emërtimi i përcaktuar ne përmbajtjen e marrëveshje është gabim material. (i njëjtin me emërtimin të shtojcës 4.)

(viii) Në nenin *29 "Të ndryshme"* pas pikës 29.10, të vijohet me pikën ***29.11 Palët në këtë marrëveshje mund të vendosin plotësimin e shtojcave që lidhen me: impianti, vendndodhja, aparati matës, profilet sezonale dhe objektivat; formula për dëmet e likuiduara të disponueshmërisë energjitike; përcaktimi i sasisë së kontratës për periudhën e tregtimit tii..*** Pas këtij ndryshimi pika 29.11 bëhet pika 29.12 dhe mbetet e pandryshuar në përmbajtje.

- Saktësimet dhe sqarimet e depozituara së fundi nga MIE dhe komentet e ERE-s janë kryesisht të së njëjtës natyrë dhe janë reflektuar në këtë marrëveshje dhe janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 24/2023 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Miratimin e *"Kushteve të përgjithshme të Kontratës TIP për Mbështetje" përshirë kushtet e Përgjithshme të CFD.* (Bashkëlidhur Marrëveshja).

2. *Kushtet e Përgjithshme të CFD* bëhen të zbatueshme pas miratimit sipas Modelit të Tregut.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**

**DATE** [       ]

(1) [**PALA KONTRAKTUESE PËR MBËSHTETJE]**

- dhe -

(2) [**PALA SPV**]

# MARRËVESHJE PËR MBËSHTETJE

# PËRMBAJTJA


1. PËRKUFIZIME.......................................................................................................... 2

(A) TERMA TË PËRGJITHSHËM

2. FILLIMI DHE AFATI ....................................................................................................... 22
3. KUSHTET ......................................................................................................................... 22
4. NDËRTIMI DHE KOLAUDIMI ....................................................................................... 23
5. OPERIMI DHE GARANCIA E DISPONUESHMËRISË……………………………….... 23
6. RI-ORGANIZIMI I TREGUT DHE VLERËSIMI I GADISHMËRISË ............................ 24

(B) PERIUDHE E TREGTIMIT I – TERMAT E MBE-SË

7. PARASHIKIME, NOMINIME, NDËRPRERJE DHE BALANCIM……………………………27
8. SHITJA DHE BLERJA E ELEKTRICITETIT DHE TRANSFERIMI I ATRIBUTEVE TË PRODHIMIT ................................................................................................................. 31
9. MATJET DHE TE DHËNAT…………………………………………………………….33

(C) PERIUDHA E TREGTIMIT II –TERMAT E CFD-SË

10. KUSHTET…..………………………………………………………………………….34
11. SHLYERJA FINANCIARE...…………………………………………………………… 34
12. CMIMET NEGATIVE …...……………………………………………………………35
13. NDËRPRERJA E TREGUT…………………………………………………………........35
14. DORËRIZIMI DHE PRANIMI I ATRIBUTEVE TË PRODHIMIT ……………………………36
15. PARASHIKIMET NË LIDHJE ME RRUGËN E TREGUT……………………………….37

(D) TË TJERA TERMA TË PËRGJITHSHËM

16. CMIMI DHE PAGESA …………….……………………………………………………37
17. ZGJIDHJA.................................................................................................................... 39
18. DËMSHPËRBLIMI PAS ZGJIDHJES .......................................................................... 41
19. PËRGJEGJËSIA ............................................................................................................ 42
20. FORCA MADHORE…………………………………………………………………….. 42
21. MBËSHTETJA E KREDISË .......................................................................................... 43
22. SIGURIMI...................................................................................................................... 45
23. NËNKONTRAKTIMI DHE KALIMI ........................................................................... 45
24. NDRYSHIMI I LIGJIT .................................................................................................. 46
25. DEKLARIME, GARANCI DHE ANGAZHIME .......................................................... 47

26. NJOFTIME .......... 48
27. KONFIDENCIALITETI DHE PUBLIKIMI .......... 49
28. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE .......... 50
29. TË NDRYSHME .......... 52
SHTOJCA 1: IMPIANTI, VENDNODHJA, APARATI MATËS .......... 55
SHTOJCA 2: FOMRA E GARANCISË BANKARE .......... 58
SHTOJCA 3: PROFILET SEZONALE DHE OBJEKTIVAT
SHTOJCA 4: FOMRULA PËR DËMET E LIKUIDUARA TË DISPONUESHMËRISË ENERGJITIKE .......... 63
SHTOJCA 5: PERCAKTIMI I SASISE SE KONTRATES PER PERIUDHEN E TREGTIMIT II .......... 64

**KJO MARRËVESHJE** lidhet më,

**NDËRMJET:**

**(1)** **[PALA KONTRAKTUESE PËR MBËSHTETJE]**, një shoqëri aksionare e themeluar në Shqipëri me nr. Regjistrimi [■] dhe seli në [■], Tiranë, Shqipëri ("**Pala Kontraktuese për Mbështetje**"); dhe

**(2)** **[PALA SPV]**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Shqipëri me nr. Regjistrimi [■] dhe me seli në [■] Tiranë, Shqipëri ("**Shitësi**");

(Pala Kontraktuese për Mbështetje dhe Shitësi secili si një "**Palë**", së bashku si "**Palët**").

**DUKE QENË SE:**

A Në përputhje me Ligjin për Burimet e Rinovueshme 24/2023, dhe VKM Nr. 349, datë 12.6.2018 "Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre", e ndryshuar. ("**Vendimi 349**"), Autoriteti Kontraktues ftoi ofertuesit të dorëzonin ofertat e tyre përkatëse për projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e një/disa Impianti/eve te energjise elektrike/_________, për një kapacitet të instaluar deri në _________MW (përfshirë) ("**Projekti**"), (pjesa e kapacitetit të instaluar që merr mbështetje referuar si "**Kapaciteti i Mbështetur**").

B [Ofertuesi/Konsorcium] i lidhur me Shitësin, është përzgjedhur si ofertues fitues dhe ka lidhur nje Marrëveshje Zhvillimi të Projektit.

C Shitësi ka për qëllim të ndërtojë dhe të operojë Impiantin në Vendndodhje për zbatimin e Projektit në përputhje me detyrimet e Ofertuesit sipas Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit.

D Pas ndërtimit, Shitësi ka për qëllim të mirëmbajë, riparojë dhe operojë Impiantin për të kryer biznesin e tij në Vendndodhje dhe të sigurojë furnizimin me energji elektrike në Pikën e Matjes përgjatë Afatit.

E Palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje për të dokumentuar termat e marrëdhenies në përputhje me Marrëveshjen e Zhvillimit të Projektit. Përgjatë Periudhës së Tregtimit I, kjo Marrëveshje për Mbështetje do të zbatohet në formën e një Marrëveshje për Blerjen e Energjisë së shlyer fizikisht që rregullon shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga Kapaciteti i Mbështetur me një çmim fiks prej [ ] ([ ]) Euro për MWh, derisa të kryhet një Vlerësim Pozitiv i Gatishmërisë së Tregut i njohur nga një Deklaratë e Përbashkët. Për Periudhën e Tregtimit II, kjo Marrëveshje për Mbështetje do të zbatohet në formën e një Kontrate për Diferencë të shlyer financiarisht e cila behet e zbatueshme sipas përcaktimeve te modelit te tregut te energjise elektrike dhe nëse palët nuk kane përcaktuar nje nga format e tjera të parashikuar në skemën mbeshtetese te *ligjit 24/2023*,

**ËSHTË RËNË DAKORD:**

**1. PËRKUFIZIME**

1.1 Termat dhe shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet përkatëse si më poshtë:

**"Shoqëri e Lidhur"** nënkupton, lidhur me një Palë, një shoqëri, korporatë ose një person tjetër juridik i cili është:

(a) drejtpërdrejt ose tërthorazi në kontrollin e asaj Pale (për qëllim të këtij përkufizimi, një **"Shoqëri Mëmë"**);

(b) drejtpërdrejt ose tërthorazi në kontrollin e një Shoqërie Mëmë; ose

(c) drejtpërdrejt ose tërthorazi nën kontroll të përbashkët me një Shoqëri Mëmë;

*me kusht që* "**kontrolli**" kërkon aftësinë për të ushtruar ndikim vendimarrës mbi një ndërmarrje, një shoqëri, korporatë ose tjetër njësi ligjore në bazë të të drejtave të pronësisë së kapitalit, kontratave, dokumentave të barazvlefshëm të themelimit, apo cfarëdo instrumenti tjetër të marrë në konsideratë vecmas apo në kombinim me njëri tjetrin, dhe duke marrë në parasysh konsideratat përkatësë të ligjit dhe të faktit.

**"Marrëveshja"** ose **"Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike"** nënkupton këtë marrëveshje dhe pjesen e vecante te saj, e cila do të konsiderohet si pjesë përbërëse të saj, me ndryshimet dhe/ose rideklarime herë pas here;

**"Kodi shqiptar i Rrjetit të Transmetimit"** nënkupton dokumentin për funksionimin e Rrjetit kombëtar të Transmetimit, të operuar nga OST sh.a;

**"Kodi shqiptar i Rrjetit të Shpërndarjes"** nënkupton dokumentin për funksionimin e Rrjetit kombëtar të Shpërndarjes, të operuar nga OSSH sh.a;

**"Rregullat e ALPEX"** nënkupton rregullat e miratura nga një Autoritet Kompetent mbi operimin dhe funksionimin e ALPEX në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm duke përfshirë, pa përjashtim, rregullat e përgjithshme, procedurat e tregtimit, rregullat e shlyerjes dhe kleringut, sic janë miratuar dhe sic mund të ndryshohen në vijim nga operatori i ALPEX dhe/ose ERE.

**"LEK"** nënkupton monedhën shqiptare Lek;

**"Pasqyrat Financiare Vjetore"** nënkupton pasqyrat financiare të audituara të një Pale që prej vitit [■] dhe për vitin më të fundit financiar të mbyllur, duke përfshirë bilancin, llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, pasqyrën e fluksit të parave dhe pasqyrën e të gjitha fitimeve dhe humbjeve të njohura, si dhe raportimet dhe shënimet e drejtorëve dhe auditorëve lidhur me to;

**"Legjislacioni i Zbatueshëm"** nënkupton, në lidhje me çdo Palë, çdo akt detyrues ndërkombëtar, çdo dispozitë kushtetuese, ligj, statut, rregull, rregullore, urdhëresë, traktat, urdhër, dekret, vendim, certifikatë, akt, urdhëresë, regjistrim, licencë, franchisë, leje, autorizim, udhëzim, Miratim Qeveritar, pëlqim ose kërkesë të një Autoriteti Kompetent që ka juridiksion mbi Palën ose pronën e saj, të zbatueshëm sipas ligjit apo statutit, duke përfshirë interpretimin dhe administrimin e saj nga Autoriteti Kompetent;

**"Gjenerimi i Disponueshëm"** nënkupton (1) energjinë elektrike aktuale të prodhuar (në MWh) gjatë një Sezoni për Impiantin e Gjenerues siç është regjistruar nga [■], si dhe (2) gjenerimin e pritshëm (në MWh) të përllogaritur nga Matja Referencë e zbatueshme gjatë secilës Periudhë të Konsideruar si e Disponueshme;

**"Garancia e Disponueshmërisë"** ka kuptimin e dhënë në nenin 5.2;

**"Balancim"** nënkupton të gjitha veprimet dhe proceset, sipas *"Rregullave të tregut Shqiptar të balancimit të energjisë elektrike"*, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020, për të gjitha afatet kohore, të përcaktuara nga OST për sigurimin në mënyrë të vazhdueshme të mirëmbajtjes së frekuencës së sistemit brenda një shtrirje të paracaktuar të qëndrueshmërisë sipas përcaktimeve në Legjislacionin e Zbatueshëm, dhe që kjo të jetë në përputhje me të gjitha veprimet, kërkesat dhe përgjegjësitë e tjera lidhur me Prodhimin e Matur dhe Impiantin sipas Legjislacionit të Zbatueshëm dhe Kodit shqiptar të Rrjetit të Transmetimit;

**"Grup Balancimi"** nënkupton një grup i përbërë nga dy ose më shumë palë përgjegjëse për balancim në të cilin një prej palëve është caktuar të bashkojë nominimet, të dorëzojë dhe të shlyejë financiarisht disbalancat e grupit pranë OST, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, në veçanti *"Rregullat e tregut Shqiptar të balancimit të energjisë elektrike"*, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020;

"**Marrëveshje e Grup Balancimit**" ka kuptimin që i është dhënë në nenin 7.8;

**"Garanci Bankare"** nënkupton një garanci bankare sipas kërkesës, të ngjashme me formën e bashkëngjitur në shtojcën 3, nga një Ofrues i Mbështetjes së Kredisë me të paktën një Vlerësim Zyrtar të Kredisë të barasvlershme ose më të lartë se Vlerësimi i Kërkuar i Bankës;

**"Pasqyrë Faturimi"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 16.1;

**"Ditë Pune"** nënkupton çdo ditë tjetër përveç të shtunës, të dielës ose çdo dite tjetër në të cilën bankat duhet të mbyllen sipas ligjit të:

(a) vendit ku ushtron veprimtarinë Pala së cilës i kërkohet të kryejë këto pagesa; dhe

(b) vendit ku është Vendndodhja;

**"Kapaciteti"** nënkupton një kapacitet të instaluara dhe kolauduar në Impiant sipas të cilët do të vendosen në [një vendndodhje në Republikën e Shqipërisë të zgjedhur nga Ofertuesi i Përzgjedhur];

**"Kapacitet i Mbështetur"** nënkupton Kapaciteti për të cilin kërkohen masa mbështetëse sipas kësaj Marrëveshje.

**"Ligji për Tregjet e Kapitalit"** nënkupton Ligjin Nr. 62/2020, Mbi tregjet e kapitalit në Republikën e Shqipërisë, sic mund të ndryshohet nga kohë ne kohë, dhe sic mund të plotësohet nga ndonjë legjislacion tjetër i lidhur nënligjor ose zbatues;

**"Ndryshim i Ligjit"** nënkupton:

(a) hyrja në fuqi e një Ligji (duke përfshirë çdo Ligj që rregullon Tatimin) që nuk është në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi;

(b) ndryshimin, shfuqizimin ose zëvendësimin e një Ligji (duke përfshirë çdo Ligj që rregullon Tatimin) pas Datës së Hyrjes në Fuqi; dhe

(c) një ndryshim pas Datës së Hyrjes në Fuqi në interpretimin ose zbatimin nga çdo Autoritet Kompetent i çdo Ligji (duke përfshirë çdo Ligj që rregullon Tatimin),

por nuk do të përfshijë asnjë nga çështjet e mësipërme për aq sa ato përbëjnë:

(a) masa korrigjuese ose sanksione të ushtruara ligjërisht nga Autoriteti Kompetent si rezultat i ndonjë shkeljeje të çdo Ligji (duke përfshirë çdo Ligj që rregullon Tatimin) nga Shitësi; apo

(b) zbatimin e drejtpërdrejtë ose miratimin e *acquis* të Komunitetit të Energjisë;

**"Data e Operimit Tregtar"** nënkupton fillimisht orën 00:00 sipas orës lokale të datës që vjen menjëherë pas datës në të cilën është kryer Kolaudimi, ose nëse është rënë dakord midis Palëve me shkrim, ditën e parë ($I^{re}$) të muajit që vjen menjëherë pas muajit në të cilin është kryer Kolaudimi dhe sipas ndryshimeve që mund të bëhen në përputhje me këtë marrëveshje;

**"Data e Afatit Përfundimtar të Operimit Tregtar"** nënkupton njëzet e katër (24) muaj nga Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve ose një datë e mëvonshme sipas dakordësisë mes Palëve me shkrim;

**"Data e Afatit të Synuar të Operimit Tregtar"** nënkupton njëzet e katër (24) muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi ose një datë e mëvonshme sipas dakordësisë mes Palëve me shkrim;

**"Kolaudimi"** nënkupton, lidhur me Impiantin, procesin e kolaudimit dhe testimit të Impiantit sipas përcaktimit në nenin 6.8 të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit;

**"Data e Fillimit të Kolaudimit"** nënkupton datën e njoftuar nga Zhvilluesi tek Autoriteti Kontraktues në përputhje me nenin 6.3 (a) të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit;

**"Periudha e Kolaudimit"** nënkupton kohën nga Data e Fillimit të Kolaudimit deri në Datën e Operimit Tregtar;

**"Autoriteti Kompetent"** nënkupton çdo autoritet, ministri, inspektorat, departament, gjykatë, gjykatë arbitrazhi, agjenci administrative ose komision ose ndonjë organ tjetër qeveritar, bashkiak, administrativ ose rregullator ndërkombëtar, kombëtar, vendor ose tjetër (në secilin rast deri në masën ku secili nga të mësipërmit ka juridiksion mbi secilën ose të dy Palët, këtë Marrëveshje dhe/ose çështje të kësaj Marrëveshjeje);

**"Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve"** nënkupton gjashtë (6) muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi ose një datë tjetër e mëvonshme sipas dakordësisë mes Palëve me shkrim;

**"Marrëveshja e Lidhjes"** nënkupton një marrëveshje të lidhur ndërmjet Shitësit dhe OST-së ose OSHEE për lidhjen e Impiantit me Rrjetin e Transmetimit ose marrëveshja ndërmjet operatorit të pavarur të Linjës së Transmetimit dhe OST-së;

**“Autoriteti Kontraktues”** nënkupton Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë, që vepron në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12 qershor 2018, dhe që përfaqësohet nga Sekretari i Përgjithshëm ose pasuesi i tij;

**"Mbështetja e Kredisë"** nënkupton:

(a) një Garanci Bankare; dhe

(b) një garanci të ngjashme lidhur me këtë Marrëveshje siç mund të dakordësohet me shkrim ndërmjet Palëve herë pas here;

**"Shuma e Mbështetjes së Kredisë"** nënkupton një shumë të paktën të barabartë Humbjen e Shitësit;

**"Ofruesi i Mbështetjes së Kredisë"** nënkupton personin që siguron Mbështetjen e Kredisë (ose një ofrues zëvendësues sipas dakordësimit në përputhje me nenin 21);

**"Rasti i Dëmshpërblimit për Padisponueshmëri"** ka kuptimin e dhënë në nenin 5.2;

**"Kontratë për Diferencë" ose "CfD"** nënkupton kontratën e shlyer financiarisht për diferencat mes Shitësit dhe Palës Kontraktuese CfD, që do të zbatohet për Periudhën e Tregtimit II pas përfundimit të një Vlerësimi të Gatishmërisë së Tregut sipas kushteve të paracaktuara, për pagimin e shpërblimit të ndryshueshëm simetrik në raport me çmimin referencë të tregut në përputhje me termat e përcaktuar në Seksionin C të kësaj Marrëveshjeje.

**"Sasia e Kontratës"** nënkupton për Periudhën e Tregtimit II sasinë e energjisë elektrike të shprehur ne MWh dhe GoO-të përkatëse sic përcaktohet më poshtë dhe sic përcaktohet më në detaj në Aneksin përkatës:

(a) Prodhimi i Matur përgjatë çdo periudhe shlyerje; ose

(b) Sasitë fikse të energjisë elektrike në përputhje me një skedulë dorëzimi për çdo periudhë shlyerje siç përcaktohet nw Aneksin 5 ose siç janë nominuar në lidhje me Prodhimin e Pritshëm të matur në çdo periudhë shlyerje, në përputhje me Rregullat Zbatueshme të Tregut; ose

(c) Sasitë e energjisë elektrike të prodhuara nga Impianti dhe të nominuara ose të shitura në Bursën Shqiptare të Energjisë në pëpurthje me Rregullat e ALPEX.

[*SHËNIM*: Shitësit i jepet mundësia që të zgjedhë një nga opsionet e mësipërme për përcaktimin e Sasisë së Kontratës për qëllim të përllogaritjës së Masës së Shlyerjes Financiare përgjatë Përiudhës së Tregtimit II].

**“Dita në-Avancë -GCT”** ka kuptimin e dhënë në nenin 7.3 (a);

**"Vendimi 349"** ka kuptimin e dhënë në Pjesën Hyrëse A;

**"Dëme të Vonesës"** nënkupton sasinë më të lartë të:

(a) humbjeve, kostove dhe dëmeve të demonstrueshme që i janë shkaktuar Palës Kontraktuese për Mbështetje si pasojë e paaftësisë së Shitësit për të operuar Impiantin në Kapacitet; apo

(b) për çdo MWh të Prodhimit të Mbështetur të pashitur dhe/ose të palivruar Palës Kontraktuese për Mbështetje, njëzet e pesë për qind (25%) e Çmimit të Energjisë Elektrike;

*me kusht që* në asnjë rrethanë nuk kalon pesë për qind (5%) të Kostos Totale të Projektit;

**"Periudhat e Konsideruara si të Disponueshme"** nënkupton periudhat e mëposhtme që nuk do të merren parasysh në përllogaritjen e Prodhimit të Padisponueshëm dhe si rrjedhojë do të konsiderohen si prodhim i disponueshëm me qëllim përllogaritjen e Disponueshmërisë Energjetike:

(a) ndërprerja, ndalimi ose mbyllja e Impiantit e shkaktuar nga Forca Madhore ose një Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar;

(b) ndërprerja, ndalimi ose mbyllja e Impiantit e shkaktuar nga një Ndryshim i Ligjit me kusht që të jetë ndryshuar Marrëveshja;

(c) mospërmbushja nga ana e Palës Kontraktuese për Mbështetje të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje në një mënyrë që pengon ose ndikon negativisht në performancën ose operimin e Impiantit;

(d) ndërprerja, ndalimi, mbyllja e Impiantit e shkaktuar nga një defekt ose dëmtim i transformatorit, rrjetit të brendshëm, sistemit të sigurisë, furnizimit me energji elektrike, furnizimit me ujë dhe/ose sistemit të komunikimit;

(e) çdo mirëmbajtje e planifikuar ose e paplanifikuar e pajisjeve të infrastrukturës eklektike të Impantit (duke përfshirë, pa kufizim, pajisjet e tensionit të lartë, transformatorët e rrjetit, themelet, kabllot, sistemet SCADA) që shkakton padisponueshmëri;

(f) ndërprerje, pezullim, ndalim ose zhvlerësim të Impiantit nga:

(i) Operatori i Rrjetit për shkak të rrethanave për të cilat Shitësi ose Ofruesi i Shërbimit nuk është përgjegjës; ose

(ii) çdo Autoritet Kompetent për shkak të rrethanave për të cilat Shitësi ose Ofruesi i Shërbimit nuk është përgjegjës; ose

(iii) ndërprerje nga Operatori i Rrjetit ose padisponueshmëria në ndonjë mënyrë tjetër e rrjetit jo e shkaktuar nga Shitësi;

**“Pika e Livrimit**” nënkupton pikën matëse tek rrjeti i OST-së ku Prodhimi i Mbështetur i livrohet dhe transferohet Palës Kontraktuese për Mbështetje, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Grupit të Balancimit dhe marrëveshjes së OST-së dhe Palës Kontraktuese për Mbështetje; ose në rast se Impianti është pjesë e Grupit të Balancimit të një pale tjetër në përputhje me 6.13 dhe 6.14, pikën matëse tek rrjeti i OST-së ku Prodhimi i Mbështetur i livrohet dhe transferohet Palës Kontraktuese për Mbështetje, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Grupit të Balancimit midis Shitësit dhe asaj Pale të tretë dhe marrëveshjes së OST-së dhe Palës Kontraktuese për Mbështetje.

**"Shuma e Kapitalit të Zhvlerësuar"** nënkupton Shumën e Kapitalit të reduktuar në bazë të drejtë që nga Data e Fillimit të Operimit deri në 30 (tridhjetë) vjet nga kjo datë;

**"Zhvillues"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 2.4 të Marrëveshjes së Zhvillimit të Projektit;

**"Kushtet e Zhvilluesit"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 2.12 të Marrëveshjes së Zhvillimit të Projektit;

**"Pagesa e Diferencës"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 11.1.

**"Marrëveshja e Drejtpërdrejtë"** nënkupton një marrëveshje të drejtpërdrejtë ndërmjet Palës Kontraktuese për Mbështetje, Shitësit, dhe Institucioneve Financiare e cila ndër të tjera përfshin:

(a) e drejta e Institucioneve Financiare për të ndërhyrë brenda një periudhe të caktuar për të siguruar që detyrimet e Shitësit do të përmbushen me qëllim parandalimin e ndonjë rrethane sipas së cilës Pala Kontraktuese për Mbështetje mund të kërkojë zgjidhjen e

kësaj Marrëveshje dhe/ose të drejtën e Institucioneve Financiare që të sigurojnë kalimin ose një transferim tjetër të të drejtave dhe detyrimeve të Shitësit sipas kësaj Marrëveshje në disa rrethana të caktuara;

(b) pranimin nga ana e Palës Kontraktuese për Mbështetje të çdo barre apo garancie tjetër (lidhur me këtë Marrëveshje) e dhënë nga Shitësi për Institucionet Financiare; dhe

(c) detyrimin e Palës Kontraktuese për Mbështetje për të mos marrë asnjë veprim për të mbyllur, caktuar një administrator ose sanksionuar një rregullim (ose të ngjashme) vullnetar në lidhje me Shitësin pa i dhënë një kohë të caktuar njoftimi Institucioneve Financiare,

sipas kushteve të pranueshme nga Shitësi duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, dhe Institucionet Financiare;

"**EBIT**" nënkupton fitimet përpara interesit dhe tatimit;

"**EBIT kundrejt Interesit**" nënkupton përqindjen e EBIT kundrejt shumës së të gjithë interesit dhe të çdo vlere të natyrës së interesit të tarifuar për shpenzimet lidhur me borxhin financiar për para të huazuara (që përfshin borxhet e paguar Shoqërive të Lidhura si dhe instrumentet e borxhit të institucioneve financiare) në çdo vit fiskal;

"**Vleresimi i Gadishmërisë së Tregut objekt Mosmarrëveshje**" ka kuptimin që i është dhënë në nenin 6.1.(a)(iv).

**"Data e Hyrjes në Fuqi"** nënkupton datën e përcaktuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;

**"Pagesa e Energjisë Elektrike"** ka kuptimin e dhënë në nenin (a);

**"Çmimi i Energjisë Elektrike"** nënkupton [●] Euro për MWh;

**"Disponueshmëria Energjetike"** nënkupton disponueshmërinë energjetike për Impiantin gjatë një Sezoni përkatës të përllogaritur si më poshtë: Disponueshmëria Energjetike$_s$ [%] = 1 – ((Gjenerimet e Padisponueshme)/(Gjenerimet e Disponueshme + Gjenerimet e Padisponueshme$_s$)) * 100%, ku Impianti është i përcaktuar si më poshtë;

"**Dëmet e Likuiduara të Disponueshmërisë Energjetike**" ka kuptimin e dhënë në nenin 5.3;

**"ERE"** nënkupton autoriteti rregullator për energjinë sic është përcaktuar në Ligjin për Sektorin e Energjisë dhe Legislacionin tjetër të Zbatueshëm;

**"Euro"** nënkupton monedhën e ligjshme të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që kanë miratuar dhe përdorin të njëjtën valutë të vetme nëpërmjet bashkimit monetar në përputhje me legjislacionin e traktatit të Bashkimit Evropian, të ndryshuar herë pas here;

**"Rast Mospërmbushje"** nënkupton një Mospërmbushje nga ana e Shitësit ose një Mospërmbushje nga ana e Palës Kontraktuese për Mbështetje (siç e kërkon konteksti);

**"Kapitali"** nënkupton një shumë të barabartë me 70% të totalit të (a) çdo kapitali të paguar nga ose në emër të aksionarëve të Shitësit ose të Shoqërive të tyre të Lidhura për aksionet dhe (b) shumës së principalit të papaguar nën ndonjë hua të Shitësit nga aksionarët e Shitësit ose Shoqërive të tyre të Lidhura në lidhje me Kapacitetin e Mbështetur, të cilat nga kushtet e tyre

janë në terma mirëbesimi e barazie komerciale dhe në varësi të ndonjë borxhi për paratë e huazuara nga Shitësi sipas çdo dokumenti financiar;

**"Shuma e Kapitalit"** nënkupton shumën e Kapitalit që aktualisht është paguar nga Shitësi në Datën e Operimit Tregtar;

**"Ekspert"** nënkupton ekspertin e caktuar në përputhje me nenin 21.4;

**"Data e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve"** ka kuptimin e dhënë në nenin 3.5;

**"Impiant"** nënkupton pajisjen që gjeneron energjinë elektrike dhe infrastrukturën përkatëse, duke përfshirë pajisjet e instaluara në tokë që përdorin energjinë fotovoltaike dhe linjën e transmetimit dhe të përshkruar me më shumë hollësi në Shtojcën 1 (por duke përjashtuar asetet e OST-së të vendosura (ose që do të vendosen) në Vendndodhje dhe Linjën e Transmetimit);

**"Pika e Matjes në Kufirin e Impiantit"** nënkupton pikën e matjes të përcaktuar në Marrëveshjen e Lidhjes ku Shitësi mund të verë në funksion Aparatin Matës për të treguar Prodhimin e Matur nga Impianti që injektohet në Linjën e Transmetimit;

**"Nominimi Përfundimtar i Prodhimit"** ka kuptimin e dhënë në nenin 7.5;

**"Institucione Financiare"** nënkupton çdo person juridik që siguron financimin ose rifinancimin e borxhit të Shitësit për projektimin, prokurimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Impiantit dhe për ushtrimin e të drejtave të tij sipas Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit dhe kësaj Marrëveshje, si dhe pasuesit dhe përfituesit e kalimit të tyre të lejuar, duke përfshirë çdo agjent ose administrues për një person ose persona të tillë dhe duke përfshirë një aksionar ose një shoqëri te lidhur me aksionarin;

**"Ngjarje e Forcës Madhore"** nënkupton çdo akt apo ngjarje që:

(a) ndalon Palën e prekur të kryejë detyrimet e saj në përputhje me Marrëveshjen;

(b) është jashtë kontrollit të arsyeshëm, dhe jo rezultat i fajit ose neglizhencës, të Palës së prekur; dhe

(c) Pala e prekur nuk mund të shmangë një akt apo ngjarje të tillë me ushtrimin e të gjithë kujdesit dhe aftësive të arsyeshme (duke përfshirë shpenzimin e shumave të arsyeshme),

duke iu nënshtruar përmbushjes së kushteve të mësipërme, **"Ngjarja e Forcës Madhore"** përfshin pa kufizim aktet ose ngjarjet e mëposhtme:

(i) mosfunksionimin e komunikimeve ose sistemeve komjuterike të OST-së ose të një Pale që pengojnë Palën e prekur nga përmbushja e detyrimeve të livrimit ose pranimit;

(ii) pezullimin e livrimit ose pranimit nga OST ose mosrespektimin nga OST të detyrimeve të Palës së prekur lidhur me Programin;

(iii) fenomenet natyrore, të tilla si stuhitë, uraganet, përmbytjet, rrufetë, shpërthimet vullkanike dhe tërmetet;

(iv) shpërthime ose zjarre që lindin nga rrufeja [jashtë parametrave të sistemit mbrojtës të rrufesë të Impiantit] ose shkaqe të tjera që nuk lidhen me veprimet ose mosveprimet e Palës që kërkon të çlirohet nga performanca;

(v) akte te luftës ose trazira publike, trazira civile, protesta, kryengritje, sabotazhe, epidemi, akte terroriste, rebelime;

(vi) greva ose mosmarrëveshje pune (me përjashtim të grevave dhe mosmarrëveshjeve të punës të shkaktuara nga punonjësit e njërës Palë ose si rrjedhojë e mosrespektimit nga ajo Palë të kontratës kolektive të punës);

(vii) ndërprerja e pjesshme ose e plotë e operimit të Impiantit ose një pjese të Impiantit gjatë vlefshmërisë së një vendimi për gjendjen e emergjencës në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose njësisë vetë-qeverisëse vendore ku ndodhet Impianti; dhe

(viii) mungesa e arritjes ose pamundësia për të arritur rezultate pozitive nga vlerësimi i thelluar i ndikimit në mjedis siç kërkohet nga Legjislacioni i Zbatueshëm dhe/ose kwrkesat e pwrcaktuara nw Shtojcwn 21 tw Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, që nuk vjen si rezultat i mospërmbushjes nga ana e Zhvilluesit të të gjitha kërkesave ligjore në lidhje me të dhe që nuk i atribuohet sjelljes së paligjshme ose sjelljes në keqbesim nga secila Palë

*me kusht që* një Ngjarje e Forcës Madhore nuk përfshin:

(A) padisponueshmërinë e forcës punëtore, pajisjeve, materialeve, shërbimeve komunale ose burimeve të tjera (me përjashtim të rastit kur padisponueshmëria vjen si pasojë e Ngjarjes së Forcës Madhore);

(B) vështirësi ekonomike ose financiare apo mungesë fondesh ose pamundësi për të përmbushur detyrimin për të paguar para në afat apo pamundësi për të përftuar financim;

(C) mungesë materialesh që nevojiten për zhvillimin, ndërtimin ose mirëmbajtjen e Impiantit (me përjashtim të rastit kur mungesa e materialeve vjen si pasojë e Ngjarjes së Forcës Madhore);

(D) greva, ngadalësim ose ndërprerje të punës që prek punonjësit e Palëve, Shoqëritë e tyre të Lidhura, ose secilin prej agjentëve ose kontraktuesve përkatës e shkaktuar vetëm nga punonjësit e njërës Palë ose si rezultat i dështimit të kësaj Pale për të respektuar një kontratë kolektive pune ose legjislacionin e zbatueshëm për punën; ose

(E) ndryshime në kushtet e tregut përkatës së shitjes me shumicë të energjisë elektrike ose, në rast se ka, në tregun përkatës të Përfitimeve të Gjenerimit;

**"Fondet nga Operimet"** nënkupton raportin e fondeve nga operimet e Impiantit ndaj Borxhit Total në një vit fiskal;

**"Përfitimet e Gjenerimit"** nënkupton të gjitha të drejtat dhe përfitimet e lidhura me lëshimin e garancive të origjinës dhe çdo përjashtim nga kostot apo Tatimet, të drejtat e rimbursimit, vlerën e komercializuar ose të drejta të tjera të Prodhimit të Mbështetur A ose B sikundër zbatohet, sipas Legjislacionit të Zbatueshëm;

**"Praktika e Mirë e Industrisë"** nënkupton shkallën e aftësive dhe kujdesit që do të pritej në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme nga një kontraktues me përvojë në të njëjtin lloj

sipërmarrjeje (projektim, inxhinieri, instalim, ndërtim, kompletim, kolaudim, testim, operim dhe mirëmbajtje) në lidhje me projekte të një madhësie, fushëveprimi, shkalle, natyre dhe kompleksiteti të ngjashëm me Impiantin;

**"Miratim Qeveritar"** nënkupton çdo miratim, pëlqim, ekskluzivitet, leje, certifikatë, vendim, koncesion, licencë, ose autorizim të lëshuar nga ose në emër të Autoritetit Kompetent përkatës;

**"Pika e Matjes në Lidhjen me Rrjetin"** nënkupton pikën e përcaktuar në përputhje me Marrëveshjen e Lidhjes në të cilën rrjedh energjia elektrike dhe ku do të kryhet matja midis infrastrukturës elektrike të operuar nga Shitësi në Impiant dhe Rrjetit të Transmetimit të operuar nga OST-ja ose Rrjetin e Shperndarjes te operuar nga OSSH-ja;

**"Rrjeti i Transmetimit"** nënkupton sistemet e transmetimit elektrik që zotëron dhe operon OST-ja për livrimin e energjisë elektrike përtej Pikës së Matjes;

**"Rrjeti i Shperndarrjes"** nënkupton sistemet e shperndarjes se energjise elektrik që zotëron dhe operon OSSH-ja për livrimin e energjisë elektrike përtej Pikës së Matjes;

**"Emëruesi i Pavarur"** nënkupton Qendrën për Zgjidhjen dhe Negocimin e Mosmarrëveshjeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, që vepron në përputhje me Aktin Procedural 2018/5/EnC të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë;

"**I Paefektshëm**" nënkupton, në lidhje me Përfitimet e Gjenerimit, ngjarjen e një prej rasteve apo rrethanave të mëposhtme:

(a) Përfitimi i Gjenerimit është, ose pretendohet të jetë, tjetërsuar nga pronari i ligjshëm me mjete të paligjshme, pavarësisht nëse do të ishte e mundur një blerje në mirëbesim;

(b) Përfitimi i Gjenerimit është anuluar për qëllime pajtueshmërie ose nuk është i pranueshëm për qëllime pajtueshmërie sipas sistemit të zbatueshëm;

(c) Përfitimi i Gjenerimit është pezulluar ose revokuar nga Autoriteti Kompetent, Organi Lëshues ose organ tjetër kompetent;

(d) Certifikata nuk i atribuohet Prodhimit të Matur të Impiantit,

dhe "**Paefektshmëria**" ose shprehje të tjera të afërta do të interpretohen sipas rastit më lart;

"**Informacion i Brendshëm**" nënkupton informacionin e një natyre të saktë që nuk është bërë publik, që lidhet në mënyrë direkte ose indirekte me një ose më shumë produkte të shumicës së energjise elektrike, dhe, që, nëse do të bëhej publik, do të kishte gjasa të ndikonte çmimet e këtyre produkteve të shumicës së energjisë elektrike siç është përcaktuar dhe në përputhje me kërkesat e REMIT;

"**Rasti i Paaftësisë Paguese**" nënkupton për sa i përket një Pale, se ajo Palë:

(a) është prishur (përveç rastit të një konsolidimi, bashkimi apo shkrirje);

(b) bëhet e paaftë të paguajë ose nuk mund të paguajë borxhet ose dështon, ose pranon me shkrim paaftësinë e saj në përgjithësi për të paguar borxhet e pagueshme;

(c) hyn në përgjithësi në një marrëveshje kalimi, angazhim apo ujdi me ose për përfitimin e kreditorëve të saj;

(d) fillon apo kundër saj ka filluar një proces për të kërkuar një vendim për deklarimin e paaftësisë paguese ose falimentimin e saj ose ndonjë masë tjetër sipas një ligji për paaftësinë paguese ose falimentimin apo një ligji tjetër të ngjashëm që prek të drejtat e kreditorëve, ose paraqitet një kërkesë për prishjen apo likuidimin e saj, dhe, në rast se është filluar një proces apo kërkesë e tillë, ky proces apo kërkesë:

(i) rezulton në një vendim për paaftësinë paguese apo falimentimin apo lëshimin e një urdhri për një masë ose dhënien e një urdhri për prishjen apo likuidimin e saj; ose

(ii) nuk është tërhequr, rrëzuar, mohuar, pezulluar apo kufizuar në çdo rast brenda tridhjetë (30) ditëve nga fillimi apo paraqitja e këtij procedimi apo kërkese;

(e) ka një vendim për prishjen e saj, administrimin apo likuidimin e detyruar (përveç rastit të një konsolidimi, bashkimi apo shkrirje);

(f) kërkon ose bëhet subjekt i caktimit të një administratori, likuiduesi provizor, ruajtësi, marrësi, administratori të besuar, kujdestari apo një zyrtari të ngjashëm për të ose për të gjithë asetet apo asetet kryesore të saj;

(g) ka një palë të siguruar për marrjen në posedim të të gjitha aseteve ose të të gjithë aseteve kryesore të saj ose ka masa kufizuese, masë ekzekutimi të detyrueshëm, konfiskimi, sekuestrimi apo ndonjë procedurë tjetër ligjore të nisur, të zbatueshme ose të detyrueshme lidhur me apo kundrejt të gjithë apo të gjithë aseteve kryesore dhe se ajo palë e siguruar posedon, apo nga ajo procedurë nuk është hequr dorë, nuk është pezulluar, anuluar, pezulluar apo kufizuar, në çdo rast brenda tridhjetë (30) ditëve nga ajo ngjarje; ose

(h) shkakton ose është subjekt i një rasti lidhur me të, i cili, sipas legjislacionit të zbatueshëm të një juridiksioni, ka një efekt të ngjashëm me secilin nga rastet e përcaktuara në pikat (a) deri tek (g) (e përfshirë);

**"Sigurimi"** ka kuptimin e dhënë në nenin 15;

**"Faturë"** ka kuptimin e dhënë në nenin 8.2;

**“Data e Faturës”** ka kuptimin e dhënë në nenin 8.2;

**"Autoriteti Lëshues"** nënkupton Autoritetin Kompetent përkatës, përgjegjës për lëshimin e Përfitimit të Gjenerimit;

**"Tregu brenda të Njëjtës Ditë"** ka kuptimin që i është dhënë në Rregullat e Tregut dhe në Rregullat e ALPEX;

**"Parashikim i Pavarur"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 7.17 (b);

**"Deklaratë e Përbashkët"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 6.1(a)(iii);

**"Ligji"** nënkupton (duke përfshirë në lidhje me Tatimin):

(a) çdo ligj (duke përfshirë sistemin juridik që bazohet në precedentë), statut, instrument statutor, rregullim, udhëzim, direktivë, rregull ose kërkesë (për secilin rast) të çdo Autoriteti Kompetent (por, për shmangjen e çdo dyshimi, vetëm kur ka forcën e ligjit);

(b) çdo kusht ose kërkesë tjetër për çdo licencë të energjisë elektrike ose çdo autorizim, licence, pëlqim, leje ose miratim tjetër të kërkuar nga çdo Autoritet Kompetent (ose çdo përjashtim nga nga një kërkesë për të pasur një të tillë);

**"Pala Kontraktuese për Mbështetje e Mundësisë së Fundit"** nënkupton shoqërinë e ngarkuar në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm që t`u japë prodhuesve të energjisë së rinovueshme shërbimet për rrugëtimin në treg kundrejt një tarife të reduktuar në krahasim me cmimet e referencës së tregut për Periudhën e Tregtimit II;

**"Furnizues i Licencuar"** nënkupton një operator publik i ngarkuar me detyrimin publik të shërbimit për blerjen e energjisë elektrike nga një kapacitet gjenerimi nga burime të rinovueshme të diellit dhe erës;

**"Vlerësimi i Likuiditetit të Tregut brenda të Njëjtës Ditë (*intra-day*)"** nënkupton likuiditetin e mjaftueshëm të Tregut Brenda të Njëjtës Ditë të përcaktuar nga ERE në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë pas kryerjes së një vlerësimi të thelluar që vërteton pa kufizim përmbushjen e të paktën kritereve të mëposhtme:

(a) aftësi për të nominuar sasi të paktën një orë përpara dorëzimit;

(b) disponueshmëria e një platforme tregtare operacionale, që ofron tregtim në baze ankandi (*auction-based*) ose tregtim të vazhdueshëm (*continous trading*);

(c) disponueshmëria e produkteve brenda të njëjtës ditë që mund të tregtohen në mënyrë konsistente me periudhën e shlyerjes së disbalancave in zonën përkatëse të tenderimit (*bidding zone*);

(d) faktori i vëllimeve të tregtuara dhe konsumit, i vlerësuar duke marrë paraysh dhe duke mos marrë parasysh sasitë e prodhura nga prodhuesit që përdorin burime të rinovueshme (d.m.th. faktori *churn*);

(e) diferenca mes ofertë-kërkesave krahasuar me tregje të ngjashëm të një përmase të ngjashme dhe të një niveli të ngjashëm zhvillimi;

(f) numri i pjesëmarrësve aktivë në Tregu brenda të Njëjtës Ditë, vecanërisht pjesëmarrje e shoqërive vendase me fuqi të ndjeshme;

(g) bashkimi/ndërlidhja e Tregut Shqiptar brenda të Njëjtës Ditë (*intra-day*) (*market coupling*) me tregje brenda të njëjtës ditë (*intra-day*) të shteteve të tjera

(h) cdo kriter tjetër që ERE e konsideron të nevojshëm për të vlerësuar likuiditetin e Tregut brenda të Njëjtës Ditë (*intra-day*).

**"Vlerësimi i Gadishmërisë së Tregut"** nënkupton

(a) krijimi i bursës së energjisë elektrike dhe ofrimi i çmimeve ekuilibër për periudhën përkatëse të shlyerjes nga operatori i bursës së energjisë elektrike të cilat janë të shpeshta dhe likuide sa duhet për të shërbyer si çmime të ndryshueshme reference ndaj

Çmimit të Energjisë Elektrike (si një çmim fiks *eng. Strike price*) për të mundësuar shlyerjen financiare bazuar në diferencën ndërmjet çmimit të ndryshueshëm dhe çmimit fiks;

(b) gatishmëria e Tregut të Ditës në Avancë (*day-ahead market*) të energjisë elektrike përcaktohet nga një Autoritet Kompetent bazuar në një vlerësim të thelluar të Tregut Së ditës në Avancë, vlerësim i cili bëhet jo më herët se [dymbëdhjetë (12)] muaj kalendarikë pas krijimit të tregut të organizuar të energjisë elektrike dhe bazohet në një numër treguesish kryesor, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: (1) vëllimet e tregtuara në tregun e një dite në vijim në lidhje me madhësinë fizike të tregut (d.m.th. faktori churn); (2) shpërndarjet e ofertave në tregun e organizuar të energjisë elektrike; (3) numri dhe pjesa e tregut të kompanive kryesore të prodhimit të energjisë elektrike në tregun shqiptar; (4) përqendrimi në tregun e prodhimit të energjisë elektrike (p.sh. Indeksi Herfindahl-Hirschman); (5) numrin dhe pjesën e tregut të furnizuesve kryesorë me pakicë të energjisë elektrike; (6) përqendrimi i tregut në sektorin e furnizimit (p.sh. Indeksi Herfindahl-Hirschman); (7) disponueshmëria e blerësve, agreguesve dhe traderëve të pavarur; dhe (8) bashkimi i tregut me vendet e ndërlidhura (referuar më vetë si "**Kriteret e Vlerësimit të Gadishmërisë së Tregut**" ose "**Kriteret**").

(c) (i) krijimi i një Operatori të Energjisë së Rinovueshme (OER) që do të jetë si palë në CfD në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, si dhe (ii) kushti për rregullimin e çështjeve të organizimit të shoqërisë dhe çështjet financiare të OER, veçanërisht krijimin e një mekanizmi funksional për përcaktimin dhe shlyerjen e detyrimit për energjinë e rinovueshme në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm ose (iii) kushte që sigurojnë qëndrueshmërinë financiare në mënyrë të barazvlefshme me Standartet e Sigurisë së Performancës të Palës Kontraktuese për Mbështetje [të jetë efektiv të paktën prej 3 muajsh para aplikimit CfD].

**"Ngjarje e çrregullimit të Tregut"** nënkupton secilën prej ngjarjeve të mëposhtme:

(a) dështimi i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) për të shpallur ose publikuar informacionin e nevojshëm për të përcaktuar Çmimin Përkatës të Referencës;

(b) padisponueshmëria objektive e përkohshme ose e përhershme e Çmimit të Referencës;

(c) mbyllja e përkohshme ose e përhershme e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX);

(d) ndërprerja ose pezullimi, ose vendosja e një kufizimi thelbësor mbi tregtimin e produkteve përkatëse të ardhshme *futures* ose produkteve *commodity* të ofruar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX) për Çmimin përkatës të Referencës;

(e) një ndryshim thelbësor në të dhënat e përbërjes apo në specifikimet e Çmimit Përkatës të Referencës (i) që janë lidhur ose përfshirë në kontratat *futures* ose *commodity* të ofruara nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX), ose (ii) që janë përdorur nga çdo institucion financiar përkatës për përcaktimin e Çmimit të Referencës në mbledhjen e informacionit të nevojshëm për të përcaktuar këtë çmim të ndryshueshëm;

(f) një ndryshim thelbësor në metodën e përllogaritjes së Çmimit përkatës të Referencës në mbledhjen e informacionit të nevojshëm për të përcaktuar këtë çmim të ndryshueshëm;

(g) çmimi përkatës i Referencës nuk përfaqëson më çmimin real të tregut të shumicës në zonën përkatëse të tenderimit (*bidding area*);

(h) një ulje thelbësore e likuiditetit të Tregut së Ditës në Avancë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX);

(i) Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX) pushon së qeni e disponueshme për Palët në terma të arsyeshëm tregtarë; dhe/ose

(j) secila ngjarjet apo rrethanat e mësipërme e përshkruar nga (a) në (i) më lart që rrezikon të ndodhë apo të materializohet.

**"Prodhimi i Matur"** nënkupton sasinë e energjisë elektrike të gjeneruar nga Impianti për çdo orë të matur dhe të furnizuar në Rrjetin e Transmetimit siç tregohet nga Aparati Matës i instaluar në Pikën e Matjes në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Marrëveshjen e Lidhjes;

**"Aparati Matës"** nënkupton pajisjet matëse të certifikuara nga Autoriteti Kompetent përkatës dhe të instaluara në Impiant për të matur energjinë elektrike të prodhuar nga Impianti dhe të livruar në Pikën Matëse në vendin e specifikuar më hollësisht në Shtojcën 1;

**"Pika e Matjes"** nënkupton Pikën e Matjes në Kufirin e Impiantit;

**"MW"** nënkupton megavat;

**"MWh"** nënkupton megavat orë;

**"Diferenciali Negativ i Çmimit"** ka kuptimin e dhënë në nenin 16.1.(c);

**"Periudha e Çmimit Negativ"** nënkupton një periudhë përgjatë së cilës Çmimi i Referencës (Çmimi orar i Tregut të Ditës në Avancë") është më pak se 0.00 Euro/MWh;

**"Rast i Zgjidhjes Pa Faj"** ka kuptimin e dhënë në nenin 17.3;

**"Prodhimi i Nominuar"** nënkupton të gjithë Prodhimin e Mbështetur i cili është nominuar ose konsiderohet i nominuar nga Shitësi për shitje dhe livrim tek Pala Kontraktuese për Mbështetje në përputhje me nenet 7 dhe 8;

**"Ndryshim i Pa-pranuar"** ka kuptimin e dhënë në nenin 17.2(i);

**"Vlerësimi Zyrtar i Kredisë"** nënkupton një vlerësim kredie (lidhur me huanë afat-gjatë, të pasiguruar, të pandërvarur) nga:

(a) Standard and Poor's;

(b) Moody's; ose

(c) një agjenci vlerësimi alternative e njohur në industri ose pasuese e njërës prej sa më sipër, e njohur nga industria (e dakordësuar nga Palët ku një marrëveshje e tillë të mos mbahet ose të vonohet pa arsye);

**"Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare"** nënkupton autoritetin rregullator të tregjeve financiare në Republikën e Shqipërisë në përputhje me Ligjin për Tregjet a Kapitalit;

**"Kushti i** Palës Kontraktuese për Mbështetje**"** ka kuptimin e dhënë në nenin 3.2;

**"Mospërmbushje nga ana e Palës Kontraktuese për Mbështetje "** ka kuptimin e dhënë në nenin 17.1.;

**"Humbja e Palës Kontraktuese për Mbështetje"** nënkupton humbjen e pësuar nga Pala Kontraktuese për Mbështetje me zgjidhjen e kësaj Marrëveshje për shkak të Mospërmbushjes nga ana e Shitësit që mbulon:

(a) në rast të zgjidhjes sipas nenit 17.2(a) ose nenit 17.2(b) kostot e brendshme dhe të jashtme të Palës Kontraktuese për Mbështetje të lidhura me angazhimin me Shitësin në përputhje me këtë Marrëveshje sipas parashikimit që do të përmbushen Kushtet e Shitësit;ose

(b) në rast të zgjidhjes sipas nenit 17.2.(c) deri 17.2(h)

  (i) për Periudhë e Tregtimit I, kostot e zëvendësimit të lidhura me kryerjen e transaksioneve zëvendësuese për energjinë elektrike të palivruar (së bashku me kostot apo shpenzimet lidhur me to);me kusht që këto kosto të jenë demonstruar me prova të arsyeshme dhe dhe dokumentacion të mjaftueshëm

  (ii) për Periudhën e Tregtimit II, humbjen e pësuar nga mos-pagesa e Pagesave të Diferencialit që Pala për Mbështetje do të kishte pritur në mënyrë të arsyeshme që Shitësi do të kishte paguar sipas kësaj Marrëveshje palivruar (së bashku me kostot apo shpenzimet lidhur me to), me kusht që këto humbje që përcaktohen në bazë të parashikimeve dhe projeksioneve të arsyeshme të cmimeve te referencës së tregut dhe me kusht që këto të jenë demonstruar me prova të arsyeshme dhe dokumentacion të mjaftueshëm;

(c) me kusht që Pala Kontraktuese për Mbështetje të ketë pësuar një humbje direkte dhe të demonstrueshme e cila nuk është kompensuar plotësisht me kompensimin për zgjidhje sipas Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit, dhe;

(d) me kusht që kompensimi total ndaj Autoritetit Kontraktues sipas Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit dhe ndaj Palës Kontraktuese për Mbështetje sipas kësaj Marrëveshje nuk tejkalon një shumë maksimale që i korrespondon shumës së Sigurimit të Marrëveshjes.

**"Periudha Operacionale"** nënkupton periudhën që fillon në orën 00:00 të ditës së parë që pason menjëherë Datën e Operimit Tregtar dhe përfundon me mbarimin e Afatit ose zgjidhjen para afatit të kësaj Marrëveshje në përputhje me kushtet e saj;

**"OST"** nënkupton [Operatori i Sistemit të Transmetimit SHA], një shoqëri e themeluar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e cila zotëron dhe operon Rrjetin e Transmetimit, duke përfshirë pasuesit e saj të lejuar të përgjithshëm dhe përfituesit e transferimit të saj të lejuar;

**"OSSH"** nënkupton [Operatori i Sistemit të Shperndarjes SHA], një shoqëri e themeluar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e cila zotëron dhe operon Rrjetin e Shperndarjes, duke përfshirë pasuesit e saj të lejuar të përgjithshëm dhe përfituesit e transferimit të saj të lejuar;

**"Ndërprerje e Energjisë"** nënkupton një periudhë të vazhdueshme prej të paktën [dy (2) orësh] gjatë së cilës Kapaciteti i Impiantit ulet me dhjetë për qind (10%) ose më shumë;

**"Garancia e Pronarit"** nënkupton një garanci, materialisht në formën e specimenit të garancisë bashkëlidhur si Shtojca 2, që mbulon një shumë maksimale të njëjtë me Shumën e Mbështetjes së Kredisë;

**"Programi i Ndërprerjeve të Planifikuara"** ka kuptimin e dhënë në nenin 7.17 dhe siç është i shtjelluar më hollësisht në Kodin Shqiptar të Rrjetit të Transmetimit;

**"Kriteret Financiare të Garancisë të Performancës"** nënkupton normat e EBIT në lidhje me Interesin, Fondet nga Operimet, Borxhi Total kundrejt Kapitalizimit Total, dhe Vlera Neto Materiale;

**"Projekt"** ka kuptimin e dhënë në Pjesën Hyrëse A;

**"Marrëveshja për Zhvillimin e Projektit"** nënkupton marrëveshjen për zhvillimin e Projektit, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë dhe [Ofertuesit][Konsortiumit] [■] dhe, Shitësit, pas krijimit të tij;

**"Rregullat Balancimit"** nënkupton "rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020;

**"Diferenciali i Çmimit"** ka kuptimin e dhënë në nenin 11.1;

**"Nominimi i Përkohshëm i Prodhimit"** ka kuptimin e dhënë në nenin 7.4. i zbatuar në kombinim me nenin 7.6.

"**Diferenciali Pozitiv i Çmimit**" ka kuptimin e dhënë në nenin 16.1(b);

**"Marrëveshja për Blerjen e Energjisë"** ose **"PPA"** nënkupton marrëveshjen për blerjen e energjisë elektrike midis Shitësit dhe Palës Kontraktuese për Mbështetje, që do të zbatohet gjatë Periudhës së Tregtimit I, sipas zbatimit përkatës, derisa një Vlerësim Pozitiv i Gadishmërisë së Tregut të jetë kryer, për shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga Impianti në përputhje me kushtet dhe termat në Seksionin (B).

**"Vlerësim Pozitiv i Gadishmërisë së Tregut"** nënkupton vendimin e marrë nga ERE që përcakton që Kritetret e Gadishmërisë së Tregut pas kryerjen së Vlerësimit të Gadishmërisë së Tregut, janë plotësuar dhe ky vendim është konfirmuar nga Një Deklaratë e Përbashkët e Palëve në përputhje me nenin 6.1.(a)(iii) ose cdo mosmarrëveshje e palëve në lidhje me këtë vendim është zgjidhur në përputhje me termat e nenin 6.1.(a)(iv) të kësaj Marrëveshje.

**"Kthimi mbi Investimin "** nënkupton një shumë të barabartë me Shumën e Zhvlerësuar të Kapitalit e mbledhur [ ] (%)për një periudhë nga Data e Afatit Përfundimtar të Operimit Tregtar deri në më të parën nga: i) Data e Përfundimit ose (ii) [ ]vjet nga Data e Afatit Përfundimtar të Operimit Tregtar;[1]

**"Matja Referencë"** nënkupton [ ][2]

**"Çmimi i Referencës"** nënkupton çmimin orar të tregut të ditës në avancë për periudhën përkatëse të shlyerjes, i percaktuar dhe publikuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë (ALPEX),

[1] Që do të përcaktohet në bazë të të dhënave të përfshira nga Ofertuesi i Përzgjedhur në Studimin e Pre-Fizibilitetit pjesë e Propozimit të tij KPP.

[2] Që do të përcaktohet në bazë të të dhënave të përfshira nga Ofertuesi i Përzgjedhur në Studimin e Pre-Fizibilitetit pjesë e Propozimit të tij KPP.

ose, në rast mos-gadishmërie të Bursës Shqiptare e Energjisë (ALPEX), nga Indeksi Zëvendësues;

**"Prodhimi Përkatës"** nënkupton:

(a) në rastin kur Impianti është pjesë e Grupit të Balancimit të Palës Kontraktuese për Mbështetje në përputhje me nenin 7.8(a) dhe/ose në rast se Pala Kontraktuese për Mbështetje siguron që një palë e tretë të operojë një Grup Balancimi sipas nenit 7.8(b), Prodhimin e Mbështetur A;

(b) në rast se Shitësi zgjedh Grupin e Balancimit të një pale tjetër në përputhje me nenet 7.13 deri 7.14, Prodhimin e Mbështetur B;

"**Vlerësimi i Kërkuar i Bankës**" nënkupton:

(a) në lidhje me vlerësimin e Standard and Poor's, një vlerësim të paktën A- apo i barasvlershëm me të;

(b) në lidhje me vlerësimin e Moody's, një vlerësim të paktën A3 apo i barasvlershëm me të; ose

(c) në lidhje me një vlerësim nga çdo agjenci vlerësimi alternative e njohur në industri ose pasuese e njërës prej sa më sipër, vlerësimin përkatës të barazvlershëm me të (e dakordësuar nga Palët ku një marrëveshje e tillë të mos mbahet ose të vonohet pa arsye);

**"REMIT"** nënkupton Legjislacionin e Zbatueshëm të adoptuar nga Autoritetet Kompetente që transpozon dhe zbaton Rregulloren (BE) Nr. 1227/2011 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, të datës 25 tetor 2011 mbi integritetin dhe transparencësn e tregjeve të shumicës së energjisë elektrike dhe/ose cdo EU *acquis* tjetër të lidhur me zbatimin e saj;

**"Operatori i Energjisë së Rinovueshme"** nënkupton palën tjetër në kontratat për diferencë i përcaktuar në përputhje me Ligjin Nr. 4/2023 për "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", i ndryshuar.

**"Rasti i Revokimit"** nënkupton një rast kur:

(a) Përfitimi i Gjenerimit është lëshuar, marrë ose përllogaritur më herët, dhe më pas është revokuar apo deklaruar si në konflikt me Legjislacionin e Zbatueshëm nga një Autoritet Kompetent ose ndryshe është anulluar;

(b) çdo transferim i Përfitimit të Gjenerimit është i pavlefshëm ose i pazbatueshëm pasi Përfitimi i Gjenerimit i cili ishte subjekt i transferimit të supozuar ishte subjekt i një tarife, detyrimi, barre ose pretendimi nga të tretët;

(c) Autoriteti Lëshues përkatës, një Autoritet tjetër Kompetent ose OST refuzon të lëshojë ose të vërë në dispozicion Përfitimin e Gjenerimit (ose nuk lejon që të merret ose të akumulohet apo regjistrohet) kur secila Palë beson në mënyrë të arsyeshme se Impianti, energjia elektrike e prodhuar nga Impianti, ose secila Palë (sipas rastit) ka të drejtën e Përfitimit të Gjenerimit (ose do të kishte pasur të drejtën nëse secila Palë do të kishte respektuar detyrimet e saj sipas këtaj Marrëveshjeje); ose

(d) Autoriteti Kompetent përkatës (duke përfshirë Autoritetin Lëshues) ose OST i kërkon përfituesit që të mos përftojë, anulojë apo përdorë Përfitimin e Gjenerimit dhe si

rezultat përfituesi nuk ka përftuar Përfitimin e Gjenerimit në datën kur Përfitimi i Gjenerimit mund të përftohej në mënyrë të arsyeshme;

"**Sezon**" nënkupton një periudhë gjashtë (6) mujore që përfundon më 31 mars ose 30 shtator të çdo viti;

"**Kufi Sezoni**" nënkupton ka kuptimin e dhënë në nenin 5.2;

**[*SPV SUBJEKTI PËR QËLLIME TË VEÇANTA*]** një shoqëri [ ] e themeluar në Shqipëri, me nr. regjistrimi [ ] dhe me seli [ ] ;

**"Programi"** nënkupton ato veprime të nevojshme për një Palë për të kryer detyrimet përkatëse të livrimit ose pranimit, të cilat mund të përfshijnë nominimin, programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me Palën tjetër, agjentët përkatës të caktuar të tyre dhe përfaqësuesit e autorizuar, dhe OST-në, sipas rastit, të Prodhimit të Nominuar, Pikës së Matjes dhe çdo përcaktimi tjetër përkatës të kësaj Marrëveshje në përputhje me të gjitha rregullat e zbatueshme të OST-së dhe praktika dhe procedura të tjera të zakonshme të industrisë, dhe "**Të Programuara**" dhe shprehje të tjera të afërta do të interpretohen përkatësisht;

**"Kushtet e Shitësit"** ka kuptimin e dhënë në nenin 3.1;

**"Mospërmbushja nga ana e Shitësit"** ka kuptimin e dhënë në nenin 17.2;

**"Humbja e Shitësit 1"** nënkupton:

(a) një shumë të barasvlershme me:

  (i) të gjitha borxhet dhe ripagimi i interesave të zbatueshëm (duke përfshirë të gjitha detyrimet për shlyerjen e parakohshme, për shkeljet, penalitetet, pasojat e kursit të këmbimit) që Shitësi i detyrohet Institucioneve Financiare (qofshin këto të lidhura me borxh të vjetër apo të ri, me garanci apo pa garanci) për financimin e Kapacittetit, plus

  (ii) Një shumë e barabartë me Kthimin e Investimit për cdo vit dhe Shuma e Kapitalit të Zhvlerësuar [e mbledhur për një periudhë të barabartë me më te ulëtën e: (i) 18 muaj ose (ii) pjesa e mbetur e periudhës origjinale së kësaj Marrëveshje, minus

  (iii) çdo të ardhur nga sigurimi e marrë nga Shitësi pëepara datës së zgjidhjes së kësaj Marrëveshje dhe që nuk është shpenzuar akoma për restaurimin e Impiantit; minus

  (iv) shumën e parave në të holla të mbajtura nga ose në emër të Shitësit nga data e zgjidhjes së kësaj Marrëveshje, duke përfshirë para në të holla dhe balancën e llogarisë të çdo depozite të tillë, të letrave me vlerë, llogaritë rezervë ose të garancive;

(b) e cila bëhet e pagueshme nëse Impianti nuk është duke u përdorur ne cfarëdo mënyrë tjetër në tregun e lirë.

"**Humbja e Shitësit 2**" nënkupton humbjen e pësuar nga Shitësi me rastin e zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje për Mospërmbushje nga ana e Palës Kontraktuese për Mbështetje dhe vazhdimin e operimit të Impiantit në treg të lirë, duke mbuluar:

(a) për periudhën e Tregtimit I, kostot e brendshme dhe të jashtme të Shitësit të lidhura me angazhimin me një palë kontraktuese për mbështetje zëvendësuese për Kapacitetin e Mbështetur, duke përfshirë kostot e lidhura më rifinancimin e borxhit nga Institucionet Financiare, gjithmonë sipas kërkesës që këto kosto duhet të jenë të demostrueshme, sipas provave dhe dokumentacionit të arsyeshëm, ose

(b) për periudhën e Tregtimit II kostot e brendshme dhe të jashtme të Shitësit të lidhura me angazhimin e një pale private apo një pale kontraktuese tjetër për zëvendësimin e marrëveshjes së shlyeshme financiarisht për të zëvendësuar elementin e mbështetjes CfD për Kapacitetin e Mbështetur, duke përfshirë kostot e lidhura më rifinancimin e borxhit nga Institucionet Financiare, gjithmonë sipas kërkesës që këto kosto të jenë të vërteta, të demostrueshme, të lidhura drejpërdrejt me angazhimin e këtaj pale kontraktuese zëvendësuese për Kapacitetin e Mbështetur, dhe me kushtin që të provohen sipas provave dhe dokumentacionit të arsyeshëm.

**"Ofruesi i Shërbimit"** nënkupton një ofrues shërbimi që ka një histori përvoje me (i) shërbimin e tipit makinerive fotovoltaike së instaluara në tokë, të përdorura në Impiant; (ii) shërbimin e të paktën xxx MW kapacitet i instaluar deri në xxx MW Kapacitet i Mbështetur kapacitet të instaluar; dhe i cili ka besueshmërinë e nevojshme për të paguar garancinë e disponueshmërisë sipas Marrëveshjes së Shërbimit dhe Disponueshmërisë;

**"Marrëveshja e Shërbimit dhe Disponueshmërisë"** nënkupton marrëveshjen e shërbimit dhe disponueshmërisë lidhur ndërmjet Shitësit dhe Ofruesit të Shërbimit në lidhje me shërbimin, operimin ose mirëmbajtjen e Impiantit;

**"Vendndodhje"** nënkupton tokën e përzgjedhur nga Shitësi dhe të ndodhur në [ ] Shqipëri dhe që përshkruhet dhe kufijtë e së cilës përcaktohen më tej në [Shtojcën 1] dhe ku do të ndodhet Impianti;

"**Periudha e Furnizimit**" nënkupton periudhën që fillon nga Data e Fillimit të Kolaudimit dhe mbaron me përfundimin e Afatit apo me zgjidhjen para afatit të kësaj Marrëveshjeje sipas përcaktimeve të saj;

"**Marrëveshja për Mbështetje**" ose "**Marrëveshja**" nënkupton këtë marrëveshje që përfshin termat për Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë të shlyer fizikisht për Periudhën e Tregtimit I dhe termat e CfD të shlyer financiarisht për Periudhën e Tregtimit II.

"**Pala Kontraktuese për Mbështetje**" nënkupton palën kontraktuese të përcaktuar në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Marrëveshjen për Mbështetje, për të vepruar si blerës në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë të shlyer fizikisht për Periudhën e Tregtimit I, ose si palë kontraktuese CfD në Kontratën për Diferencë të shlyer financiarisht për Periudhën e Tregtimit II, dhe të cilës i zbatohen termat e përgjithshëm të kësaj Marrëveshje përgjatë gjithë Afatit të Marrëveshjes për Mbështetje, në kombinim ose me termat e MB-së për Periudhën Tregtare I ose me termat CfD për Periudhën Tregtare II;

**"Prodhim i Mbështetur A"** ka kuptimin e dhënë në nenin 8.2.(a)(i)(A);

**"Prodhim i Mbështetur B"** ka kuptimin e dhënë në nenin 8.2 (a)(i)(B);

**"Vlera Neto Materiale"** nënkupton shumën e të gjitha kontributeve në para të aksionarëve në llogarinë e kapitalit aksionar e apo në çdo llogari kapitali tjetër të Palës Kontraktuese për Mbështetje ose të një subjekti tjetër të caktuar si zëvendësues i Palës Kontraktuese për Mbështetje për këto qëllime të Palës Kontraktuese për Mbështetje dhe çdo fitim të akumuluar

minus çdo humbje të akumuluar të mbajtur dhe asete jomateriale (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, emrin e mirë);

**"Tatim"** nënkupton çdo tatim, taksë, sekuestro, detyrim, honorar ose pagesë ose mbajtje tjetër e një natyre të ngjashme (duke përfshirë çdo penalitet ose interes që duhet paguar në lidhje me ndonjë rast mos-pagimi ose ndonjë vonesë në pagimin e ndonjerës ose të njëjtë me të) përfshirë tatimin mbi të ardhurat dhe tatimin mbi fitimin;

**"Afat"** nënkupton periudhën që fillon në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe përfundon pesëmbëdhjetë [(____) vjet] pas Datës së Operimit Tregtar;

**"Kapitalizimi Total"** nënkupton në lidhje me periudhën përkatëse shumën e Borxhit Total dhe të gjithë kontributet në para të aksionarëve të paguar në llogarinë e kapitalit të shoqërisë ose ndonjë llogari tjetër kapitali të Palës Kontraktuese për Mbështetje ose të një subjekti tjetër të caktuar si zëvendësues i Palës Kontraktuese për Mbështetje për këto qëllime të Palës Kontraktuese për Mbështetje;

**"Borxhi Total"** nënkupton në lidhje me periudhën përkatëse shumën e borxhit financiar për paratë e huazuara (që përfshin borxhet e pagueshme ndaj Shoqërive të Lidhura si dhe instrumentet e borxhit ndaj Institucioneve Financiare) të Palës Kontraktuese për Mbështetje apo çdo subjekti tjetër të caktuar si zëvendësues i Palës Kontraktuese për Mbështetje;

**"Borxhi Total kundrejt Kapitalizimit Total"** nënkupton raportin e Borxhit Total ndaj Kapitalizimit Total në çdo vit fiskal;

"**Kostoja Totale e Projektit**" nënkupton [ ][3];

"**Periudhë Tregtare I**" ka kuptimin e dhënë në nenin 6.1(a);

"**Periudhë Tregtare II**" ka kuptimin e dhënë në nenin 6.1(a);

" **Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje** " ka kuptimin e dhënë në nenin 6.3;

**"Linja e Transmetimit"** ka kuptimin e dhënë nw Dokumentat KPP;

**"Gjenerimi i Padisponueshëm"** nënkupton gjenerimin e pritshëm (në MWh) të përllogaritur sipas Matjes Referencë e zbatueshme gjatë secilës Periudhë Padisponueshmërie për Impiantin me panele diellore (s) përgjatë një Sezoni;

**"Periudha e Padisponueshmërisë"** nënkupton çdo periudhë, përveç Periudhës së Konsideruar si e Disponueshme, gjatë së cilës impiantet me panele diellore nuk janë në operim ose u reduktohet fuqia. Për shmangien e çdo dyshimi, çdo mirëmbajtje e programuar e kryer në Impiant do të konsiderohet si një Periudhe Padisponueshmërie;

**"Ndërprerja e Paplanifikuar"** ka kuptimin e dhënë në nenin 7.20 dhe të përcaktuar sipas Kodit Shqiptar të Rrjetit të Transmetimit;

**"Sjellje e Paligjshme me Dashje"** nënkupton një veprim ose mosveprim të qëllimshëm që devijon nga rrjedha e arsyeshme e veprimit ose nga një dispozitë e marrëveshjes i cili kryhet

[3] Që do të përcaktohet në bazë të të dhënave të përfshira nga Ofertuesi i Përzgjedhur në Studimin e Pre-Fizibilitetit pjesë e Propozimit të tij KPP.

ose nuk kryhet duke patur dijeni apo duke injoruar me ndërgjegje ose me qëllim pasojat e dëmshme, të shmangshme dhe të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme; dhe

**“Rinominim Brenda Ditës GCT”** ka kuptimin e dhënë në nenin 7.3(b);

“**Vit**” nënkupton një periudhë dymbëdhjetë (12) mujore që nis më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

1.2 Në këtë Marrëveshje, vetëm nëse konteksti e kërkon ndryshe:

(a) njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas;

(b) një referencë për një gjini nuk do të përjashtojë gjinitë e tjera;

(c) fjalët për personat përfshijnë personat fizikë, organet e shoqërive, shoqatat dhe ortakëritë e paregjistruara (pavarësisht nëse ndonjëri prej tyre ka ose jo një personalitet të veçantë juridik);

(d) referenca për çdo dispozitë ligjore do të konsiderohet se përfshin çdo akt ligjor, nënligjor, rregullore, rregull, legjislacion sekondar ose nënligjor ose urdhër dhe rregulla dhe rregullore në bazë e për zbatimin e tij dhe çdo ri-miratim ose ndryshim të mëvonshëm të tij;

(e) fjalët "përfshirë", "të tjera", "në veçanti", "për shembull" dhe fjalë të ngjashme nuk do të kufizojnë përgjithësinë e fjalëve të mëparshme dhe do të interpretohen sikur ato të pasoheshin menjëherë nga fjalët "pa kufizim";

(f) referencat tek "me shkrim" përfshijnë shtypjen, printimin, transmetimin elektronik dhe faksimil dhe mënyrat e tjera të prodhimit ose riprodhimit të fjalëve në një formë të dukshme dhe shprehjet që referojnë tek shkrimi do të interpretohen sipas rastit;

(g) titujt e seksioneve dhe shtojcave, përmbajtja dhe faqja e parë janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin ose kuptimin e kësaj Marrëveshjeje;

(h) përveç kur parashikohet ndryshe, referencat tek nenet dhe shtojcat janë referenca tek nenet dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje, dhe referencat në çdo shtojcë tek paragrafët, pjesët dhe anekset, përveç nëse parashihet ndryshe, janë referenca tek paragrafët, pjesët dhe anekset e shtojcës ose pjesës së shtojcës ku shfaqen këto referenca;

(i) referencat tek kjo Marrëveshje janë referenca tek kjo Marrëveshje të ndryshuara ose të modifikuara herë pas here; dhe

(j) referenca tek një marrëveshje, kontratë, dokument ose akt do të interpretohet si një referencë tek kjo, siç është ndryshuar, plotësuar apo me shtesa herë pas here.

1.2 Shtojcat 6 dhe çdo aneks dhe shtesë janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

## (A) – TERMAT E PËRGJITHSHËM

## 2. FILLIMI DHE AFATI

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit dhe mbetet në fuqi deri në mbarimin e Afatit të saj përveç rastit kur zgjidhet përpara afatit sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

## 3. KUSHTET

3.1 Shitësi do të:

(a) lidhë Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit me Autoritetin Kontraktues;

(b) të përmbushë Kushtet e Zhvilluesit sic janë përcaktuar në nenin 2.12 të Marrëveshjes së Zhvillimit të Projektit sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë të aryeshme pas Datës së Hyrjes në Fuqi dhe në cdo rast jo më vonë se Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve.

(së bashku **"Kushtet e Shitësit"**).

3.2 Pala Kontraktuese për Mbështetje do të sigurojë Mbështetjen e Kredisë në favor të Shitësit në përputhje me kërkesat e nenit 21 ("**Kushti i Palës Kontraktuese për Mbështetje** ").

3.3 Secila Palë do të përmbushë kushtet përkatëse të saj të përcaktuara më sipër sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur pas Datës së Hyrjes në Fuqi dhe, në çdo rast, jo më vonë se Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve.

3.4 Në datën në të cilën Shitësi vihet në dijeni që një ose më shumë nga Kushtet e Shitësit është përmbushur, Shitësi do të njoftojë me shkrim Palën Kontraktuese për Mbështetje dhe do t'i paraqesë Palës Kontraktuese për Mbështetje provën që tregon këtë përmbushje siç do të kërkohet nga Pala Kontraktuese për Mbështetje në mënyrë të arsyeshme.

3.5 Palët pranojnë dhe njohin se Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve do të ndryshojë vetëm në rrethanat e mëposhtme:

(a) kur Shitësi dhe Pala Kontraktuese për Mbështetje bien dakord bashkërisht me shkrim për një datë tjetër si Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve në përputhje me Marrëveshjen për Zhvillimit e Projektit, ose

(b) kur Shitësi nuk mund të përmbushë një ose më shumë nga Kushtet e Zhvilluesit në ose përpara Datës së Afatit Përfundimtar të Kushteve në rastet apo rrethanat e përcaktuara në nenin 2.15 të Marrëveshjes për Zhvillimit e Projektit,

ku në këtë rast data përkatëse do të jetë e dakordësuar me shkrim nga Zhvilluesi dhe Autoriteti Kontraktues ose sic është shtyrë për një periudhë kohore sa periudha e vonesës për përmbushjen e Kushteve përkatëse të Zhvilluesit të shkaktuar nga këto ngjarje apo rrethana, që bien në fushën e zbatimit dhe në përputhje me nenin 2.15 të Marrëveshjes për Zhvillimit e Projektit ("**Data e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve**"). Në këto rrethana referencat në këtë Marrëveshje tek Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve të Marrëveshjes do të lexohen si referenca tek Data e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve. Në datën të cilën Zhvilluesi vihen në dijeni të Datës së Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve, ai duhet të njoftojë më shkrim Palën Kontraktuese për Mbështjetje dhe t`i paraqesë Palës Kontraktuese për Mbështjetje prova të arsyeshme sipas kërkesës së Palës Kontraktuese për Mbështjetje.

3.6 Çdo mosmarrëveshje apo konflikt lidhur me zgjatjen kohore sipas së cilës duhet të shtyhet Data e Afatit Përfundimtar të Kushtit sipas nenit 3.5. do të trajtohet në përputhje me nenin 21.

**4. NDËRTIMI DHE KOLAUDIMI**

4.1 Shitësi do të njoftojë Palën Kontraktuese për Mbështetje me shkrim për:

(a) parashikimin më të mirë të mundshëm kur pret të ndodhë Data e Fillimit të Kolaudimit sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur pas përmbushjes së Kushteve të Shitësit;

(b) parashikimin më të mirë të mundshëm të datës kur parashikon ndodhjen e Datës së Operimit Tregtar sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur; dhe

(c) ndodhjen e Datën së Operimit Tregtar, pa vonesë kur kjo ndodh.

4.2 Shitësi do të njoftojë Palën Kontraktuese për Mbështetje me shkrim kur merr dijeni se Data e Operimit Tregtar nuk do të realizohet përpara ose në Datën e Synuar të Operimit Tregtar, njoftim i cili përfshin Datën e Synuar të Operimit Tregtar të rishikuar .

**5. OPERIMI, GARANCIA E DISPONUESHMËRISË**

5.1 Shitësi do të operojë dhe mirëmbajë Impiantin në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, Kodet dhe Rregullat përkatëse dhe Praktikat e Mira të Industrisë, me qëllimin që të maksimizojë disponueshmërinë e Impiantit dhe Prodhimit të Matur. Me kushtin që Shitësi të përmbushë të gjitha detytimet në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, Kodet dhe Rregullat përkatëse dhe Praktikat e Mira të Industrisë, Shitësi duhet të takohet të paktën një (1) herë cdo gjashtë (6) muaj me Palën Kontraktuese për Mbështetje për të diskutuar cështjet tregare dhe operacionale të lidhura me Impiantin.

5.2 Nëse, në çdo Vit të plotë gjatë Periudhës së Furnizimit, Prodhimi i Matur i Impiantit është më pak se [ ] (%) ("**Objektivi i Disponueshmërisë Energjetike**") dhe Prodhimi i Matur mujor është më pak se [ ] e prodhimit të parashikuar të Impiantit për Sezonin përkatës bazuar në profilet mujore të përcaktuar sipas Shtojcës 5 të kësaj Marrëveshjeje ("**Objektivi i Sezonit**") (të dy objektivat referuar së bashku si "**Garancia e Disponueshmërisë**") do të konsiderohet se ka ndodhur një rast dëmshpërblimit për padisponueshmëri ("**Rasti i Dëmshpërblimit për Padisponueshmëri**"). Shitësi duhet të lidhë një Marrëveshje për Shërbimin dhe Disponueshmërinë brenda datës [ ]. Palët duhet të përcaktojnë Objektivin e Disponueshmërisë Energjetike dhe Objektivin e Sezonit, si dhe të plotësojnë Shtojcën 3 në përputhje me Marrëveshjen për Shërbimin dhe Disponueshmërinë.

5.3 Në përputhje me nenin 5.2., nëse ka ndodhur një Rast i Dëmshpërblimit për Padisponueshmëri, Shitësi i paguan Palës Kontraktuese për Mbështetje dëmet e likuiduara në shumën prej [ ] për çdo MWh të Prodhimit Përkatës të palivruar kundrejt Garancisë së Disponueshmërisë dhe sipas kufizimeve në nenin 5.2 ("**Dëmet e Likuiduara të Disponueshmërisë Energjetike**"), sa më shpejt që të jetë e praktikisht mundur pas përfundimit të çdo Viti. Kur ndodh një Rast i Dëmshpërblimit për Padisponueshmëri, Shitësi i paraqet Palës Kontraktuese për Mbështetje një njoftim me shkrim lidhur me këtë. Palët do të plotësojnë Shtojcën 4 në përputhje me Marrëveshjen e Shërbimit dhe Disponueshmërisë.

5.4 Dëmet e Likuiduara të Disponueshmërisë Energjetike lidhur me secilin Vit:

(a) do të kenë një tavan maksimal për vit në përputhje me formulën dhe tabelën në Shtojcën 4; dhe

(b) do të jenë i vetmi dëmshpërblim për Palën Kontraktuese për Mbështetje për ngjarjen e Rastit të Dëmshpërblimit për Padisponueshmëri, duke përjashtuar dëmshpërblime të tjera sipas kontratës, ligjit apo tjetër bazë.

## 6. RI-ORGANIZIMI I TREGUT DHE VLERËSIMI I GATISHMËRISË

6.1 Palët pranojnë dhe bien dakord se tregu shqiptar i energjisë elektrike është në procesin e ristrukturimit të vazhdueshëm të tregut dhe si rrjedhojë e këtij ristrukturimi:

(a) Një Vlerësimi Pozitiv i Gatishmërisë së Tregut duhet përfunduar nga ERE dhe është një kush paraprak për zbatimin Kushteve të Kontratës për Diferencë në përputhje me këtë Marrëveshje. Duke filluar që nga Data e Hyrjes ne Fuqi deri në Ditën e njëzet (20-të) të Punës (të përfshirë) pas nënshkrimit të Deklaratës së Përbashkët që pranon rezultatin e një Vlerësimi Pozitiv i Gatishmërisë së Tregut, ("**Periudha e Tregtimit I**"), Kushtet dhe Termat e MBE do të zbatohen. Në ditën e njëzet e një (21-të) pas nënshkrimit të Deklaratës së Përbashkët që pranon rezultatin e një Vlerësimi Pozitiv i Gatishmërisë së Tregut deri në përfundim të Afatit ("**Periudha e Tregtimit II**"), Kushet dhe Termat CfD do të zbatohen. Palët duhet të përcaktojnë fillimin e **Periudhës së Tregtimit I** dhe kalimin nga zbatimi i Termave të MBE-së tek zbatimi i Termave të CfD-së në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë nen dhe Deklaratën e Përbashkët.

(i) ERE duhet të kryjë një Vlerësimi të Gatishmërisë së Tregut duke u bazuar në të paktën Kriteret e paracaktuara në këtë Marrëveshje, Legjislacionin e Zbatueshëm dhe në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë.

(ii) Pala Kontraktuese për Mbështetje duhet t`i dërgojë një njoftim Shitësit për ta njoftuar për fillimin e procedurave nga ERE për Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut dhe duhet të bëjë përpjekjet më të mira për të siguruar që Shitësi të ftohet për të paraqitur këndvështrimin e tij në lidhje me Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut, në formë të shkruar dhe në një dëgjesë përpara ERE.

(iii) Pala Kontraktuese për Mbështetje duhet t`i dërgojë një njoftim Shitësit për ta njoftuar për cdo vendim pozitiv të marrë nga ERE, që përcakton se Kriteret për Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut pas një procedure Vlerësimi të Gatishmërisë së Tregut janë plotësuar, brenda pesë (5) Ditë Pune nga marrja e dijenisë mbi këtë vendim. Palët duhet, në mirëbesim, të diskutojnë dhe darkordësojnë nëse rezultatet e Vlerësimit të Gatishmërisë së Tregut janë të pranueshme për to në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë dhe Legjislacionin e Zbatueshëm. Me këtë qëllim, Palët duhet të përpilojnë një raport me shkrim duke evidentuar qëndrimin e tyrë në lidhje me Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut. Në rast të dakordësimit mbi vendimin pozitiv të ERE mbi Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut, palët duhet të nënshkruajnë një deklaratë të përbashkët duke pranuar rezultatin ("**Deklaratë e Përbashkët**") (një vendim i tillë pozitiv i marrë nga ERE në këtë kontekst, dhe i konfirmuar nga një Deklaratë e Përbashkët referuar si "**Vlerësimi Pozitiv i Gatishmërisë së Tregut**").

(iv) Cdo mosmarrëveshje e Palëve në lidhje me kriteret dhe rezultatet e Vlerësimit të Gatishmërisë së Tregut ("**Mosmarrëveshje në lidhje me Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut**") duhet të zgjidhet me Përcaktim Eksperti dhe më tej duke zbatuar nenin 28. Në rast mosmarrëveshje kundrejt ERE, Palët duhet të

bëjnë përpjekje në mirëbësim për të arritur një marrëveshje mbi një pozicion të përbashkët, dhe atëherë kur është e mundur, të kundërshtojnë vendimin e ERE përpara gjykatave kompetente dhe organizatave ndërkombëtare në përputhje me Legislacionin e Zbatueshëm.

(v) Për hir të qartësisë, për sa kohë një Mosmarrëveshje në lidhje me Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut ekziston dhe nuk është zgjidhur në përputhje me këtë Marrëveshje, do të konsiderohet se Periudha e Tregtimit I vazhdon dhe Marrëveshja për Mbështetje do të zbatohet si Marrëveshje për Blerjen e Energjisë Elektrike.

(vi) Brenda njëzet (20) Ditë Pune pas nënshkrimit të një Deklarate të Përbashkët, Palët duhet të ndërmarrin të gjitha hapat dhe masat e nevojshme për të kaluar nga Periudha e Tregtimit I në Periudhën e Tregtimit II, dhe, për pasojë, nga zbatimi i Termave të MBE-së në zbatimin e Termave të CfD-së.

(b) Pala Mbështetëse mund të caktojë një palë kontraktuese të transferuar në përputhje me këtë nen dhe Legjislacionin e Zbatueshëm.

6.2 Pala Kontraktuese për Mbështetje mund t'ia transferojë këtë Marrëveshje pa pëlqimin e Shitësit një Furnizuesi të Licensuar, Operatorit të Energjisë së Rinovueshme ose një subjekti tjetër të caktuar nga një Autoritet Kompetent për të vepruar si pala tjetër e kësaj Marrëveshjeje ("**Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje**"). Pala Kontraktuese për Mbështetje do të njoftojë Shitësin për datën dhe kohën kur do të hyjë në fuqi transferimi i kësaj Marrëveshjeje tek Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje. Pas kësaj date dhe kohe, (a) sipas neneve 6.3 dhe 5.8 siç mund të zbatohen, Pala Kontraktuese për Mbështetje do të shkarkohet nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe (b) Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje do të marrë përsipër të gjithë detyrimet e Palës Kontraktuese për Mbështetje sipas kësaj Marrëveshjeje (të gjitha referencat lidhur me "**Palën Kontraktuese për Mbështetje**" në këtë Marrëveshje do të interpretohen si referenca lidhur me "**Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje** ").

6.3 Në rast të transferimit sipas nenit 6.2 më sipër:

(a) Palës Kontraktuese për Mbështetje transferuese përmbush të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje deri sa Blerësi i Ri të hyjë në këtë Marrëveshje si Blerësi;

(b) Palës Kontraktuese për Mbështetje transferuese dhe Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje përgjigjen solidarisht dhe individualisht përkundrejt Shitësit për të gjithë detyrimet e Palës Kontraktuese për Mbështetje të cilat kanë lindur përpara transferimit;

(c) në rast se dhe për sa kohë që Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje nuk përmbush të njëjtat Kritere Financiare të Garancisë së Performancës si PalaKontraktuese për Mbështetje transferuese ose ka një Vlerësim Zyrtar Kredie më të ulët se Vlerësimi Zyrtar i Kredisë së Palës Kontraktuese për Mbështetje transferues në kohën e transferimit të Marrëveshjes, Palës Kontraktuese për Mbështetje transferues dhe Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje përgjigjen solidarisht dhe individualisht përkundrejt Shitësit lidhur me të gjithë detyrimet e Palës Kontraktuese për Mbështetje sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse Shitësi bie dakord ndryshe me shkrim.

6.4 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me Vlerësimin Zyrtar të Kredisë apo Kriteret Financiare të Garancisë së Performancës së Palës se Re Kontraktuese për Mbështetje do të zgjidhet sipas nenit 28.

6.5 Në përputhje me nenet 6.3 dhe 6.4, Pala Kontraktuese për Mbështetje mund të lidhë një marrëveshje me një ose më shumë Furnizues të Licencuar sipas së cilës Furnizuesi i Licencuar do të ketë të drejtën, pa miratimin e Shitësit, të përmbushë disa ose të gjithë detyrimet e Palës Kontraktuese për Mbështetje sipas kësaj Marrëveshjeje për një pjesë ose të gjithë Periudhën e Tregtimit I.

6.6 Pavarësisht marrëveshjes ndërmjet Palës Kontraktuese për Mbështetje dhe Furnizuesit të Licencuar të referuar nw kwtw nenn, Pala Kontraktuese për Mbështetje mbetet përgjegjësi i vetëm ndaj Shitësit lidhur me të gjithë:

(a) detyrimet e Palës Kontraktuese për Mbështetje sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

(b) detyrimet e përmbushura ose që do të përmbushen nga një Furnizues i Licencuar (duke përfshirë edhe shkelje të këtyre detyrimeve) në emër të Palës Kontraktuese për Mbështetje sipas kësaj Marrëveshjeje sikur Pala Kontraktuese për Mbështetje t'i kishte përmbushur ose duhej t'i përmbushte vetë këto detyrime.

6.7 Pala Kontraktuese për Mbështetje mund të caktojë ose të zëvendësojë Furnizuesin e Licencuar në çdo kohë, me kusht që:

(a) Furnizuesi i Licencuar është financiarisht (ku në rast transferimi në përputhje me nenin 6.3 do të thotë përmbushje të Vlerësimit Zyrtar të Kredisë apo të Kritereve Financiare të Garancisë të Performancës) dhe teknikisht i aftë të kryejë rolin e Furnizuesit të Licencuar;

(b) Pala Kontraktuese për Mbështetje i paraqet Shitësit një njoftim paraprak me shkrim lidhur me caktimin ose zëvendësimin e Furnizuesit të Licencuar sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur;

(c) nëse kërkohet nga OST-ja apo Legjislacioni i Zbatueshëm, Furnizuesi i Licencuar bëhet regjistruesi lidhur me Pikën e Matjes.

## (B)- PERIUDHA E TREGTIMIT I – TERMAT E MBE-SË

### 7. PARASHIKIME, NOMINIME, NDËRPRERJE, BALANCIMI DHE GARANCIA E DISPONUESHMËRISË

7.1 Përgjatë Periudhës së Tregtimit I, Shitësi do të sigurojë që të gjitha parashikimet dhe nominimet e kryera në përputhje me këtë nen 7 do të përgatiten në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë dhe Legjislacionin e Zbatueshëm. Në përputhje me dispozitat e Legjislacionit të Zbatueshëm, do të zbatohen parashikimet e mëposhtme të këtij neni 7.

7.2 Jo më pak se [pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune] përpara fillimit të Periudhës Operacionale dhe të çdo përvjetori të mëpasshëm, Shitësi i paraqet Palës Kontraktuese për Mbështetje një përllogaritje jo detyruese të Prodhimit të Matur të parashikuar për vitin pasardhës. Shitësi bën të gjitha përpjekjet e mundshme për të siguruar që ky parashikim të jetë sa më i saktë që të jetë e mundur. Kur Shitësi rishikon një parashikim për të pasqyruar një ndryshim në Prodhimin e Matur të pritshëm, Shitësi do t'i dorëzojë Palës Kontraktuese për Mbështetje parashikimin e rishikuar sa më shpejt që të jetë praktike në mënyrë të arsyeshme.

7.3 Në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm (përfshirë Rregullat e Përkohshme të Balancimit), Palët njohin dhe pranojnë se afati për:

(a) nominimet e kryera sipas nenit 7.4 tek OST është nga ora 10:37 deri në orën 14:00 në D-1 ("**Ditë në-Avancë -GCT**"); dhe

(b) rinominimet e kryera sipas nenit 7.5 tek OST është nga ora 18:00 në D-1 deri në orën 23:00 në D, gjashtëdhjetë (60) minuta përpara livrimit për çdo periudhë përkatëse shlyerje në D ("**Rinominim Brenda Ditës GCT**").

7.4 Jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) minuta përpara Ditës në Avancë GCT, Shitësi në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë do t’i paraqesë Palës Kontraktuese për Mbështetje një nominim të parashikimit të tij të Prodhimit Pwrkatws për çdo periudhë përkatëse shlyerje në D ("**Nominimi i Përkohshëm i Prodhimit**").

7.5 Jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) minuta përpara një Rinominimi përkatës Brenda Ditës GCT, nëse Shitësi parashikon një ndryshim material ndërmjet **Nominimit të Përkohshëm të Prodhimit** dhe prodhimit aktual të Impiantit, Shitësi do t’i paraqesë Palës Kontraktuese për Mbështetje një rinominim të parashikimit të tij të ri të Prodhimit Pwrkatws për periudhën përkatëse të shlyerjes ose çdo numër të këtyre periudhave në D ("**Nominimi Përfundimtar i Prodhimit**").

7.6 Pavarësisht nenit 7.5, nëse Shitësi:

(a) nuk ushtron të drejtën e tij sipas nenit 7.5; apo

(b) ushtron të drejtën e tij sipas nenit 7.5, por pas Rinominimit Brenda Ditës GCT,

Nominimi i Përkohshëm i Prodhimit do të konsiderohet si Nominimi Përfundimtar i Prodhimit për efekte të periudhës së shlyerjes në D.

Të gjitha periudhat e shlyerjes në nenet 7.3 deri në 7.6. janë përcaktuar në përputhje me rregullat e tregut dhe rregullat e balancimit në fuqi. Në rast se këto periudha ndryshojnë, atëherë afatet e nominimeve dhe periudhat përkatëse të shlyrjes do të ndryshohen sipas rregullave të reja, duke ruajtur të njëjtat parime të përgjithshme sipas neneve të mësipërme.

7.7 Pala Përgjegjese e Grupit të Balancimit do të kryejë apo do të mundësojë që të kryhen për OST-në nominimet dhe/ose rinominimet për Prodhimin e Mbështetur në bazë të nominimeve dhe/ose rinominimeve të paraqitura nga Shitësi sipas neneve 7.3 deri 7.6, me kushtin që këto mund të ndryshohen nga Pala Kontraktuese për Mbështetje në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë.

7.8 Gjatë Periudhës së Tregtimit I, Pala Kontraktuese për Mbështetje:

(a) do të operojë një Grup Balancimi ku Shitësi të mund të marrë pjesë; ose

(b) do të sigurojë që një palë e tretë të operojë një Grup Balancimi që përmbush kriteret e nenin 7.9 ku Shitësi të mund të marrë pjesë.

(secili **Pala Përgjegjëse e Grupit të Balancimit**"). Pala përkatëse Përgjegjëse e Grupit të Balancimit do të shlyejë çdo disbalancë ndërmjet Prodhimit Përkatës dhe Nominimit Përfundimtar të Prodhimit. Pala Përgjegjëse e Grupit të Balancimit nuk ka të drejtë të ngarkojë Shitësin (dhe/ose çdo palë të tretë) në mënyrë retroaktive për ndonjë disbalancë për muajin përkatës, përveç rastit kur disbalanca është shkaktuar nga neglizhenca e rëndë apo veprimet e paligjshme me dashje të tij në lidhje me paraqitjen e nominimeve dhe/ose rinominimeve.

7.9 Pala Përgjegjëse e Grupit të Balancimit dhe Shitësi duhet të arrijnë një marrëveshje mbi shërbimet e balancimit në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë duke përcaktuar ndër të tjera, tarifat dhe cmimet që Pala Përgjegjëse e Grupit të Balancimit mund t`i ngarkojë Shitësit në bazë të kostove të arsyeshme për ofrimin e shërbimeve të balancimit në përputhje me nenin 7.8 një tarifë për shërbimet e balancimit ("**Tarifa për Shërbimet e Balancimit**"). Tarifa për Shërbimet e Balancimit nuk duhet të jetë më lartë se limiti prej [xxx EUR / MWh] parashikuar në kushet e vençanta të marrevshjes, derisa një Vlerësim Pozitiv i Likuiditetit të Tregut Brenda të Njejtës Ditë të jetë arritur.

7.10 Nëse Pala Kontraktuese për Mbështetje ushtron të drejtën e tij sipas nenit 7.8(b), ajo do të sigurojë që Pala Përgjegjëse e Grupit të Balancimit do t`ia kalojë kostot për shërbimet e balancimit Shitësit në një mënyrë transparente dhe sipas llogarive të hapura deri në një masë të barabartë me limitin e **Tarifës për Shërbimet e Balancimit** sipas nenit 7.9.

7.11 Kur caktohet një palë e tretë që të drejtojë një Grup Balancimi sipas nenit 7.8(b), Pala Kontraktuese për Mbështetje në çdo kohë do të bëjë përpjekjet e saj të arsyeshme që të sigurojë shërbimet e Balancimit në një mënyrë efiçente për koston.

7.12 Gjatë Periudhës Tregtare I, nëse Pala Kontraktuese për Mbështetje nuk arrin të sigurojë shërbimet e Balancimit nga një palë e tretë si Palë Përgjegjëse e Grupit të Balancimit me kosto të njëjtë apo më të ulët se Limiti i Kostos për Shërbimet e Balancimit, Palët pranojnë se do t'i tenderojnë shërbimet e Balancimit. Palët do të bien dakord për çdo kusht tenderi që do të konsiderohet i nevojshëm, dhe bashkërisht do të bien dakord për zgjedhjen e një pale të tretë bazuar në ofertën më të mirë konkurruese. Çmimi i tenderuar do të zëvendësojë çmimin e dakordësuar me kusht që të mos kalojë Limitin e Kostos për Shërbimet e Balancimit.

7.13 Pa paragjykuar parashikimet në nenet 7.3 deri ne 7.12, Pala Kontraktuese për Mbështetje ka të drejtë t`i kërkojë Shitësit që të ulë pjesërisht ose plotësisht prodhimin e Impiantit për periudha të caktuara, duke përfshirë pa kufizim raste të kufizimeve të Rrjetit, periudha të çmimeve negative të tregut ose periudha të Forcës Madhore. Pas kërkesës së Palës Kontraktuese për Mbështetje, Shitesi duhet sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur, t`i japë Palës Kontraktuese për Mbështetje akses virtual në Aparatin Matës dhe çfarëdo instalimi tjetër në Impiant siç mund të konsiderohet e arsyeshme nga ana e Palës Kontraktuese për Mbështetje për t`i mundësuar kësaj të fundit që të kryejë parashikimet e veta në lidhje me prodhimin e mundshëm të Impiantit.

7.14 Shitësi ka të drejtë të sigurojë që Impianti të bëhet pjesë e Grupit të Balancimit të operuar nga një palë tjetër në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm. Në rast se Shitësi synon të ushtrojë të drejtat e tij sipas këtij neni 6.13, Shitësi do t'i dorëzojë një kërkese me shkrim Palës Kontraktuese për Mbështetje lidhur me këtë jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) Ditë Punë para datës së daljes së Shitësit nga Grupi i Balancimit të Blerësit siç tregohet në kërkesën e shoqëruar nga një Marrëveshje e Grupit të Balancimit me palën tjetër të tretë dhe marrëveshjet e nevojshme (nëse ka) me Blerësin dhe OST-në, që do nënshkruhen nga Blerësi në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm për të siguruar detyrimet e livrimit në përputhje me nenet 8.2 (a) (i), (A) dhe 8.2 (a), (i), (B).

7.15 Shitësi mundet që në çdo kohë të kërkojë të integrojë sërish Impiantin në Grupin e Balancimit të Palës Kontraktuese për Mbështetje. Për të ushtruar këtë të drejtë, Shitësi do t'i dorëzojë Palës Kontraktuese për Mbështetje një kërkesë me shkrim duke i kërkuar hyrjen sërish jo më pak se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë përpara datës së kërkuar për integrimin sërish të Impiantit në Grupin e Balancimit të Palës Kontraktuese për Mbështetje.

7.16 Duke nisur nga data e miratimit të kërkesës së daljes deri në miratimin e një kërkese të re për futjen e Impiantit në Grupin e Balancimit të Palës Kontraktuese për Mbështetje, Impianti do të

konsiderohet të ketë dalë nga Grupi i Balancimit të Blerësit dhe nenet 7.8 deri 7.12 nuk do të zbatohen gjatë kësaj periudhe.

7.17 Në rast se Impianti është palë e një Grupi Balancues të operuar nga një palë e tretë e zgjedhur nga Shitësi në përputhje me pikat 7.13 deri në 7.14, dispozitat e mëposhtme do të zbatohen për saktësinë e parashikimit:

(a) Brenda një (1) muaji pas përfundimit të çdo gjysmë viti kalendarik të Periudhës së Tregtimit I, Shitësi do t'i vendosë në dispozicion Palës për Mbështetje të dhënat e mëposhtme të regjistruara nga Shitësi dhe që lidhen me saktësinë e Prodhimeve Përfundimtare të Nominuara për periudhat përkatëse të shlyerjes në lidhje me gjysmë-vitin kalendarik të mëparshëm të Periudhës I të Tregtimit:

(A) Prodhimin aktual të Matur të matur në Pikën Matëse për çdo periudhë shlyerjeje, dhe

(B) Prodhimin/et përkatëse Përfundimtare të Nominuara për çdo periudhë shlyerjeje.

(b) Brenda një (1) muaji pas përfundimit të çdo gjysmë viti kalendarik të Periudhës së Tregtimit I, dhe në lidhje me këtë gjysmë viti kalendarik të mëparshëm të Periudhës së Tregtimit I, Shitësi do t'i ofrojë Palës për Mbështetje për të njëjtat periudha shlyerjeje për prodhimin e parashikuar të Impiantit nga një ekspert i pavarur i industrisë që plotëson kriteret e përcaktuara në pikën më poshtë ("**Parashikimi i Pavarur**"). Parashikimi i Pavarur do të ndjekë parimet për përgatitjen e një parashikimi në përputhje me Rregullat e Tregut dhe Legjislacionin e Zbatueshem. Parashikimi i Pavarur duhet të ndjekë parimet për përgatitjen e një parashikimi në përputhje me pikat 7.4, 7.5 dhe 7.6, ku si Parashikimi i Pavarur i ofruar nga eksperti i pavarur i industrisë ashtu edhe Nominimi Përfundimtar i Prodhimit i ofruar nga Shitësi duhet të pasqyrojnë ndërprerjet e energjisë në të njëjtën mënyrë në përputhje me Marrëveshjen e Lidhjes me Rrjetin (por vetëm në masën që këto zbatohen për ndërprerjet e udhëzuara).

(c) Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të pavarur të industrisë janë që individi të jetë:

(i) në dispozicion dhe të gatshëm për të vepruar sipas kushteve të këtij neni 7.17, brenda njëzet (20) ditët e pune nga emërimi;

(ii) një person fizik i pavarur me përvojë të provuar në kryerjen e parashikimeve për prodhimin në tregun e ditës në avancë;

(iii) flet mjaftueshëm rrjedhshëm në gjuhën angleze për të bërë parashikimin e e ditës në avancë dhe për ta dhënë atë në gjuhën angleze; dhe

(iv) mund të zgjidhet nga një grup ekspertësh të angazhuar rregullisht nga Shitësi, me kusht që një angazhim i tillë të mos krijojë ndonjë konflikt interesi për të vepruar si ofrues i Parashikimit të prodhimit për Ditën në Avancë.

(d) Nëse në lidhje me ndonjë vit kalendarik, varianca midis Nominimit Përfundimtar të Prodhimit dhe Parashikimeve të Pavarura është më e lartë se [ ] % përqindjeje, por më e ulët se Varianca e Papranuar, Shitësi do t'i paguajë Palës Mbështetëse si kompensim të vetëm dhe përfundimtar [ ] EUR / MWh] për këtë variancë.]

7.18 Jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune përpara fillimit të Periudhës Operacionale dhe të çdo përvjetori vijues, Shitësi i paraqet Palës Kontraktuese për Mbështetje programin ku përcakton secilën Ndërprerje të propozuar për vitin pasardhës, duke përfshirë detaje lidhur me sasinë me të cilën do të reduktohet Kapaciteti i Impiantit dhe kohën dhe datat e nominuara të këtyre Ndërprerjeve (**"Programi i Ndërprerjeve të Planifikuara"**).

7.19 Programi i Ndërprerjeve të Planifikuara do të përfshijë lidhur me çdo Ndërprerje:

(a) detaje të shkurtra të shkakut të Ndërprerjes;

(b) ditën që pritet të fillojë dhe kohëzgjatjen e pritshme të Ndërprerjes;

(c) operimin e pjesshëm ose të reduktuar gjatë Ndërprerjes dhe çdo reduktim të pritshëm në gjenerimin e energjisë elektrike (që është nën nivelin normal) pas përfundimit të Ndërprerjes dhe kohëzgjatjen e këtij reduktimi; dhe

(d) ndryshimet për çdonjerën nga Ndërprerjejet e njoftuara më parë lidhur me sa më sipër.

7.20 Shitësi mund ta ndryshojë Programin e Ndërprerjeve të Planifikuara për çdo vit, përpara ose gjatë vitit, *me kusht që* ta bëjë këtë sa më shumë që është e mundshme në mënyrë të arsyeshme përpara Ndërprerjes së planifikuar që përfshihet në Programin e Ndërprerjeve të Planifikuara që duhet të rishikohet sipas ndryshimit dhe t'i paraqesë Palës Kontraktuese për Mbështetje, dhe nëse kërkohet nga Legjislacioni i Zbatueshëm, njëkohësisht edhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut, një njoftim lidhur me ndryshimin sa më herët që të jetë e mundshme në mënyrë të arsyeshme, dhe të marrë parasysh çdo deklarim të arsyeshëm të bërë nga Pala Kontraktuese për Mbështetje (*me kusht që* Palët bien dakord se çdo vendim lidhur me kohën e programimit të Ndërprerjes së Planifikuar i përket vetëm Shitësit).

7.21 Shitësi bën përpjekjet e arsyeshme për të minimizuar numrin dhe kohëzgjatjen e çdo Ndërprerje që nuk përfshihet në Programin e Ndërprerjeve të Planifikuara ("**Ndërprerje e Paplanifikuar**") që ndodh gjatë Periudhës Operacionale. Shitësi, sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur pas ngjarjes së një Ndërprerjeje të Paplanifikuar gjatë Periudhës Operacionale, do të njoftojë Palën Kontraktuese për Mbështetje dhe nëse kërkohet nga Legjislacioni i Zbatueshëm njëkohësisht edhe pjesëmarrës të tjerë të tregut lidhur me Ndërprerjen e Paplanifikuar dhe do të përdorë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të korrigjuar Ndërprerjen e Paplanifikuar në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë. Gjatë njoftimit të Palës Kontraktuese për Mbështetje lidhur me Ndërprerjen e Paplanifikuar, Shitësi do të vërë në dijeni Palës Kontraktuese për Mbështetje edhe për parashikimin e tij më të mirë për mundësitë e kohëzgjatjes së Ndërprerjes së Paplanifikuar.

## 8. SHITJA DHE BLERJA E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TRANSFERIMI I PËRFITIMEVE TË GJENERIMIT

8.1 Gjatë Periudhës së Kolaudimit, Pala Kontraktuese për Mbështetje, duke njoftuar Shitësin, mund të zgjedhë të blejë dhe të pranojë çdo Prodhim të Mbështetur të gjeneruar nga Impianti me Çmimin e Energjisë Elektrike. Nëse Pala Kontraktuese për Mbështetje nuk zgjedh të blejë Prodhimin e Matur gjatë Periudhës së Kolaudimit, Shitësi mund të ofrojë Prodhimin e Matur në tregun e lirë të energjisë në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike dhe Legjislacionin e Zbatueshëm. Kjo mund të përfshijë pa kufizim të drejtën e Shitësit për të marrë pjesë në tendera për shitjen e energjisë elektrike për të mbuluar humbjet e Rrjetit të Transmetimit në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm.

8.2 Gjatë Periudhës Operacionale:

(a) Shitësi:

(i) operon Impiantin në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë me qëllim maksimizimin e Prodhimit Përkatës nga Impianti; dhe

(A) në rast se Impianti është pjesë e një Grupi Balancimi të operuar nga Pala Kontraktuese për Mbështetje ose një palë e tretë e përzgjedhur nga Pala Kontraktuese për Mbështetje në përputhje respektivisht me nenet 7.8(a) ose nenet 7.8(b) dhe nenet 7.9 deri 7.13, shet, programon dhe livron, në Pikën e Matjes, Prodhimin të Matur për çdo periudhë shlyerje të matur ("**Prodhimi i Mbështetur A**");

(B) në rast se Impianti është pjesë e një Grupi Balancimi të operuar nga një palë e tretë e përzgjedhur nga Shitësi në përputhje me nenet 7.13 deri 7.14, shet, programon dhe siguron që OST-ja të livrojë në Pikën e Livrimit, deri në dhe duke përfshirë (por pa tejkaluar) Nominimin Përfundimtar të Prodhimit në lidhje me Prodhimin të Matur të parashikuar për çdo periudhë shlyerje ("**Prodhimi i Mbështetur B**");

(b) Pala Kontraktuese për Mbështetje:

(i) Në rast se Impianti është pjesë e një Grupi Balancimi të operuar nga Pala Kontraktuese për Mbështetje ose një palë e tretë e zgjedhur nga Pala Kontraktuese për Mbështetje në përputhje me nenet 7.8 deri 7.13, pranon në Pikën e Matjes Prodhimin e Mbështetur A dhe paguan për çdo MWh të sasisë së livruar Çmimin e Energjisë Elektrike;

(ii) Në rast se Impianti është pjesë e një Grupi Balancimi të operuar nga një palë e tretë e zgjedhur nga Shitësi në përputhje me nenet 7.14 deri 7.18, pranon në Pikën e Livrimit Prodhimin e Mbështetur B dhe paguan për çdo MWh të sasisë së livruar Çmimin e Energjisë Eletrike.

8.3 Të drejtat e pronësisë dhe të gjithë të drejtat e lidhura, si dhe risku i humbjeve lidhur me, Prodhimin e Mbështetur A apo Prodhimin e Mbështetur B sipas rastit do t'i kalojnë Palës Kontraktuese për Mbështetje pas livrimit në Pikën e Matjes apo në Pikën e Livrimit sipas rastit. Në zbatim të nenit 7.20, dhe Marrëveshjes së Lidhjes:

(a) Shitësi është përgjegjës për çdo kosto apo pagesë që i tarifohet ose që shoqërohet me Programin, transmetimin dhe livrimin e Prodhimit të Mbështetur A apo Prodhimit të Mbështetur B sipas rastit deri te Pika e Matjes apo Pika e Livrimit sipas rastit; dhe

(b) Pala Kontraktuese për Mbështetje është përgjegjës për çdo kosto dhe pagesë që i tarifohet ose që shoqërohet me pranimin dhe transmetimin e Prodhimit të Mbështetur A në dhe nga Pika e Matjes. Në përputhje me nenin 8, Shitësi pranon të transferojë ose të vërë në dispozicion të Palës Kontraktuese për Mbështetje të gjitha Përfitimet e Gjenerimit të akumuluara gjatë ose të lidhura me Prodhimin e Mbështetur gjatë Periudhës së Tregtimit 1.

8.4 Shitësi merr përsipër që Prodhimi i Mbështetur dhe Përfitimet e Gjenerimit të livruara, transferuara ose të vëna në dispozicion të Palës Kontraktuese për Mbështetje në përputhje me këtë Marrëveshje të shiten të lira nga çdo tarifë, detyrim, barrë ose nga pretendimet e një pale të tretë. Në rast të shkeljes së këtij detyrimi nga Shitësi, pa cenuar asnjë mjet mbrojtës të Shitësit sipas kësaj Marrëveshjeje apo Legjislacionit të Zbatueshëm dhe të drejtat e Palës Kontraktuese për Mbështetje sipas kësaj Marrëveshjeje apo Legjislacionit të Zbatueshëm, Pala Kontraktuese

për Mbështetje mund të përcaktojë humbjen e saj të drejtpërdrejtë, aktuale, të arsyeshme dhe të provueshme të lidhur me të dhe të njoftojë Shitësin për këtë. Njoftimi përfshin detaje të përllogaritjes së kësaj humbje dhe çdo dokument mbështetës përkatës. Brenda pesë (5) Ditëve Pune nga marrja e këtij njoftimi (i shoqëruar me Faturën e vlefshme) nga Pala Kontraktuese për Mbështetje, Shitësi kompenson Palën Kontraktuese për Mbështetje për humbjen e njoftuar.

8.5 Nëse Përfitimi i Gjenerimit është ose bëhet i Paefektshëm ose nuk është më i vlefshëm, aplikohet sa më poshtë:

(a) kur Përfitimi i Gjenerimit është ose bëhet i Paefektshëm ose nuk është më i vlefshëm si rezultat i një veprimi ose mosveprimi nga Pala Kontraktuese për Mbështetje, atëherë Pala Kontraktuese për Mbështetje nuk do të ketë asnjë pretendim ndaj Shitësit lidhur me këtë;

(b) kur Përfitimi i Gjenerimit është ose bëhet i Paefektshëm ose nuk është më i vlefshëm si rezultat i një veprimi ose mosveprimi nga Shitësi, atëherë Shitësi ose:

(i) zëvendëson këtë Përfitim të Gjenerimit brenda njëzet (20) Ditëve Pune; ose

(ii) i paguan Palës Kontraktuese për Mbështetje një shumë të barabartë me humbjen e drejtpërdrejtë, aktuale, të arsyeshme dhe të provueshme të Palës Kontraktuese për Mbështetje të shkaktuar nga mosdorëzimi i Përfitimit të efektshëm të Gjenerimit nga ana e Shitësit.

8.6 Blerësi pranon që Prodhimi i Matur dhe disa nga Përfitimet e Gjenerimit mund të ndryshojnë në varësi të kushteve mbizotëruese klimatike në ose pranë Impiantit dhe se asgjë në këtë Marrëveshje nuk ka për qëllim të krijojë përgjegjësi për Shitësin ndaj Palës Kontraktuese për Mbështetje si rezultat i mos gjenerimit nga Impianti të Prodhimit të Nominuar .

## 9. MATJA DHE TË DHËNAT

9.1 Sipas nenit 9.2, leximet e Aparatit Matës janë përfundimtare në lidhje me sasinë e prodhimit të livruar në Pikën e Matjes dhe OST, në përputhje me Marrëveshjen e Lidhjes, është përgjegjëse për të marrë matjet e prodhimit të livruar në Pikën e Matjes në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë. Secila Palë do të ketë të drejtën të jetë e pranishme për çdo lexim të ndonjë Aparati Matës. [*Shënim sqarues*: Për hir të qartësisë, duhet të instalohet një aparat matës i veçantë për Kapacitetin e Mbështetur. Kur një Projekt përfshin një pjesë ekzistuese ose shtesë të kapacitetit të instaluar që tejkalon Kapacitetin e Mbështetur, një aparat matës i veçantë duhet të instalohet për atë pjesë tjetër.]

9.2 Sipas nenit 9.1, nëse Aparati Matës nuk është funksional, konstatohet se është i pasaktë sipas nenit 9.4, ose dakordësohet se regjistron Prodhimin e Matur me pasaktësi, Shitësi përcakton Prodhimin e Matur në një mënyrë të arsyeshme tregtare në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë, duke iu referuar sasisë së livruar gjatë periudhave me kushte diellore të ngjashme kur Aparati Matës regjistronte saktë Prodhimin e Matur.

9.3 Secila Palë dhe konsulentët dhe përfaqësuesit e saj kanë të drejtë të jenë të pranishëm gjatë çdo testi që kryhet nga ose nën mbikëqyrjen e OST-së ose autoriteteve të tjerë testues të certifikuar për të verifikuar saktësinë e matjeve dhe regjistrimeve të Aparatit Matës. Shitësi i jep Palës Kontraktuese për Mbështetje njoftim paraprak me shkrim në mënyrë të arsyeshme përpara datës kur duhet kryer një test i tillë.

9.4 Sipas dispozitave të Marrëveshjes së Lidhjes dhe Kodit Shqiptar të Rrjetit të Transmetimit, Palët njohin dhe pranojnë se do të ndërmarrin hapat e mëposhtëm për zgjidhjen e çfarëdolloj

mosmarrëveshjeje në lidhje me saktësinë e Aparatit Matës ose për të përcaktuar Prodhimin e Matur në përputhje me nenin 9.2:

(a) nëse ndonjëra nga Palët kundërshton saktësinë ose gjendjen e Aparatit Matës, kjo Palë e këshillon Palën tjetër me shkrim, duke parashtruar në detaje të arsyeshme bazën për këtë mosmarrëveshje;

(b) Pala jo-kundërshtuese, brenda dhjetë (10) Ditësh Pune nga marrja e këtij njoftimi nga Pala kundërshtuese, këshillon Palën kundërshtuese me shkrim për sa i përket pozicionit të saj në lidhje me saktësinë e këtij Aparati Matës dhe parashtron arsyet për mbajtjen e këtij pozicioni;

(c) nëse Palët nuk janë në gjendje të bien dakord mbi saktësinë ose gjendjen e Aparatit Matës ose me përcaktimin e Shitësit, secila Palë mund të kërkojë testime shtesë të Aparatit Matës nga OST-ja ose autoritete të tjera testuese të autorizuara ose të certifikuara prej saj;

(d) nëse Aparati Matës konstatohet se është brenda pragjeve të saktësisë që parashikohen në Legjislacionin e Zbatueshëm, çfarëdolloj regjistrimi tjetër i mëparshëm i Aparatit Matës konsiderohet i vlefshëm dhe Pala që kërkon testimin e matjes sipas nenit 9.4(c) përballon kostot e inspektimit dhe testimit të Aparatit Matës sikundër përshkruhet në nenin 9.4(c); dhe

(e) nëse Aparati Matës konstatohet se është jashtë pragjeve të saktësisë që parashikohen në Legjislacionin e Zbatueshëm ose nëse ky Aparat Matës për çfarëdolloj arsyeje nuk funksionon ose nuk regjistron, atëherë:

    (i) Shitësi menjëherë kërkon që Aparatet Matëse që janë konstatuar të pasaktë të zëvendësohen nga OST-ja, ose të riparohen ose të përshtaten nga ajo për ta korrigjuar këtë pasaktësi;

    (ii) Palët vlerësojnë sasitë e sakta të prodhimit të livruar në Pikën e Matjes gjatë periudhave të prekura nga kjo pasaktësi, ndërprerje shërbimi ose mosregjistrim në përputhje me nenin 9.2; dhe

    (iii) Shitësi përballon koston e inspektimit dhe testimit të Aparatit Matës të kryera në përputhje me nenin 9.4(c).

9.5 Nëse si rrjedhojë e përshtatjeve sipas nenit 9.4 Pasqyra e Faturimit për ndonjë periudhë pëson rënie, vlerat rezultuese do të përfshihen në Pasqyrën pasardhëse të Faturimit që lëshohet sipas nenit 8 nëpërmjet kompensimit me ose zbritjes së këtyre shumave nga detyrimet për pagesë të Palës Kontraktuese për Mbështetje sipas kësaj Marrëveshjeje.

9.6 Nëse, si rrjedhojë e çdo përshtatjeje sipas nenit 9.4, Pasqyra e Faturimit për ndonjë periudhë rritet, vlerat rezultuese do të përfshihen në Pasqyrën pasardhëse të Faturimit që lëshohet sipas nenit 8 si zë shtesë i kostove.

## (B)- PERIUDHA E TREGTIMIT II – TERMAT E CFD-SË

## 10. KUSHTET

10.1 Shitësi do të sigurojë të gjitha autorizimet, miratimet dhe kërkesat e kolateralit siç kërkohet për t'u regjistruar si pjesëmarrës në Bursën Shqiptare të Energjisë në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshem;

10.2 Shitësi të sigurojë që ka bërë të gjitha njoftimet përkatëse dhe ka marrë të gjitha miratimet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, duke përfshirë pa kufizim përjashtimin ose autorizimin e shërbimeve të veprimtarisë ndihmëse, siç kërkohet nga Ligji për Tregjet e Kapitalit dhe Legjislacioni i Zbatueshem.

10.3 Pala Kontraktuese për Mbështetje duhet të ri-lëshojë Mbështetjen e Kredisë duke pasqyruar shumën e kërkuar për pagesat CfD, në favor të Shitësit në përputhje me kërkesat e nenit 21 dhe të Shtojcës 2.

10.4 Palët do të plotësojnë kushtet e tyre përkatëse të përcaktuara më lart sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur dhe, në çdo rast, jo më vonë se 20 (njëzet) ditë pune pas ekzekutimit të Deklaratës së Përbashkët në lidhje me Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut.

10.5 Në datën në të cilën njëra Palë merr dijeni se një ose më shumë nga kushtet e mësipërme janë përmbushur, ajo do të njoftojë Palën tjetër me shkrim dhe do të sigurojë prova që vërtetojnë përmbushjen siç mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme Pala tjetër.

## 11. SHLYERJA FINANCIARE

11.1 Gjatë Periudhës Tregtare II,

(a) nëse Çmimi i Energjisë Elektrike është më i lartë se Çmimi i Referencës, Pala për Mbështetje do t'i paguajë Shitësit për çdo periudhë shlyerjeje produktin e:

(i) një shumë të barabartë me diferencën financiare ndërmjet Çmimit të Energjisë Elektrike dhe Çmimit të referencës ("**Diferenciali pozitiv i Çmimit**"), i llogaritur për periudhën përkatëse të shlyerjes, dhe

(ii) Sasinë e Kontratës për periudhën përkatëse të shlyerjes.

(b) nëse Çmimi i Energjisë Elektrike është më i ulët se Çmimi i Referencës, Shitësi do t'i paguajë Palës për Mbështetje për çdo periudhë shlyerjeje produktin e:

(i) një shumë të barabartë me diferencën financiare ndërmjet Çmimit të Energjisë Elektrike dhe Çmimit të referencës ("**Diferenciali negativ i Çmimit**"), i llogaritur për periudhën përkatëse të shlyerjes, dhe

(ii) Sasinë e Kontratës për periudhën përkatëse të shlyerjes.

11.2 Diferenciali Çmimit do të llogaritet nga Shitësi për periudhën përkatëse të shlyerjes dhe njoftohet menjëherë Pales për Mbështetje me njoftim me shkrim jo më vonë se 3 (tri) Ditë Pune nga llogaritja e tillë.

11.3 Kur zgjidhet opsioni (b) bazuar në nominimet për përcaktimin e Sasisë së Kontratës me kërkesë të Palës Kontraktuese për Mbështetje-s nenet 7.17 në lidhje me Parashikimin e Pavarur, *mutandis mutandis.*

## 12. ÇMIMET NEGATIVE

12.1 Pas një Periudhe Çmimi Negativ, Pala për Mbështetje duhet t'i kërkojë Shitësit të mos prodhojë në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm. Nëse prodhimi i Shitësit është pakësuar pjesërisht ose plotësisht për shkak të Periudhave të Çmimit Negativ sipas këtij neni për një shumë të agreguar të periudhave të shlyerjes më të lartë se [■], Shitësi ka të drejtë për një kompensim nga ana e Palës për Mbështetje për një shumë e barabartë me: [produktin e: (i) Çmimit të Energjisë Elektrike dhe (ii) Nominimit Përfundimtar të Prodhimit për sasitë e ndërprera]. Nëse zbatohet kompensimi sipas ketij neni, Pala per Mbështetje mund t'i kërkojë Shitësit të permbushë kërkesat e verifikimit të saktesisë së parashikimit sipas nenit 7.17 *mutandis mutandis*.

12.2 Çdo ndërpreje gjatë një Periudhe Çmimi Negativ do të përfshihet në orët e lejuara për qëllimet e Garancisë së Disponueshmërisë dhe prodhimi i lejuar për qëllimet e Garancisë së Performancës.

## 13. NDERPRERJA E TREGUT

13.1 Nëse në çdo kohë, secila Palë beson në mënyrë të arsyeshme se ka ndodhur një Ngjarje e Ndërprerjes së tregut, ajo Palë duhet të njoftojë menjëherë Palën tjetër dhe Palët do të takohen menjëherë dhe do të përpiqen të bien dakord për një ndryshim ose zëvendësim të përshtatshëm të Çmimit të Referencës të zbatueshëm, si të jetë i nevojshëm për të siguruar që indeksi i ndryshuar ose i zëvendësimit pasqyron, sa më afër që të jetë e mundur, metodologjinë, bazën e llogaritjes dhe likuiditetin e këtij Çmimi të Referencës (një "**Indeks i Zëvendësimit**")

13.2 Çdo Indeks Zëvendësimi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

(a) në rastin e energjisë elektrike, ai duhet të publikojë informacionin e Çmimit për zonën e tenderit (*bidding zone*) të cilës i përket Impianti dhe të marrë parasysh masën në të cilën vendndodhja fizike e Impiantit dhe kufizimet në lëvrimin e energjisë elektrike në treg mund të kenë ndikimin mbi çmimin për shitjen e energjisë elektrike të levruar në atë zone të ofertave (*bidding area*);

(b) në rastin e Garancive të Origjinës, nëse është e zbatueshme, duhet të publikojë informacionin e çmimeve për të njëjtin lloj prodhimi si ai nga Impianti, dhe nëse një informacion i tillë nuk është i disponueshëm, informacion për të njëjtin shtet ku ndodhet Impianti;

(c) të dhënat themelore të përdorura për përpilimin ose përgatitjen e këtij indeksi: (i) duhet t'i nënshtrohen procedurave të arsyeshme për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e tij; (ii) duhet të mbahen nga administratori i këtij indeksi për një periudhë minimale prej dy (2) vitesh pas publikimit të tij, në mënyrë që të jetë i aftë për auditim; dhe (iii) përbëhet vetëm nga të dhëna të verifikueshme të transaksionit dhe përjashton të dhënat që janë produkt i gjykimit subjektiv; (d) metodologjia e përdorur nga administratori për të përgatitur një indeks të tillë është e dokumentuar siç duhet; (e) duhet të pasqyrojë një vëllim të mjaftueshëm të tregtimeve nga një numër i mjaftueshëm dhe një gamë e ndryshme pjesëmarrësish në treg; dhe (f) duhet të jetë në dispozicion të Palës për Mbështetje me kushte të arsyeshme tregtare.

13.3 Nëse pas skadimit të tre (3) muajve pas datës së njoftimit sipas nenit 13.1, nuk është arritur asnjë marrëveshje në lidhje me ndryshimet e nevojshme në Çmimin e Referencës ose në Indeksin e Zëvendësimit, secila palë ka të drejtë të referojë çështjen për Zgjidhjen me Ekspert në përputhje me pikën 28.

## 14. DOREZIMI DHE TRANSFERIMI I PËRFITIMEVE TË GJENERIMIT

14.1 Shitësi duhet te programoje, te shese, te dorezoje ose te siguroje dorezimin dhe Pala per Mbeshtetje duhet te pranoje dhe te marre ne dorezim Përfitimet e Gjenerimit ne lidhje me Sasine e Kontrates, të lira nga çdo tarifë, detyrim, barrë ose nga pretendimet e një pale të tretë.

14.2 Palët pranojnë se autoritetet shqiptare janë në proces të krijimit të një regjistri për garancitë e origjinës (GoOs). Kur është e nevojshme, Shitësi dhe Pala Mbështetëse do të ndërmarrin të gjitha hapat dhe veprimet për të siguruar që dorëzimi dhe pranimi i Përfitimeve te Gjenerimit ne lidhje me Sasinë e Kontratës të kryhet ose nëpërmjet transferimit elektronik ose transferimit me anulim, në përputhje me rregullat e Regjistrit të GoO Shqiptare dhe Legjislacionit te Zbatueshem.

14.3 Në rast të shkeljes së këtij detyrimi nga Shitësi, pa cenuar asnjë mjet mbrojtës të Shitësit sipas kësaj Marrëveshjeje apo Legjislacionit të Zbatueshëm dhe të drejtat e Pales per Mbeshtetje sipas kësaj Marrëveshjeje apo Legjislacionit të Zbatueshëm, Pala Mbeshtetese mund të përcaktojë humbjen e saj të drejtpërdrejtë, aktuale, të arsyeshme dhe të provueshme të lidhur me të dhe të njoftojë Shitësin për këtë. Njoftimi përfshin detaje të përllogaritjes së kësaj humbje dhe çdo dokument mbështetës përkatës. Brenda pesë (5) Ditëve Pune nga marrja e këtij njoftimi (i shoqëruar me Faturën e vlefshme) nga Pala per Mbeshtetje, Shitësi kompenson Palen per Mbeshtetje për humbjen e njoftuar.

14.4 Nëse Përfitimi i Gjenerimit është ose bëhet i Paefektshëm ose nuk është më i vlefshëm, aplikohet sa më poshtë:

(a) kur Përfitimi i Gjenerimit është ose bëhet i Paefektshëm ose nuk është më i vlefshëm si rezultat i një veprimi ose mosveprimi nga Pala per Mbeshtetje, atëherë Pala per Mbeshtetje nuk do të ketë asnjë pretendim ndaj Shitësit lidhur me këtë;

(b) kur Përfitimi i Gjenerimit është ose bëhet i Paefektshëm ose nuk është më i vlefshëm si rezultat i një veprimi ose mosveprimi nga Shitësi, atëherë Shitësi ose:

(c) zëvendëson këtë Përfitim të Gjenerimit brenda njëzet (20) Ditëve Pune; ose

(d) i paguan Pales per Mbeshtetje një shumë të barabartë me humbjen e drejtpërdrejtë, aktuale, të arsyeshme dhe të provueshme të Pales per Mbeshtetje të shkaktuar nga mosdorëzimi i Përfitimit të efektshëm të Gjenerimit nga ana e Shitësit.

14.5 Pala per Mbeshtetje pranon që Sasia e Kontrates dhe disa nga Përfitimet e Gjenerimit mund të ndryshojnë në varësi të kushteve mbizotëruese klimatike në ose pranë Impiantit dhe se asgjë në këtë Marrëveshje nuk ka për qëllim të krijojë përgjegjësi për Shitësin ndaj Pales per Mbeshtetje si rezultat i mos gjenerimit nga Impianti të Sasise se Kontrates.

## 15. PARASHIKIMET PER SHERBIMET PER SIGURIMIN E RRUGES SE TREGUT

15.1 Gjatë Periudhës së Tregtimit II, Shitësit do t'i ofrohet opsioni për të lidhur një marrëveshje shërbimesh për sigurimin e rrugës së tregut me një Palë tjetër Mbështetëse të Mundësisë së Fundit në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, dhe që ofron shërbime për shitjen e Sasisë së Kontratës në treg për një çmim më të ulët të barabartë me [tetëdhjetë (70-80)%] të Çmimit të Referencës për periudhat përkatëse të shlyerjes.

15.2 Gjatë Periudhës së Tregtimit II, Shitësit do t'i ofrohet opsioni i lidhjes ose mbajtjes së marrëveshjes së shërbimeve balancuese me një Palë Përgjegjëse të Grupit Balancimit, e cila mund të jetë ose ish-Pala për Mbështetje ose një palë e tretë e caktuar prej saj ose Pala e Mbështetjes së Mundësisë së Fundit që merr rolin e Palës Përgjegjëse të Grupit të Balancimit duke vepruar në përputhje me nenet 7.8 deri në 7.16, të cilat do të zbatohen *mutandis mutandis* për periudhën e Tregtimit II.

# (D) – TERMAT E PËRGJITHSHËM

## 16. ÇMIMI DHE PAGESA

16.1 Për sa i përket secilit muaj të Periudhës së Furnizimit, Shitësi përgatit dhe i lëshon Palës për Mbështetje brenda dhjetë (10) Ditësh Pune të çdo muaji një pasqyrë mujore ("**Pasqyrë Faturimi**"), që përfshin:

(a) Në Periudhën e Tregtimit I, shuma e Prodhimit Përkatës për muajin përkatës shumëzuar me Çmimin e Energjisë Elektrike ("**Pagesa e Energjisë Elektrike**") që Pala për Mbështetje detyrohet t´i paguajë Shitësit;

(b) Produktin e Diferencialit të Cmimit dhe Sasisë se Kontratës të përllogaritur në përputhje me nenin 9.2(a) për muajin përkatës ("**Pagesa e Diferencialit Pozitiv**") që Pala për Mbështetje detyrohet t´i paguajë Shitësit;

(c) Produktin e Diferencialit të Cmimit dhe Sasisë së Kontratës të përllogaritur në përputhje me 9.2(b) për muajin përkatës ("**Pagesa e Diferencialit Negativ**") që Shitësi detyrohet t´i paguajë Palës per Mbështetje;

(d) çdo lloj pagese për t'iu shlyer Palës per Mbështetje nga Shitësi si pasojë e transferimit të Përfitimeve të Gjenerimit në përputhje me nenin 8;

(e) çdo pagesë që duhet bërë në përputhje me pikën 9.6;

(f) Tarifat e Shërbimeve të Balancimit nga Shitësi te Pala për Mbështetje, nëse është e zbatueshme;

(g) Dëmet e Likuiduara të Disponueshmërisë Energjetike nga Shitësi tek Pala për Mbështetje;

(h) çdo shumë tjetër që merret nga secila Palë sipas çdo dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje;

(i) çdo shumë të vlerave të pagueshme nga Pala për Mbështetje tek Shitësi pa shumat e pagueshme nga Shitësi tek Pala për Mbështetje sikundër parashtrohet në nenin (a) deri neni (h) (përfshirë këto).

16.2 Shitësi i paraqet Palës për Mbështetje një faturë për çdo Pasqyrë Faturimi (secila si "**Faturë**") jo më vonë se dhjetë (10) Ditë Pune pas lëshimit të Pasqyrës përkatëse të Faturimit (secila si "**Data e Faturës**"), që fillon në Datën e parë të Faturës pas fillimit të Periudhës së Furnizimit.

16.3 Të gjitha pagesat dhe faturat e paraqitura sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të jenë në EUR dhe në formën e faturave të vlefshme TVSH-je.

16.4 Të gjitha shumat e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje nuk përfshijnë TVSH-në ose Tatime apo tarifa të tjera të zbatueshme të pagueshme mbi këto shuma, të cilat do të shtohen nëse është rasti sipas normës që mbizotëron në periudhën Tatimore përkatëse.

16.5 Pala për Mbështetje paguan çdo shumë të pakundërshtuar që përmban Fatura brenda tridhjetë (30) ditësh pas datës së Datës së aplikueshme të Faturës. Çdo shumë e kundërshtuar por më pas e pranuar ose vendosur si e kërkueshme dhe e pagueshme paguhet brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i saj apo vendimi për të.

16.6 Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, të gjitha shumat e papaguara sipas kësaj Marrëveshjeje bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme tridhjetë (30) ditë nga marrja e njoftimit për pagesën e tyre.

16.7 Pala për Mbështetje do të kryejë të gjitha pagesat e e pagueshme nga Pala për Mbështetje sipas kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet transferimit elektronik të fondeve në fonde menjëherë të disponueshme në llogarinë e përcaktuar nga Shitësi me shkrim herë pas here.

16.8 Nëse Pala për Mbështetje konteston me arsye *në mirëbesim* ndonjë shumë që përmbahet në ndonjë Faturë, atëherë Pala për Mbështetje mund t'i mbajë këto shuma të kundërshtuara që përmban Fatura, dhe këto shuma të kundërshtuara nuk do të konsiderohen si mospërmbushje sipas kësaj Marrëveshjeje për arsye të kësaj mospagese, *me kusht që* kur një shumë nuk kundërshtohet brenda dhjetë (10) Ditë Pune nga Data e aplikueshme e Faturës, Pala për Mbështetje nuk mund të kundërshtojë këtë shumë dhe do të konsiderohet se ka pranuar përmbajtjen e Faturës (përveç rasteve të gabimeve të dukshme).

16.9 Asnjëra nga Palët nuk do të pezullojë përmbushjen e detyrimeve të saj përkatëse, përfshirë pagesën e shumave të pakundërshtuara dhe të pashlyera sipas një Fature, gjatë periudhës së mosmarrëveshjes për pagesën.

16.10 Përveçse nëse parashikohet shprehimisht në këtë Marrëveshje, asnjëra Palë nuk ka të drejtë të kompensojë shumat e kërkueshme ndaj Palës tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje duke përdorur shumat që Pala përfituese i detyrohet Palës paguese, qoftë sipas kësj Marrëveshjeje ose ndonjë rregullimi tjetër.

**17. ZGJIDHJA**

17.1 Shitësi mund ta zgjidhë në çdo kohë këtë Marrëveshje nëpërmjet njoftimit me shkrim të Palës për Mbështetje nëse një ose disa prej rasteve të mëposhtme ndodh dhe vazhdon të ndodhë:

(a) Pala për Mbështetje nuk ka përmbushur Kushtin e Pales për Mbështetje brenda Datës së Afatit Përfundimtar të Kushteve ose Datës së Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve (kjo e fundit vetëm nëse është e zbatueshme);

(b) Pala për Mbështetje nuk ka paguar ndonjë shumë të pakundërshtuar të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, e cila tejkalon Shumën e Mbështetjes së Kredisë brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e njoftimit nga Shitësi ku kërkohet shlyerja e kësaj shume të papaguar;

(c) Pala për Mbështetje është përfshirë në një Sjellje të Paligjshme me Dashje, ose kryen një shkelje materiale të një prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, që nuk mund të korrigjohet;

(d) pa cenuar nenet 17.1(a) dhe 17.1(c), Pala për Mbështetje kryen një shkelje materiale të një prej detyrimeve të tij sipas nenit 25, ose është në shkelje të një prej detyrimeve të saj materiale sipas kësaj Marrëveshjeje, që është e korrigjueshme por që Pala për Mbështetje nuk e ka korrigjuar brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh Pune nga marrja e kërkesës me shkrim të Shitësit për korrigjimin e kësaj shkeljeje;

(e) Pala për Mbështetje nuk ka siguruar ose nuk ka mbajtur asnjë Mbështetje të Kredisë të nevojshme, ose Mbështetja e Kredisë e siguruar nuk është më në fuqi dhe me efekte të plota sipas nenit 21;

(f) Pala për Mbështetje pëson një Rast të Paaftësisë Paguese ose ndërmerr veprime që tregojnë përparimin e, tregimin e pëlqimit, miratimit ose pranimit të Rastit të Paaftësisë Paguese;

(g) Pala për Mbështetje ia ka transferuar këtë Marrëveshje një subjekti tjetër në përputhje me nenet 6.3. dhe 6.4., por subjekti në fjalë nuk përmbush Vlerësimin Zyrtar të Kredisë dhe Kriteret Financiare për Garancinë e Performancës ose ka shkelur nenin 6.4;

(h) Pala për Mbështetje nuk zbaton përcaktimet e një vendimit arbitrazhi të dhënë sipas nenit 28;

(secila si "**Mospërmbushje nga ana e Palës për Mbështetje**").

17.2 Në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë, Pala për Mbështetje mund ta zgjidhë në çdo kohë këtë Marrëveshje nëpërmjet njoftimit me shkrim të Shitësit nëse një ose disa prej rasteve të mëposhtme ndodh dhe vazhdon të ndodhë:

(a) me kusht të miratimit nga Autoriteti Kontratkor, Shitësi nuk ka përmbushur Kushtet e Shitësit ose nuk ka përfunduar Kolaudimin e Impiantit, brenda Datës së Afatit Përfundimtar të Operimit Tregtar në përputhje me kushtet e kësaj Marreveshje;

(b) Shitësi nuk ka shlyer shumat e pakundërshtuara të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshje brenda tridhjetë (30) Ditësh Pune nga marrja e njoftimit të Pales për Mbështetje ku kërkohet shlyerja e kësaj shume të papaguar;

(c) Shitësi është përfshirë në një Sjellje të Paligjshme me Dashje ose kryen një shkelje materiale të ndonjërit prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, që nuk mund të korrigjohet;

(d) pa cenuar nenet 17.2(a) dhe 17.2(c) Shitësi kryen një shkelje materiale të një detyrimi sipas nenit 25, ose kryen një shkelje materiale të një prej detyrimeve të tij materiale sipas kësaj Marrëveshjeje, që është e korrigjueshme (pavarësisht kohës së përmbushjes) por që Shitësi nuk e ka korrigjuar brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh Pune nga marrja e kërkesës me shkrim të Pales për Mbështetje për korrigjimin e kësaj shkeljeje materiale;

(e) Shitësi pëson një Rast të Paaftësisë Paguese ose ndërmerr veprime që tregojnë përparimin e, tregimin e pëlqimit, miratimit ose pranimit të Rastit të Paaftësisë Paguese;

(f) Marrëveshja e Zhvillimit të Projektit është zgjidhur në përputhje me pikën 11.4(a) të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit;

(g) Shitësi nuk zbaton përcaktimet e një vendimi arbitrazhi të dhënë sipas nenit 23;

(h) Nëse, për dy (2) periudha të njëpasnjëshme gjashtëmujore (6) të vazhdueshme, ndodh si vijon:

(i) Disponueshmëria Energjetike totale e Impiantit është nën shtatëdhjetë për qind (70%); dhe

(ii) (ii) Prodhimi i Matur në Pikën e Livrimit është nën shtatëdhjetë për qind (70%) të prodhimit të parashikuar të Impiantit për periudhën dymbëdhjetë (12) mujore përkatëse bazuar në profilin mujor për Sezonin përkatës sikundër përcaktohet në Shtojcën 5 të kësaj Marrëveshjeje,

(i) Në rast se Impianti është palë e një Grupi Balancimi të operuar nga një palë e tretë e zgjedhur nga Shitësi në përputhje me nenet 7.13 deri në 7.14, ose në rast të përcaktimit të Sasisë së Kontratës në bazë të nominimeve, në lidhje me cilindo vit kalendarik, ndryshimi i akumuluar midis Nominimeve Përfundimtare të Prodhimit dhe Parashikimeve të Pavarura është me i lartë se [ ] perqind ([ ]%) ("**Ndryshimi/Varianca e Papranueshme**").

(secila si **"Mospërmbushje nga ana e Shitësit").**

17.3 Njëra prej Palëve mund ta zgjidhë menjëherë këtë Marrëveshje nëpërmjet njoftimit me shkrim tek Pala tjetër nëse i lind e drejta për këtë si rezultat i një ngjarjeje të zgjatur të Forcës Madhore (siç përcaktohet në nenin 20.3) ("**Rasti i Zgjidhjes pa Faj**").

17.4 Të gjitha shumat e pashlyera sipas Marrëveshjes por që ende nuk janë të kërkueshme dhe pagueshme në momentin e marrjes së njoftimit për zgjidhjen, bëhen të kërkueshme dhe pagueshme brenda dhjetë (10) Ditësh Pune nga marrja e njoftimit për zgjidhjen. Gjatë periudhës (nëse ka) ndërmjet njoftimit me shkrim për zgjidhjen dhe zgjidhjes, detyrimet e Shitësit për livrimin sipas Marrëveshjes dhe detyrimet e Pales për Mbështetje për shlyerjen e pagesave për livrimin në fjalë nuk cenohen.

17.5 Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje nga ndonjëra prej Palëve nuk cenon asnjë nga të drejtat, mjetet mbrojtëse ose detyrimet e secilës Palë përpara zgjidhjes, apo ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje që janë parashikuar shprehimisht apo në mënyrë të nënkuptuar se do të mbeten në fuqi pas zgjidhjes, duke përfshirë pa kufizim çdo dëmshpërblim sipas kësaj Marrëveshjeje për sa kohë që ky dëmshpërblim lidhet me një përgjegjësi të lindur përpara zgjidhjes së Marrëveshjes, këtij neni 17 dhe secilit prej neneve 8, 10,19,26,27,28 dhe 29.

17.6 Të drejtat e Pales për Mbështetje për të zgjidhur këtë Marrëveshje i nënshtrohen shtyrjes dhe të drejtave të tjera në favor të Institucioneve Financiare të cilat përcaktohen në Marrëveshjen e Drejtpërdrejtë për sa mund të zbatohen në lidhje me Impiantin.

17.7 Pala për Mbështetje njofton Institucionet Financiare me shkrim nëse parashikon në mënyrë të arsyeshme se do të ndërmarrë veprime sipas këtij neni 17, duke dhënë detajet që mund të kërkohen sipas kushteve të Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë.

## 18. DËMSHPËRBLIMI PËR ZGJIDHJEN

18.1 Në rastin kur kjo Marrëveshje zgjidhet nga ana e Shitësit për shkak të Mospërmbushjes nga ana e Pales për Mbështetje në përputhje me nenin 17.1, atëherë:

(a) sa më parë të jetë praktike në mënyrë të arsyeshme pas zgjidhjes, Shitësi përllogarit Humbjen e Shitësit 1 ose 2, si të jetë e zbatueshme, që ka pësuar si rezultat i kësaj zgjidhjeje dhe i dërgon Palës për Mbështetje një faturë për shumën e përllogaritur;

(b) Pala për Mbështetje i paguan Shitësit një shumë në vlerën e Humbjes së Shitësit 1 ose 2, si të jetë e zbatueshme, brenda [gjashtëdhjetë (60) Ditësh Pune] nga marrja e faturës;

(c) çdo pagese të kryer me vonesë i ngarkohet interesi në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm (pa përfshirë shumat që janë subjekt i një mosmarrëveshjeje *bona fide*, ku në këtë rast paguhen shumat e pakundërshtuara, dhe çdo pagesë e korrigjuar pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes sipas nenit 28 vetëm në lidhje me shumën e kundërshtuar do të ngarkohet me interes);

(d) e drejta për marrjen e këtyre pagesave (nëse ka) është (pa cenuar nenin 19.1) dëmshpërblimi ekskluziv i Shitësit për humbjet e shkaktuara atij si rezultat i zgjidhjes.

18.2 Në rastin kur kjo Marrëveshje zgjidhet nga Pala për Mbështetje për arsye të Mospërmbushjes nga ana e Shitësit sipas nenit 17.2:

(a) sa më parë të jetë praktike në mënyrë të arsyeshme pas zgjidhjes, Pala për Mbështetje përllogarit Humbjen e Palës për Mbështetje, që ka pësuar si rezultat i kësaj zgjidhjeje, dhe i dërgon Shitësit një faturë për shumën e përllogaritur;

(b) Shitësi i paguan Palës për Mbështetje një shumë në vlerën e Shumën e Zgjidhjes sipas Vlerës se Tregut të pesuar nga Pala per Mbështetje brenda [gjashtëdhjetë (60) Ditësh Pune] nga marrja e faturës;

(c) çdo pagese të kryer me vonesë i ngarkohet interesi në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm (pa përfshirë shumat që janë subjekt i një mosmarrëveshjeje *bona fide*, ku në këtë rast paguhen shumat e pakundërshtuara, dhe çdo pagesë e korrigjuar pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes sipas nenit 28 vetëm në lidhje me shumën e kundërshtuar do të ngarkohet me interes); dhe

(d) e drejta për marrjen e kësaj pagese (nëse ka) është (pa cenuar nenin 19.1) dëmshpërblimi ekskluziv i Palës për Mbështetje për humbjet e shkaktuara atij si rezultat i zgjidhjes.

18.3 Nëse Humbja e Shitësit apo e Palës për Mbështetje do të diskutohen apo kundërshtohen, atëherë zbatohet neni 28.

18.4 Secila nga Palët përballon humbjet e saj në rast se kjo Marrëveshje zgjidhet si rezultat i një Rasti Zgjidhjeje pa Faj.

## 19. PËRGJEGJËSIA

19.1 Asgjë në këtë Marrëveshje nuk përjashton apo nuk kufizon përgjegjësinë e secilës Palë në rastin e vdekjes apo dëmtimit të një personi të shkaktuar si pasojë e neglizhencës së , Sjelljes të Paligjshme me Dashje, ose deklarimit të rremë të asaj Pale.

19.2 Në përputhje me nenin 19,1 asnjëra nga Palët, apo nëpunësit, punëmarrësit ose agjentët e tyre, në asnjë rrethanë (përveç masës së përcaktuar në mënyrë të posaçme në këtë Marrëveshje) nuk mban përgjegjësi ndaj Palës tjetër për:

(a) humbje të shkaktuara nga pretendime të ngritura nga palë të treta të çfarëdolloj natyre; ose

(b) humbje të emrit të mirë apo reputacionit; ose

(c) humbje të tërthorta apo shkakësore.

19.3 Në përputhje me nenet 19.1, 19.2, dhe 19.3, të kësaj Marrëveshjeje, asnjë përgjegjësi tjetër e Palëve sipas apo në lidhje me këtë Marrëveshje nuk do të tejkalojë në cilëndo rrethanë [ ]Euro, *me kusht* që:

(a) ky nen 19.3 të mos kufizojë detyrimin ose përgjegjësinë e asnjerës Palë për dëmshpërblim për zgjidhje sipas neneve 19.1, 19.2, 19.3, ose për dëme të likuiduara të tjera sipas neneve 4 dhe 5, ose sipas ndonjë parashikimi tjetër të kësaj Marrëveshjeje e cila përcakton shprehimisht shumat për dëmet e likuiduara;

(b) ky nen 19.3, të mos kufizojë të drejtën e asnjërës Palë për të ngritur padi lidhur me detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë për shmangien e dyshimit, detyrimet sipas nenit 8.8., interesat e maturuara mbi këto detyrime që nuk llogariten për kufirin financiar të përcaktuar në këtë pikë).

## 20. FORCA MADHORE

20.1 Nëse njëra nga Palët pengohet në mënyrë të pjesshme ose të plotë si rezultat i një Ngjarje të Forcës Madhore për të përmbushur detyrimet e veta në këtë Marrëveshje dhe nëse Pala në fjalë i përmbahet kërkesave të nenit 20.2, atëherë nuk do të konsiderohet se nga ana e kësaj Pale të prekur ka ndodhur shkelje apo mospërmbushje dhe detyrimet përkatëse shuhen (dhe jo thjesht pezullohen) për një periudhë kohe dhe për sa kohë që Ngjarja e Forcës Madhore pengon përmbushjen e tyre. Duke përjashtuar rastet e përcaktuara në nenin 20.3, një Ngjarje e Forcës Madhore nuk i jep asnjërës Palë të drejtën të zgjidhë këtë Marrëveshje.

20.2 Pala e prekur nga Ngjarja e Forcës Madhore shkarkohet nga përgjegjësia në bazë të nenit 20.1 vetëm nëse:

(a) njofton me shkrim Palën tjetër, sapo të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme pas ndodhjes së Ngjarjes së Forcës Madhore, duke treguar se Ngjarja e Forcës Madhore në fjalë ka penguar apo vonuar në mënyrë të arsyeshme përmbushjen e detyrimeve të Palës së prekur dhe duke parashtruar masën dhe kohëzgjatjen e mundshme të parashikuar të Ngjarjes së Forcës Madhore në fjalë;

(b) ndërmerr të gjitha masat e arsyeshme për të zvogëluar ndikimin dhe korrigjuar pasojat e Ngjarjes së Forcës Madhore sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme; dhe

(c) i paraqet Palës tjetër një raport, të paktën çdo muaj, në lidhje me masat që po merr në përputhje me nenin 20.2 (b) dhe një përditësim mbi përmasën dhe kohëzgjatjen e mundshme të parashikuar të Ngjarjes së Forcës Madhore.

20.3 Sipas nenit 6 secila nga Palët mund ta zgjidhë në mënyrë të menjëhershme këtë Marrëveshje në çdo kohë nëpërmjet njoftimit me shkrim të Palës tjetër nëse një Ngjarje e Forcës Madhore pengon Palën e prekur që të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje për një

periudhë më të gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj të njëpasnjëshëm. Zgjidhja në këtë rast kryhet në përputhje me nenin 7.3

20.4 Sipas neneve 20.3, Afati zgjatet ditë pas dite kur njëra nga Palët pezullon detyrimet e veta nën këtë Marrëveshje për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore sipas këtij neni 20.

20.5 Afati nuk zgjatet në rast se Shitësi merr nga Autoriteti Kontraktues një shumë në vlerën e Pagesës së Disponueshmërisë në përputhje me nenin 17 të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit.

20.6 Në rastin kur Shitësi është Pala e prekur nga Ngjarja e Forcës Madhore dhe kur Ngjarja e Forcës Madhore në fjalë redukton Kapacitetin e Impiantit, Pala për Mbështetje mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje vetëm nëse Shitësi, në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë, nuk arrin ta rikthejë Impiantin në punë përgjatë një periudhe të vazhdueshme prej dymbëdhjetë (12) muajsh menjëherë pas ndodhjes së Ngjarjes së Forcës Madhore.

20.7 Pala e prekur nuk do të ketë asnjë detyrim për të paguar dëmet sipas kësaj Marrëveshjeje për sa i takon sasive të nominuara dhe Përfitimeve të Gjenerimit që nuk janë livruar ose pranuar për shkak të ndodhjes së Ngjarjes së Forcës Madhore.

## 21. MBËSHTETJA E KREDISË

21.1 Pavarësisht ndonjë transferimi të kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë të drejte apo përfitimi të parashikuar tek një Pale e Re per Mbeshtetje, i sipas nenit 5 të kësaj Marreveshjeje, Pala per Mbeshtetje siguron, nga Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve (ose, sipas rastit, Data e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve) deri në perfundim te Afatit, që në favor të Shitësit është realizuar dhe mbahet një Mbështetje e Kredisë e vlefshme në vlerë jo më të ulët se Shuma e Mbështetjes së Kredisë.

21.2 Palët pranojnë se:

(a) forma e një Garancie Bankare do të varet përfundimisht nga forma e kërkuar nga banka lëshuese, siç është rënë dakord me Shitësin;

(b) çdo Garanci Bankare zakonisht ka një afat vlefshmërie (që zgjat zakonisht deri në dy (2) vite nga data e lëshimit të saj) dhe, rrjedhimisht, Pala për Mbështetje merr përsipër që, në mënyrë të vazhdueshme deri në datën e përcaktuar në nenin 21.3, dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune përpara datës së përfundimit të Garancisë Bankare ekzistuese, të sigurojë një Garanci Bankare zëvendësuese.

21.3 Kur:

(a) një Rast i Paaftësisë Paguese ndodh në lidhje me Palën për Mbështetje;

(b) Mbështetja e Kredisë jepet në formën e një Garancie Bankare dhe Ofruesi i Mbështetjes së Kredisë së Garancisë Bankare nuk ka më një Vlerësim Zyrtar të Kredisë të barasvlershëm me apo më të lartë se Vlerësimi i Kërkuar i Bankës; ose

(c) Mbështetja e Kredisë jepet në një formë të rënë dakord ndërmjet Palëve që është e ndryshme nga Garancia Bankare apo Garancia e Pronarit dhe ndonjë nga kushtet apo prezumimet e vazhdueshme të dakortësuara midis Palëve në lidhje me Mbështetjen e Kredisë në fjalë është shkelur apo nuk është më i zbatueshëm,

(d) Pala për Mbështetje njofton menjëherë Shitësin për një ndryshim të tillë të rrethanave dhe brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditësh Pune nga këto rrethana siguron një Mbështetje të Kredisë të re apo zëvendësuese, sipas rastit, dhe ia jep këtë Shitësit.

21.4 Pala për Mbështetje ka të drejtë të zëvëndësojë një Mbështetje të Kredisë të lëshuar për një Mbështetje Kredie tjetër. Pala për Mbështetje siguron që Mbështetja zëvendësuese e Kredisë do të jetë e disponueshme jo më vonë se njëzet (20) Ditë Pune përpara skadimit të Mbështetjes së Kredisë ekzistuese (të hyjë në fuqi përpara ose në datën e skadimit). Në vijim të, cilado të ndodhë më vonë:

(a) marrjes së Mbështetjes zëvendësuese të Kredisë; dhe

(b) datës së hyrjes së saj në fuqi, , Shitësi i kthen menjëherë Palës për Mbështetje Mbështetjen origjinale të Kredisë që është zëvendësuar.

21.5 Shitësi ka të drejtë të ngrejë pretendime për ndonjë nga Mbështetjet e lëshuara të Kredisë nëse Pala për Mbështetje:

(a) nuk ka shlyer një pagesë të kërkueshme për të cilën detyrohet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe me marrjen e njoftimit të bërë nga Shitësi, Pala për Mbështetje nuk ka shlyer shumën e papaguar brenda dhjetë (10) Ditësh Pune; ose

(b) nuk ka siguruar një Mbështetje zëvendësuese të Kredisë më ose përpara dhjetë (10) Ditë Pune para përfundimit të saj.

21.6 Çdo shumë e paguar tek Shitësi sipas Mbështetjes së lëshuar të Kredisë do të kompensojë detyrimin e Palës për Mbështetje për ta paguar atë shumë sipas kësaj Marrëveshjeje (dhe që konsiderohet pagesë nga Pala për Mbështetje për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje) ose, kur ngrihet një pretendim në lidhje me nenin 21.4 (b), nëpërmjet garantimit të detyrimeve të Palës për Mbështetje sipas kësaj Marrëveshjeje deri në momentin e dhënies nga Palën për Mbështetje së një Mbështetje Kredie zëvendësuese të vlefshme.

21.7 Shitësi, sa më parë të jetë e mundur, rimburson Ofruesin e Mbështetjes së Kredisë për çdo shumë të paguar tek Shitësi sipas Mbështetjes së lëshuar të Kredisë si rezultat i një pretendimi të gabuar nga ana e Shitësit lidhur me çdo Mbështetje të lëshuar të Kredisë.

21.8 Kur Pala për Mbështetje nuk ka më detyrimin për të mbajtur një Mbështetje të Kredisë sipas nenit 21.1, Shitësi (me kërkesë të Palës për Mbështetje), sa më parë të jetë praktike në mënyrë të arsyeshme, i kthen Palës për Mbështetje ose Ofruesit të Mbështetjes së Kredisë çdo Mbështetje të Kredisë të lëshuar që ai mban.

## 22. SIGURIMI

22.1 Shitësi, në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë, mban në fuqi (ose siguron që mbahen në fuqi) me një sigurues me reputacion të mirë për kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje, policat e sigurimit që konsiderohen të përshtatshme dhe të duhura sipas Praktikës së Mirë të Industrisë, duke mbajtur parasysh detyrimet e Shitësit sipas kësaj Marrëveshje dhe marrëveshjeve financiare me Institucionet Financiare. Shitësi, me marrjen e njoftimit të arsyeshëm, i paraqet sa më parë Palës për Mbështetje dëshmi (nëpërmjet vërtetimit të sigurimit) për sigurimin përkatës.

22.2 Shitësi, në rastin kur shkaktohen dëmtime të Impiantit si pasojë e një ngjarje që duhet të sigurohet sipas përcaktimit të nenit 22.1, sa më parë të jetë praktike në mënyrë të arsyeshme, njofton Palën për Mbështetje në lidhje me dëmin e shkaktuar dhe veprimet korrigjuese që Shitësi propozon se duhen kryer.

## 23. NËNKONTRAKTIMI DHE KALIMI

23.1 Pa cenuar nenin 6, asnjëra nga Palët nuk mund të nënkontraktojë pjesërisht apo plotësisht detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshje pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, *me kusht* që, me marrjen e këtij miratimi, Pala nënkontraktuese do të mbajë përgjegjësi për përmbushjen e detyrimeve të veta në çdo kohë pavarësisht nënkontraktimit.

23.2 Pa cenuar nenin 6, asnjëra nga Palët nuk mund të kalojë dhe transferojë të gjithë ose disa prej të drejtave dhe detyrimeve të veta sipas kësaj Marrëveshjeje tek një palë e tretë pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, ku ky miratim të mos refuzohet apo vonohet pa arsye, me kusht që është e arsyeshme që njëra nga Palët të refuzojë dhënien e miratimit për transferimin e detyrimeve nga Pala tjetër kur beson në mënyrë të arsyeshme se përfituesi i propozuar i transferimit ka një gjendje financiare apo njohuri teknike të pamjaftueshme për të përmbushur detyrimet e transferuesit sipas kësaj Marrëveshjeje.

23.3 Shitësi mund t'i kalojë të drejtat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje me anë të garancive tek ose në favor të çdo Institucioni Financues në lidhje me financimin ose ri-financimin e detyrimeve të tij të këtushme apo aktiviteteve të tij tregtare pa pëlqimin e Palës për Mbështetje. Shitësi njofton sa më parë të jetë praktikisht e mundur Palën për Mbështetje për këtë kalim.

23.4 Pala për Mbështetje kur kërkohet nga Shitësi ose Institucionet Financiare, hyn në një Marrëveshje të Drejtpërdrejtë (ose Marrëveshje të Drejtpërdrejtë zëvendësuese, sipas rastit) me Shitësin dhe ndonjë Institucion Financiar brenda tridhjetë (30) Ditë Pune nga marrja e njoftimit me shkrim nga Shitësi ose Institucionet Financiare ku i kërkohet Palës për Mbështetje që të dorëzojë të nënshkrur një Marrëveshje të Drejtpërdrejtë në përputhje me këtë Marrëveshje.

## 24. NDRYSHIMI I LIGJIT

24.1 Nëse ndonjëra nga Palët gjykon se ka ndodhur një Ndryshim i Ligjit që:

(a) e bën të pamundur ose të paligjshme dhënien e fuqisë ligjore kësaj Marrëveshjeje;

(b) bën të pamundur konstatimin e ndonjë çështjeje materiale që kërkohet të konstatohet sipas kësaj Marrëveshjeje;

(c) bën që dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të jenë në kundërshtim me Legjislacionin e Zbatueshëm (duke përfshirë çdo fjalë ose shprehje të kësaj Marrëveshjeje që përkufizohet duke iu referuar kuptimit të saj në Legjislacionin e Zbatueshëm);

(d) prezanton, zëvendëson, ndryshon apo shuan një Përfitim Gjenerimi apo nëse Rasti i Revokimit ka ndodhur si pasojë e një Ndryshimi të Ligjit; ose

(e) (pa cenuar nenin 24.1 (a) deri 24.1 (d) përfshirë më sipër), ndikon në mënyrë të konsiderueshme dhe negativisht në përfitimet e kësaj Marrëveshjeje për ndonjërën apo të dyja Palët,

atëherë kjo Palë mund të njoftojë Palën tjetër duke kërkuar që Palët të takohen për të diskutuar rrethanat në fjalë dhe në mirëbesim të përpiqen të bien dakord për ndryshimet që duhet të bëhen në këtë Marrëveshje, që janë të nevojshme për të arritur (sa më shumë të jetë e mundur) të njëjtin ekuilibër të përfitimeve, detyrimeve, rreziqeve dhe shpërblimeve ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje sikurse zbatohet në Datën e Hyrjes në Fuqi. Nëse një rast mund të përbëjë njëkohësisht Paefektshmëri dhe Ndryshim të Ligjit, atëherë ky do të konsiderohet vetëm si Ndryshim i Ligjit.

24.2 Në qoftë se Palët nuk arrijnë të bien dakord sipas nenit 24.1, secila Palë ka të drejtë ta dërgojë çështjen në Qendrën për Zgjidhjen dhe Negocimin e Mosmarrëveshjeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për përcaktimin e ndryshimeve që duhet t'i bëhen kësaj Marrëveshjeje që janë të nevojshme për të arritur (sa më shumë të jetë e mundur) të njëjtin ekuilibër të përfitimeve, përgjegjësive, rreziqeve dhe shpërblimeve ndërmjet Palëve lidhur me objektin e kësaj Marrëveshjeje sikurse zbatohet në Datën e Hyrjes në Fuqi. Nëse një çështje nuk është zgjidhur brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh Pune (apo brenda një kohe tjetër të miratuar nga Palët) nga referimi për ndërmjetësim në Qendrën për Zgjidhjen dhe Negocimin e Mosmarrëveshjeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, secila nga Palët mund të nisë procedurat për arbitrazh ndërkombëtar në përputhje me nenin 28.5.

24.3 Për shmagjen e dyshimeve, nuk është qëllim i asnjërës nga Palët që luhatjet në çmimet e tregut me shumicë të energjisë elektrike në vetvete (në ndryshim nga luhatjet e shkaktuara nga Ndryshimet e Ligjit) të shkaktojnë ndryshime sipas këtij neni 24.

24.4 Kur një marrëveshje apo zgjidhje sipas nenit 24.1 ose 24.1, ndodh pas Ndryshimit të Ligjit, kjo marrëveshje apo zgjidhje duhet të marrë parasysh çdo korrigjim të nevojshëm për t'i vendosur Palët në pozicionin në të cilin do të ishin nëse marrëveshja apo zgjidhja do të kishte ndodhur menjëherë përpara Ndryshimit përkatës të Ligjit.

24.5 Pa cenuar dispozitat e tjera të këtij neni 24, Palët bien dakord që:

(a) asnjë Palë nuk mban përgjegjësi për mospërmbushjen e ndonjë detyrimi sipas kësaj Marrëveshjeje që bëhet i ndaluar ose i pamundur për t'u përmbushur për shkak të një Ndryshimi të Ligjit (dhe një rrethanë e tillë do të përbëjë një Ngjarje të Forcës Madhore);

(b) sipas nenit 24.5 (a) Ndryshimi i Ligjit në vetvete nuk përbën Ngjarje të Forcës Madhore, dhe nuk i jep të drejtë asnjërës nga Palët të pezullojë ose shuajë detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje;

secila Palë do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të minimizuar dhe zbutur pasojat e Ndryshimeve të Ligjit për përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

24.6 Nëse Palët vendosin bashkërisht, Qendra për Zgjidhjen dhe Negocimin e Mosmarrëveshjeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (në përputhje me nenin24.2) ose një vendim arbitrazhi (i marrë në përputhje me nenin 28) përcakton se nuk mund të bëhen rregullime të arsyeshme të kësaj Marrëveshjeje për qëllime të trajtimit të ndikimit të Ndryshimit të Ligjit në përmbushjen e detyrimeve në këtë Marrëveshje, çështja zgjidhet nëpërmjet zbatimit të dispozitave të nenit 17 të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit.

## 25. DEKLARIMET, GARANCITË DHE ANGAZHIMET

25.1 Secila Palë merr përsipër që (gjatë afatit të kësaj Marrëveshjeje) do të:

(a) ketë, mbajë dhe përmbushë kërkesat e të gjitha autorizimeve dhe miratimeve për të cilat Pala ka përgjegjësinë për t'i siguruar dhe mbajtur;

(b) veprojë në përputhje me të gjithë Legjislacionin e Zbatueshëm (duke përfshirë, pa kufizim, Kodin Shqiptar të Rrjetit), dhe, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të saj të qëllimshme apo të pakujdesshme, nuk do të bëjë që Pala tjetër të shkelë Legjislacionin e Zbatueshëm apo këtë Marrëveshje; dhe

(c) t'i japë Palës tjetër të gjitha dokumentet, të dhënat, certifikatat apo informacione të tjera në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje me kërkesën e arsyeshme të Palës tjetër (gjithashtu dhe në lidhje me kërkesën e bërë ndaj Palës tjetër nga një Autoritet Kompetent për sa më sipër), dhe do t'i dorëzojë çdo Autoriteti Kompetent të gjitha dokumentet, të dhënat, certifikatat apo informacione të tjera në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje që mund të kërkohen herë pas here nga ana e Autoritetit Kompetent.

25.2 Shitësi deklaron dhe garanton Palën për Mbështetje që, duke nisur që prej Datës së Hyrjes në Fuqi (deklarata dhe garanci që do të konsiderohen se përsëriten nga secila Palë në fillimin e Periudhës së Furnizimit):

(a) është i organizuar në mënyrë të rregullt dhe ekziston në mënyrë të vlefshme sipas ligjeve të juridiksionit në të cilin është organizuar ose themeluar (dhe, nëse kërkohet sipas këtij legjislacioni përkatës, është në gjendje të mirë financiare);

(b) ka kompetencë për të:

(i) nënshkruar këtë Marrëveshje dhe çdo dokumentacion tjetër të lidhur me të në të cilin është palë (duke përfshirë Marrëveshjen e Drejtpërdrejtë);

(ii) zbatuar këtë Marrëveshje dhe çdo dokumentacion tjetër të lidhur me të, zbatimi i të cilëve kërkohet nga kjo Marrëveshje; dhe

(iii) përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje dhe ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të autorizuar nënshkrimin, zbatimin dhe përmbushjen e saj;

(c) nënshkrimi, zbatimi dhe përmbushja e referuar në nenin 25.2 (b) (iii) nuk shkelin apo bien ndesh me asnjë Legjislacion të Zbatueshëm, dispozitë të dokumenteve statutore të tij, urdhër apo vendim gjyqësor apo të ndonjë agjencie qeveritare që i zbatohet atij apo aseteve të tij ose kufizime kontraktuale të detyrueshme për ose që prekin atë apo ndonjë nga asetet e tij;

(d) detyrimet në këtë Marrëveshje përbëjnë detyrimet e tij ligjore, të vlefshme dhe të zbatueshme e të ekzekutueshme në përputhje me kushtet përkatëse sipas ligjeve të zbatueshëm për falimentimin, riorganizimin, paaftësinë paguese, moratoriumin apo ligje të tjera të ngjashme që prekin të drejtat e kreditorit në përgjithësi;

(e) nuk ka ndodhur asnjë Rast Mospërmbushjeje (apo rast që nëpërmjet njoftimit dhe/ose kalimit të kohës do të përbënte Rast Mospërmbushjeje) lidhur me të dhe se një rast i

tillë nuk do të ndodhte si rezultat i hyrjes së tij në këtë Marrëveshje apo përmbushjes së detyrimeve të tij sipas saj;

(f) asnjë padi ose procedurë gjyqësore, arbitrazhi apo administrative para një gjykate, tribunali, organi qeveritar, agjencie, zyrtari apo arbitri nuk ka filluar ose, në dijeninë e tij, nuk është kërcënuar se do të fillojë kundër tij apo Shoqërive të lidhura me të që, nëse do të zgjidhej jo në favor të tij, do të shkaktonte një ndryshim material negativ në gjendjen financiare të kësaj Pale apo në aftësinë e saj për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, ose që mund të ndikojë në ligjshmërinë, vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ndaj tij;

(g) nuk mbështetet në asnjë deklaratë të Palës tjetër të ndryshme nga ato të përcaktuara shprehimisht në këtë Marrëveshje.

## 26. NJOFTIMET

26.1 Çdo njoftim apo komunikim ndërmjet Palëve në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të kryhet në formë të shkruar, dhe konsiderohet i dorëzuar rregullisht nëse dorëzohet personalisht, me postë të regjistruar me parapagesë, me faks, ose postë elektronike në adresën e marrësit ose (sipas rastit) në numrin e faksit ose adresën e postës elektronike të paraqitur më poshtë (apo në adresën ose numrin faks të njoftuar paraprakisht në përputhje me nenin 26); *me kusht që*, nëse nuk është dhënë adresa postare, posta elektronike dhe/ose numri faks për marrjen e njoftimeve të caktuara, këto njoftime nuk do të dorëzohen në mënyrë të vlefshme nëpërmjet këtyre mënyrave të komunikimit.

26.2 Sipas nenit 26, të dhënat fillestare të Palëve për njoftimet janë si më poshtë:

(a) Për Shitësin:
(i) Adresa:

(ii) Adresa e email-it:

(b) Për Palën për Mbështetje:
Adresa:

Adresa e email-it:

26.3 Në përputhje me nenin 26.4, një njoftim do të konsiderohet i marrë:

(a) në rastin e dorëzimit dorazi, në momentin e dorëzimit;

(b) në rastin e dërgesës me postë të regjistruar të parapaguar, në ditën e dytë nga data e postimit;

(c) në rastin e dërgesës me faks, në momentin e pranimit nga makina e faksit të marrësit; *me kusht* që të dërgohet dhe një kopje me postë të parapaguar të klasit të parë brenda një (1) Dite Pune; dhe

(d) në rastin e dërgesës me postë elektronike, në momentin e mbërritjes në serverin e marrësit dhe nëse dërguesi nuk merr mesazh që ka ndodhur gabim.

26.4 Çdo njoftim që konsiderohet si i marrë në një ditë që nuk është Ditë Pune, apo pas orës 17:00 me orën lokale në vendndodhjen e marrësit në një Ditë Pune, konsiderohet se është marrë në orën 09:00 me orën lokale në vendndodhjen e marrësit në Ditën e nesërme të Punës.

## 27. KONFIDENCIALITETI DHE PUBLICITETI

27.1 Në përputhje me përjashtimet sipas nenit 27.2, dhe 27.3, nga Data e Hyrjes në Fuqi deri në mbarimin apo zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje ose brenda një periudhe dyvjeçare (2) pas mbarimit apo zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje, asnjë nga Palët nuk do të japë informacion apo nuk do të lejojë apo nuk do të mundësojë që zyrtarët, punëmarrësit, agjentët apo kontraktorët e saj të japin informacion ndonjë personi apo entiteti për përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje ose çdo informacion konfidencial tregtar lidhur me negociatat rreth kësaj Marrëveshjeje të cilat mund t'i jenë bërë të njohura Palës gjatë zhvillimit të negociatave të tilla apo lidhur me veprimet, kontratat, marrëveshjet ose çështjet tregtare apo financiare të Palës tjetër, pa pëlqimin e Palës tjetër.

27.2 Kufizimet e vendosura në nenin 27.1, nuk do të zbatohen për dhënien e informacionit:

(a) që aktualisht apo në të ardhmen bëhet publik përveç rastit kur bëhet publik si rezultat i shkeljes së detyrimit të konfidencialitetit ose që mund të merret nga burime të tjera përveç Palëve;

(b) kur dhe në masën e kërkuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm për t'ju dhënë çdo personi të autorizuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm për ta marrë atë;

(c) kur dhe në masën e kërkuar për t'u dhënë nga rregullat e ndonjë burse të njohur në të cilën aksionet e Palës që jep informacionin janë apo propozohen për kuotim apo listim herë pas here;

(d) kur dhe në masën e kërkuar për t'u dhënë në një gjykatë, arbitër apo gjykatë administrative gjatë procedurave para saj në të cilat Pala që jep informacionin është palë;

(e) që njëra Palë i jep një zyrtari apo punëmarrësi të saj ose një Shoqërie të lidhur apo zyrtar ose punëmarrësi të Shoqërisë së lidhur të cilët e kërkojnë informacionin për t'i mundësuar kryejen e duhur të detyrave të tyre, *me kusht* që këta persona të zbatojnë detyrimet e konfidencialitietit njëlloj me ato që parashikohen në këtë nen 27;

(f) që njëra Palë i jep ndonjerit prej konsulentëve, bankave, financierëve, siguruesve ose këshilltarëve të saj ose ndonjërës prej Shoqërive të lidhura apo konsulentëve, bankave, financierëve, siguruesve ose këshilltarëve të Shoqërisë së lidhur, *me kusht* që këta persona të zbatojnë detyrimet e konfidencialitetit njëlloj me ato që parashikohen në këtë nen 27;

(g) që Shitësi i jep një investitori të mundshëm *në mirëbesim*, ose një blerësi të mundshëm *në mirëbesim* të aksioneve të Shitësit ose të aseteve që përbëjnë Impiantin (ose konsulentëve, bankave, financierëve ose këshilltarëve të tyre profesionalë), *me kusht* që këta persona të zbatojnë detyrimet e konfidencialitetit njëlloj me ato që parashikohen në këtë nen 27.

27.3 Pa cenuar të drejtat ose mjetet e tjera mbrojtëse që mund të ketë njëra Palë, Palët njohin dhe pranojnë se dëmet nuk do të përbëjnë masën ndreqëse të duhur për asnjë nga shkeljet sipas këtij neni 20 dhe se mjetet ligjore të masës së sigurimit, kryerjes së një veprimi të caktuar apo masa të tjera të ngjashme janë masa të duhura për çdo shkelje potenciale apo aktuale të kësaj dispozite.

## 28. LIGJI RREGULLUES DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

28.1 Kjo Marrëveshje dhe çfarëdo mosmarrëveshje apo pretendim që rrjedh nga apo lidhet me të (duke përfshirë pretendimet jashtëkontraktuale) rregullohet nga dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë.Palet mund ti drejtohen ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëse nuk parashikohet ndryshe në kushtet e veçanta të marrevehejs për mbeshtetje. Nëçdo rast në kushtet e veçanta të marrëveshjes, palët duhet te mbeshtetet në përcaktimet e pergjithshme në nenin 28.2 e në vijim.

28.2 Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga apo lidhet me këtë Marrëveshje (përfshirë çdo pretendim për ekzistencën, vlefshmërinë ose zgjidhjen e saj) i referohet fillimisht drejtorit të secilës Palë, të cilët do të takohen në mirëbesim për të zgjidhur mosmarrëveshjen brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve Pune që nga data e parashtrimit të mosmarrëveshjes tek ata.

28.3 Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet në këtë takim, atëherë:

(a) palët mund të bien dakord të kërkojnë mendimin pa efekte detyruese të Entit Rregullator Shqiptar të Energjisë;

(b) nëse mosmarrëveshja ka të bëjë me një çështje që sipas kësaj Marrëveshje parashikohet shprehimisht se do të zgjidhet nga Qendra për Zgjidhjen dhe Negocimin e Mosmarrëveshjeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (ose nëse Palët bien dakord që çështja duhet të zgjidhet nga Qendra për Zgjidhjen dhe Negocimin e Mosmarrëveshjeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë), Palët do të kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me Aktin Procedural 2018/5/EnC të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë;

(c) nëse mosmarrëveshja ka të bëjë me:

(i) përcaktimin e Produktit të Matur;

(ii) përllogaritjen e Pagesës së Elektricitetit;

(iii) përmbushjen nga Shitësi të Kushteve të Shitësit;

(iv) kryerjen e kolaudimit brenda Tolerancës, deri në Datën e Afatit Përfundimtar të Operimit Tregtar;

(v) Garancia e Disponueshmërisë ose Dëmet e Likuiduara të Disponueshmërisë Energjetike;

(vi) rezultati i Vlerësimit të Gadishmërisë së Tregut;

(vii) Përcaktimi i Sasisë së Kontratës me qëllim kryerjen e pagesave të Kontratës së Diferences;

(viii) Diferenciali i Çmimit për Kontratën e Diferencës;

(ix) Përcaktimi i një Rasti Ndërprerje Tregu;

(x) Përcaktimi i Indeksit të Zëvendësimit;

çështja do të zgjidhet nëpërmjet vendimit të Ekspertit në përputhje me nenin 28.4; ose

(d) në të kundërt, mosmarrëveshja do të zgjidhet në arbitrazh ndërkombëtar në përputhje me nenin 28.5;

28.4 Në rastin kur ky nen 28.4, zbatohet në përputhje me nenin28.3, zbatohen dispozitat si më poshtë:

(a) çdonjëra nga Palët mund ta referojë çështjen për zgjidhje nga Eksperti nëpërmjet një kërkese me shkrim tek Pala tjetër për referimin e mosmarrëveshjes për zgjidhje nga Eksperti, që përfshin emrin e Ekspertit të propozuar;

(b) nëse Palët nuk bien dakord për caktimin e Ekspertit dhe/ose për kushtet e caktimit të Ekspertit, brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditësh Pune nga njoftimi, Eksperti caktohet (me kërkesë të çdonjërës nga Palët) nga Emëruesi i Pavarur;

(c) në përputhje me këto parashikime, zgjidhja e çështjes së mosmarrëveshjes do të kryhet në përputhje me Marrëveshjen Model të Zgjidhjes nga Eksperti në fuqi herë pas here të Qendrës për Zgjidhjen e Efektshme të Mosmarrëveshjeve;

(d) Eksperti vepron si ekspert dhe jo si arbitër;

(e) Eksperti duhet të arsyetojë me shkrim vendimin e tij;

(f) duke përjashtuar rastet e mashtrimit apo gabimit të dukshëm, vendimi i Ekspertit sipas nenit 28.4, është përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët dhe i zbatueshëm si detyrim kontraktual;

(g) të gjitha çështjet për zgjidhje nga Eksperti dhe vendimi i Ekspertit do të jenë në gjuhën angleze dhe me shkrim; dhe

(h) secila nga Palët do të mbulojë plotësisht kostot e saj dhe gjysmën e kostove të Ekspertit dhe të këshilltarëve të pavarur të Ekspertit, përveçse kur Eksperti (në diskrecionin e tij/saj) përcakton ndryshe.

28.5 Në përputhje me nenin 28.3 dhe 28.4, çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga apo në lidhje me këtë Marrëveshje (duke përfshirë mosmarrëveshjet lidhur me ekzistencën, vlefshmërinë ose zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje apo detyrimeve jashtë kontraktore që rrjedhin nga apo në lidhje me këtë Marrëveshje) referohen dhe zgjidhen përfundimisht nëpërmjet arbitrazhit sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) ("**Rregullat**"). Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga tre (3) arbitra të caktuar në përputhje me Rregullat. Selia e arbitrazhit do të përcaktohet nga palët në kushtet kushtet e veçanta të marrëvshjes. Gjuha e arbitrazhit është gjuha angleze.

28.6 Asnjëra Palë nuk do të pezullojë apo nuk do të shkarkohet nga përmbushja e detyrimeve përkatëse, përfshirë detyrimet për pagesat, që rrjedhin nga kjo Marrëveshje deri kur çdo mosmarrëveshje të jetë zgjidhur përfundimisht sipas mënyrës së parashikuar këtu.

28.7 Lindja e çdo mosmarrëveshjeje apo vazhdimi i procedurave të zgjidhjes së mosmarrëveshjes nuk do të cenojë detyrimet e Palëve për kryerjen e pagesave në zbatim të kësaj Marrëveshjeje. Një shumë e tillë do të konsiderohet e kërkueshme dhe do të paguhet plotësisht në pritje të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Rakordimi i shumave të paguara do të kryhet menjëherë pas dhe bazuar në zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes.

## 29. DISPOZITA TË NDRYSHME

29.1 Asnjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet se parashikon ndonjë dëmshpërblim për humbje, dëme, kosto apo shuma të tjera për të cilat Pala e dëmtuar është dëmshpërblyer për të njëjtën humbje, dëm, kosto apo shumë sipas ndonjë prej dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes tjeter te lidhur me Projektin.

29.2 Në rastet kur njëra Palë i akordon Palës tjetër një periudhë falje, lehtësie ose shtyrje afati, ose nuk zbaton apo nuk ushtron ndonjë prej të drejtave ose mjeteve të saj ligjore, ose vonon të veprojë si më lart, të drejtat dhe mjetet ligjore të asaj Pale lidhur me këtë Marrëveshje nuk pakësohen, nuk hiqet dorë nga ato ose nuk shuhen në asnjë rast.

29.3 Nëse njëra nga Palët heq dorë nga shkelja e kësaj Marrëveshjeje, gjithësesi ajo ruan të drejtën e zbatimit të asaj dispozite në të ardhmen dhe heqja dorë nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga shkeljet në të ardhmen të asaj apo një dispozite tjetër.

29.4 Në rast se, në çdo kohë një pjesë e kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë një ose disa nene të kësaj Marrëveshjeje apo nën-nen apo paragraf apo një pjesë e një ose më shumë prej këtyre neneve) është apo bëhet e pavlefshme ose e pazbatueshme për çfarëdo arsye sipas Legjislacionit të Zbatueshëm, ajo do të hiqet nga kjo Marrëveshje, dhe pjesa e mbetur e kësaj Marrëveshjeje do të lexohet sipas rastit dhe vlefshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikohet apo kufizohet për shkak të asaj pjese të hequr.

29.5 Secila Palë bie dakord që të bëjë dhe të kryejë herë pas here veprime të tjera apo të mëtejshme dhe të zbatojë dhe të ekzekutojë çdo dhe të gjithë aktet që mund të kërkohen nga ligji apo në mënyrë të arsyeshme nga Pala tjetër për krijimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe mjeteve ligjore të Palës tjetër dhe për zbatimin e përmbushjen e objektit dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

29.6 Në çdo kohë pas Datës së Hyrjes në Fuqi, Palët do të ushtrojnë dhe do të bëjnë çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar se çdo palë e tretë sipas rastit do të zbatojë ato dokumente dhe do të kryejë ato veprime që kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga një Palë me qëllim që kjo Palë të përfitojë plotësisht nga të gjithë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

29.7 Kjo Marrëveshje përbën tërësinë e marrëveshjes ndërmjet Palëve lidhur me objektin e saj. Secila nga Palët heq dorë në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar nga e drejta për ngritur pretendime për dëme, ose për ta anuluar këtë Marrëveshje për shkak të shkeljes së një garancie që nuk parashikohet shprehimisht në këtë Marrëveshje, apo për shkak të ndonjë deklarimi të gabuar parashikuar apo jo në këtë Marrëveshje, me përjashtim të deklarimit të rremë.

29.8 Një person që nuk është palë e kësaj Marrëveshjeje (përfshirë cilindo punëmarrës, zyrtar, agjent, përfaqësues apo nënkontraktor të cilësdo palë) nuk ka të drejtë të kërkojë zbatimin e asnjë prej kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

29.9 Asgjë në këtë Marrëveshje nuk krijon apo konsiderohet se krijon një ortakëri, apo bashkim tregtar apo një marrëdhënie punëdhënës-punëmarrës apo porositës-agjent ndërmjet Palëve dhe asnjë punëmarrës i një Pale nuk do të konsiderohet se është apo është bërë punëmarrës i Palës tjetër.

29.10 Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, asnjëra Palë nuk ka të drejtë të marrë dëmshpërblim apo të ngrejë një pretendim sipas kësaj Marrëveshjeje lidhur me një humbje ose dëm që ka pësuar, nëse ka marrë më parë dëmshpërblim për atë humbje ose dëm sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit, të ardhurave nga sigurimi ose të tjera.

Asnjë Palë nuk ka të drejtë të zhdëmtohet për dëmet e pësuara apo të përfitojë shtyrje afati, pagesë, rimbursim, kthim  apo zhdëmtim më shumë se njëherë për të njëjtën humbje.

29.11 Palët në ketë marrëveshje mund të vendosin plotësimin e shtojcave qe lidhen me; impiantin vendndodhja, aparati matës; profilet sezonale dhe objektivat; formula për dëmet e likuiduara të disponueshmërisë energjitike; formula për dëmet e likuiduara të disponueshmërisë energjetike.

29.12 Kjo Marrëveshje është hartuar në tri (3) kopje në gjuhën shqipe dhe tri (3) kopje në gjuhën angleze. Në rast mospërputhjeje midis versionit në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën angleze, do të ketë përparësi versioni në gjuhën shqipe.

**FAQJA E NËNSHKRIMEVE**

Në emër dhe për llogari të

…………………………………………………….

Në emër dhe për llogari të

…………………………………………………….

## SHTOJCA 1: IMPIANTI, PLANI I VENDNDODHJES DHE VENDI I APARATIT MATËS

### Impianti

**Vendndodhja**

**Vendi i Aparatit Matës**

**SHTOJCA 2: FORMA E GARANCISË BANKARE**

[***LETËR ME KOKË E BANKËS TREGTARE LËSHUESE***]

Për:
[*Emri i Bankës Tregtare*]
*[Adresa]*
Vendi i Lëshimit: [*VENDI]*
Data e lëshimit: [*DATA*]
Letër Garanci Nr. ______________

**NDËRMJET:**

***[Emri i Bankës Tregtare]***, ***[adresa e bankës tregtare]*** referuar më tej si "**Garantuesi**";

***[emri i shoqërisë***], ***[adresa e shoqërisë]*** referuar më tej si "**Principali**"; dhe

***[emri i përfituesit]***, ***[adresa e përfituesit tregtar]*** referuar më tej si "**Përfituesi**";

**1.PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME**

1.1 Në këtë Garanci fjalët e mëposhtme kanë këto kuptime:

> "**Marrëveshja**" nënkupton Marrëveshjen per Diferencat të datës [*data*] ndërmjet principalit dhe përfituesit;
>
> "**Detyrimet e Garantuara**" nënkupton detyrimet e pagesës së principalit të marra përsipër nga ai për çdo transaksion të kryer në përputhje me Marrëveshjen gjatë periudhës nga [*data*] deri në dhe përfshirë [*data*];
>
> "**Ditë Pune**" është dita (përveç të shtunës dhe të dielës) kur bankat janë hapur për punë në Tiranë, Shqipëri dhe [*vendndodhja*]; dhe
>
> "**Vlera tavan**" nënkupton [përgjatë Periudhës së Tregtimit I, vlera që i korrespondon shumës që duhen për të mbuluar 3 muaj pagesa të MBE-së, në varesi të Impiantit; përgjatë Periudhës së Tregtimit II vlera që i korrespondon shumës që duhen për të mbuluar 3 muaj pagesa CfD, në varësi të Impiantit dhe Sasisë së Kontratës] Euro në total lidhur me secilën dhe të gjitha kërkesat e këtushme, subjekt i ndryshimeve në përputhje me paragrafin 4 më poshtë.

Për sa kohë nuk përcaktohet ndryshe, çdo referencë në këtë garanci për "**Garantuesin**", "**Principalin**" ose "**Përfituesin**" interpretohet se përfshin pasardhësit e tij, përfituesit e lejuar të kalimit dhe përfituesit e lejuar të transferimit;

**2. GARANCIA**

2.1. Me kërkesë të Principalit dhe si shpërblim për Përfituesin që ka hyrë në transaksionet sipas Marrëveshjes, Garantuesi, në mënyrë të pakthyeshme të pakushtëzuar:

> (a) garanton për Përfituesin përmbushjen e përpiktë nga ana e Principalit të detyrimeve të garantuara; dhe
>
> (b) merr përsipër përkundrejt Përfituesit se do t'i paguajë, si i detyruari kryesor, shumën apo shumat e kërkueshme dhe të pagueshme por të papaguara nga Principali me kërkesën më të parë me shkrim

(dhe heq dorë nga të gjitha të drejtat për kundërshtim dhe ushtrimin e mjeteve mbrojtëse kundër Principalit) brenda 7 Ditësh Pune nga marrja e kësaj kërkese me shkrim nga Përfituesi, me kusht që ajo të jetë thelbësisht në formën e përcaktuar në paragrafin 4 më poshtë, dhe në përputhje me paragrafin 3 si më poshtë.

**3. SHUMA E GARANCISË**

3.1 Shuma maksimale e pagueshme nga Garantuesi për Përfituesin sipas kësaj Garancie nuk do të kalojë vlerën tavan. Vlera tavan do të ulet herë pas here me një shumë të barabartë me vlerën e pagesës së principalit të kryer në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar nga Principali tek Përfituesi në lidhje me detyrimet e garantuara në përputhje me Marrëveshjen.

3.2 Me marrjen nga Përfituesi të këtyre pagesave nga Principali, Përfituesi konfirmon nëpërmjet swift-it marrjen e pagesës brenda 7 Ditësh Pune dhe se pranon që vlera tavan të ulet në përputhje me kushtet.

3.3 Pas marrjes së konfirmimit nga Përfituesi se ka marrë pagesat nga Principali, Garantuesi do t'i dërgojë Përfituesit një ndryshim nëpërmjet swift-it ku do të specifikojë shumën maksimale të re.

**4. FORMA E KËRKESËS**

4.1 Çdo kërkesë e Përfituesit sipas kësaj Garancie i dorëzohet Garantuesit në formën swift [dhe duhet të nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Përfituesit]. Kërkesa duhet të jetë thelbësisht në formën bashkëngjitur kësaj Garancie si shtojcë dhe:

(a) deklaron që Principali ka shkelur Detyrimet e Garantuara;

(b) përcakton mënyrën e shkeljes së kryer nga Principali; dhe

(c) përcakton shumën e detyrueshme dhe të pagueshme nga Principali.

4.2 Për shmangien e dyshimeve, Garantuesi është i autorizuar dhe, në çdo kohë, ka të drejtën të kryejë pagesa në lidhje me kërkesat deri në vlerën tavan pa hetime apo investigime të mëtejshme, si dhe pa u shqetësuar për vlefshmërinë, vërtetësinë, saktësinë dhe/ose bazën e kërkesave që ai merr sipas kësaj Garancie. Gjithashtu, Garantuesi nuk ka asnjë detyrë apo detyrim që të kontrollojë apo të konfirmojë nëse personi që ka nënshkruar kërkesën është në fakt personi i autorizuar për nënshkrimin e këtyre kërkesave në emër të Përfituesit.

**5. PËRFUNDIMI**

Kjo Garanci hyn në fuqi duke filluar nga [*data*] dhe do të përfundojë në [data] ("**Data e Përfundimit të Garancisë**"). Në vijim të Datës së Përfundimit të Garancisë, kjo Garanci, bëhet e pavlefshme dhe Garantuesi nuk ka më asnjë detyrim apo përgjegjësi sipas saj përveç detyrimeve parashikuar këtu që kanë lindur apo janë bërë të kërkueshëm në apo para Datës së Përfundimit të Garancisë.

**6. ZGJIDHJA**

Garantuesi mund ta zgjidhë këtë Garanci në çdo kohë nëpërmjet njoftimit me shkrim tek Principali dhe Përfituesi me efekt nga data ("**Data e Zgjidhjes**") e përcaktuar në atë njoftim që nuk duhet të jetë më pak se tre (3) muaj kalendarikë pas njoftimit tek Principali dhe Përfituesi nga Garantuesi. Në Datën e Zgjidhjes, të gjitha detyrimet e Garantuesit sipas kësaj Garancie përfundojnë dhe Garantuesi nuk ka më përgjegjësi lidhur me to, përveç rastit kur zgjidhja e kësaj Garancie nuk prek

ndonjë detyrim të Garantuesit që ka lindur apo është bërë i kërkueshëm përpara zgjidhjes sipas kësaj Garancie.

**7. TË NDRYSHME**

7.1 Garantuesi nuk mund t'ia kalojë dhe/ose transferojë detyrimet ose të drejtat e tij në këtë Garanci asnjë personi pa miratimin paraprak me shkrim të Përfituesit dhe Principalit.

7.2 Kjo Garanci rregullohet nga legjislacioni shqiptar. Çdo mosmarrëveshje ose mosmarrëveshjet që rrjedhin nga apo në lidhje me këtë Garanci, duke përfshirë mosmarrëveshjet lidhur me ekzistencën, vlefshmërinë ose zgjidhjen e kësaj Garancie apo detyrimet jashtëkontraktuale që rrjedhin nga apo në lidhje me këtë Garanci ("**Mosmarrëveshje**") do të referohen dhe zgjidhen përfundimisht nëpërmjet arbitrazhit sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) ("**Rregullat**"). Rregullat përfshihen si referencë në këtë paragraf. Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga tre arbitra të caktuar në përputhje me rregullat në fjalë. Selia, apo vendi ligjor, e arbitrazhit është në Vjenë, Austri. Gjuha e arbitrazhit është gjuha angleze. Të gjithë dokumentet e paraqitur në lidhje me procedurat e arbitrazhi janë në gjuhën angleze, ose nëse janë në gjuhë tjetër, shoqërohen me përkthimin në gjuhën angleze.

7.3 Përveç Garantuesit, Principalit dhe Përfituesit, asnjë person tjetër nuk ka të drejtë(a) të ekzekutojë apo të përfitojë nga kushtet e kësaj Garancie.

[Përveçse kur bie ndesh me kushtet e shprehura të kësaj Garancie, kjo Garanci i nënshtrohet rregullave uniforme të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) për garancitë me kërkesë, rishikimi i 2010, botimi nr. 758 i ICC-së].

PËR DHE NË EMËR TË

[*EMRI I BANKËS TREGTARE LËSHUESE*]
*[EMRI I NËNSHKRUESIT]*
*[TITULLI I NËNSHKRUESIT]*

SHTESA E SHTOJCËS 2: FORMA E KËRKESËS

[DATA E KËRKESËS]

PËR: *[Emri dhe adresa e bankës lëshuese]*

NGA: *[Emri dhe adresa e përfituesit]*

**RE: LETRA JUAJ E GARANCISË NR. [◆ ] DATË [◆ ] 20[◆]**

Kjo i referohet letrës suaj të mësipërme të garancisë ("**Garancia**"). Kjo është një kërkesë me shkrim për pagesë sipas garancisë në përputhje me Garancinë. Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në Garanci kanë të njëjtin kuptim dhe në këtë kërkesë.

Në përputhje me paragrafin 4 të Garancisë, konfirmojmë sa më poshtë:

Principali ka shkelur Detyrimet e Garantuara;

1. Shkelja përkatëse e detyrimeve që passolli këtë kërkesë konsiston në [*të përcaktohet shkelja përkatëse që ka passjellë këtë kërkesë në kohën e kërkesës];* dhe

2. Shuma e kërkuar për shlyerje nga Principali dhe e pretenduar në këtë kërkesë është [*të përcaktohet shuma përkatëse me fjalë dhe shifra*].

Ju lutemi të kryeni pagimin e shumës së përcaktuar në pikën 3 më sipër nëpërmjet swift-it në llogarinë e mëposhtme dhe brenda afatit kohor të parashikuar në Garanci:

[*të vendosen të dhënat e llogarisë në kohën e kërkesës*]

Kjo kërkesë rregullohet nga ligjet e Anglisë dhe Uellsit. Kjo kërkesë nuk cenon të drejtat tona për të bërë kërkesa të tjera në të ardhmen, siç parashikohet në Garanci, deri në vlerën tavan.

Për dhe në emër të [*emri i përfituesit*]

[*emri i nënshkruesit të autorizuar të përfituesit*]
Nënshkruesi i autorizuar

**SHTOJCA 3: FORMULA PER GARANCINE E DISPONUESHMERISE DHE DEMET** *(NESE E APLIKUESHME)*

## SHTOJCA 4: FORMULA PER DEMET E LIKUIDUARA PER DISPONUESHMERINE ENERGJITIKE

## SHTOJCA 5: PERCAKTIMI I SASISE SE KONTRATES PER PERIUDHEN E TREGTIMIT II